

Vesna Kipa Tatjana Novoviq

HULUMTOJ

MJEDISIN

TIM

NATYRA DHE SHOQËRIA
PËR KLASËN E DYTË TË SHKOLLËS FILLORE
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË
2012

Весна Кипа др Татјана Нововић
ИСТРАЖУЈЕМ СВОЈУ ОКОЛИНУ
Природа и друштво за други разред основне школе
ПРИРУЧНИК ЗА НАСТАВНИКЕ

Vesna Kipa dr. Tatjana Novović
HULUMTOJ MJEDISIN TIM
Natyra dhe shoqëria për klasën e dytë të shkollës fillore
LIBRI I MËSUESIT

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse: Nagja Durković

Redaktore në gjuhën malazeze: Snezhana Martinović

Redaktor i botimit në gjuhën shqipe: Dimitrov Popović

Recensentë: dr. Zhelko Jaqimović
mr. Danka Petrović
Ranka Bozhović
Rada Mujović
Petar Shpadijer

Ilustrimet: Ozren Mizhdallo

Përkthyes: Zarija Brajović

Dizenjoja dhe përgatitja teknike: Sllagjana Bajiq-Bogdanović

Redaktor teknik: Rajko Radulović

Faqosja e botimit në gjuhën shqipe: Rajko Jelovac

Për botuesin: Nebojsa Dragović

Shtypur në: "Studio MOUSE", Podgoricë

Tirazhi: 50

CIP - Каталогизacija у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње
ISBN 978-86-303-1648-7
COBISS.CG-ID 19783440

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin numër 16-3740 të datës 11.07.2011, e ka miratuar këtë Tekst mësimor për përdorim në shkollën fillore.

P Ë R M B A J T J A

REKOMANDIME HYRËSE	5
RRITEMI	7
PËRSËRI NË SHKOLLË	9
KUR TË RRITEM, DO TË BËHEM	10
FAMILJA IME	12
NË MOSHË GJITHNJË E MË TË MADHE	14
SI KA JETUAR GJYSHJA E NËNËS?	15
SHOKË E MIQ	16
SHKOLLA JONË	18
NË SHKOLLË	20
RREGULLOJMË KLASËN	21
KËNDI I GJALLË	23
NË KËNDIN E LOJËRAVE	24
RETË DHE ERA	27
MOTI	29
KA ARDHUR VJESHTA	31
MË THUAJ ME FIGURA	32
DITA DHE NATA	34
GJATË UDHËTIMIT	36
SHENJAT E QARKULLIMIT RRUGOR	38
UDHËTOJMË	40
TË JEMI TË KUJDESSHËM	42
KËMBALKAT DHE PATERICAT	43
PREJ Ç'GJËJE JANË SENDET?	45
SHPEJT, MË SHPEJT	47
KA ARDHUR DIMRI	50
KA RËNË BORË	52
UJI DHE AKULLI	53
KALENDARI	55
FESTOJMË	56

KUJDESEM PËR VETVETEN	58
TRUPI IM	60
USHQIMI	62
JETOJ NË MËNYRË TË SHËNDETSHME.....	63
PRANVERA ERDHI	65
DRURI NDRYSHON	67
PREJ NGA VJEN USHQIMI?	68
MAJDANOZI DHE SPECI	70
NË LIVADH	72
LIQENI.....	74
TË NGJASHËM, POR TË NDRYSHËM	76
MJEDISI IM	78
NGA SHTËPIA DERI NË SHKOLLË	80
MJEDISI NDRYSHON	81
ÇFARË TREGOJNË TABELAT	83
VERA	84

REKOMANDIME HYRËSE

Sikurse edhe vitin e kaluar, kompleti mësimor për Lëndën "Natyra dhe shoqëria" të klasës së dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare; "Hulumtoj mjedisin tim 2", përfshin Tekstin mësimor, Fletoren e punës dhe Librin e mësuesit.

Duke ndjekur logjikën e vazhdimësisë me temat mësimore më parë të zhvilluara në kompletin e tekstit mësimor të klasës së parë, pastaj idenë për metodën integruese të materialit të zgjedhur të mësimin si edhe ligjet e metodës së mësimin e të njohjes, temat mësimore i kemi organizuar në kapituj të gjerë të lidhur logjikisht. Edhe ky Libër i mësuesit është hartuar me qëllim që t'u ofrojë mësuesve mbështetjen për arritjen e qëllimeve të vëna me Programin mësimor dhe që mësimin ta bëjnë sa më funksional.

Libri i mësuesit është i ndërtuar në tetë kapituj të ndarë në 37 tema mësimi dhe ndjek Tekstin mësimor dhe Fletoren e punës të konceptuara në të njëjtën mënyrë. Çdo kapitull është një grupim i integruar i një numri të caktuar temash mësimore të lidhura nga ana logjike, në të cilat ndërthuren qëllimet programore natyrore, shoqërore e teknike dhe zhvillohen nocionet e konceptet. Mendojmë se kjo është mënyra më primare që mësuesit të japin mësim duke nxitur tek nxënësit vrojtimin, hulumtimin, të menduarit dhe lidhjen e aspekteve të ndryshme të nocioneve në rrjete të plota e në koncepte. Një strukturë e tillë e përmbajtjes së kompletit mësimor "Hulumtoj mjedisin tim 2" ka si qëllim ta mbështesë të mësuarit dhe organizimin e njohurive, të cilat do të pasurohen nga nxënësi. Karakteri konkret në parashtrimin e temave mësimore e të nocioneve në Tekstin mësimor dhe në Fletoren e punës duhet të mundësojë të mësuarit mendor e efikas, të rrisë shkallën e motivimit të nxënësve dhe të ndihmojë në ndërtimin e strategjisë së përgjithshme për kuptimin e qëllimeve të Programit.

Gjatë konceptimit të Librit të mësuesit kemi patur si qëllim që t'u ndihmojmë mësuesve për t'i planifikuar, renditur e realizuar në një mënyrë sa më frytdhënëse qëllimet e Programit. Krahas qëllimeve operative të Programit të Lëndës "Natyra dhe shoqëria" të klasës së dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare, kemi shtuar edhe disa qëllime të reja, të cilat nuk i implikojnë nocionet e reja, por vetëm i zgjerojnë ato aktualet dhe ndihmojnë në zhvillimin e disa proceve të njohurive, respektivisht të shkathtësive të nxënësve.

Lidhja e qëllimeve të Programit të fushave të ndryshme mundëson integrimin e temave mësimore natyrore, shoqërore e teknike. Në të njëjtën kohë, ndërthurja logjike e qëllimeve dhe e temave mësimore është pikënisje për mësimin e lëndëve të ndryshme mësimore gjatë shkollimit të mëtejshëm. Qëllimet dhe veprimtaritë brenda një kapitulli, respektivisht të disa temave të mësimin, mund të përfaqësojnë boshtet integruese për lidhjen me lëndët e tjera mësimore. Kjo është rruga e natyrshme për trajtimin e dukurive/fenomeneve të caktuara në aspekte të ndryshme me synim përvetësimin e nocioneve dhe kuptimin e mjedisit rrethues të drejtpërdrejtë dhe më gjerë. Përvetësimi i përhershëm dhe funksional i nocioneve është i mundshëm, nëse nxënësit e mbështetin përvojën e re në përvojën e vjetër; të njohur, të afërt për nga konteksti. Në këtë mënyrë, njohuritë

e veta të pasistemuara e spontane i integrojnë në sistemet e koncepteve të menduara e të rregulluara. Kriteret për lidhje duhet të jenë të qarta e precize. Nacionet shkencore janë të lidhura horizontalisht e vertikalisht dhe lindin mbi bazën e lidhjeve të nocioneve spontane. Duke patur parasysh natyrën njohëse të fëmijës, të ndërtimit e të përvetësimit të nocioneve, mësuesit vazhdojnë që t'i zhvillojnë, t'i zgjerojnë e t'i plotësojnë nocionet që kanë trajtuar në klasën e parë: unë (nacioni për vetveten), e gjallë/jo e gjallë, shëndet, komunitet, marrëdhënie, kohë, hapësirë, materie.

Pas fjalëve hyrëse të autorëve, në Librin e mësuesit do të gjeni sqarimet më nga afër për strukturën e çdo kapitulli, propozimin për Planin vjetor, si edhe listën e literaturës së përdorur.

Çdo kapitull përmban **pjesën hyrëse**, ku është sqaruar koncepti i kapitullit, me shpjegimin e qëllimeve e të përmbajtjeve të temave. Drejtimet teorike shërbëjnë si kujtesë për disa informacione shtesë të lëndës mësimore dhe për vendosjen e lidhjeve më të qarta midis temave të ndryshme. Zhvillimi më i hollësishëm i çdo teme mësimi është dhënë përmes një varg veprimtarish të propozuara dhe punës me Tekstin mësimor e Fletoren e punës. Në fillim të çdo teme mësimi janë dhënë **qëllimet** e Programit që do të realizohen dhe **nacionet (fjalët) kyçe**. Pasojnë **veprimtaritë e propozuara** me të cilat mund të arrihen qëllimet e parashikuara, ndërsa pastaj edhe shpjegimet për **punën me Tekstin mësimor** e me **Fletoren e punës**. Edhe një herë theksojmë se mësuesit, në përpunje me autonominë personale profesionale, mund të zgjedhin veprimtaritë e tjera për arritjen e qëllimeve të projektuara me Program, përkatësisht të rezultateve. Në fund të çdo teme mësimi janë dhënë **mjetet ndihmëse**.

Veprimtaritë e propozuara mund të realizohen në klasë, në ambientet e shkollës, në oborrin e shkollës ose jashtë ambientit të shkollës. Rekomandohet që, në përpunje me natyrën e lëndës së mësimi, mësues-i/ja të organizojë mësimin në situata e në kontekste të ndryshme. Është e dëshirueshme që për dukuritë e ndodhitë e ndryshme në mjedisin natyror e shoqëror, nxënësit të mësojnë përmes përvojës konkrete. Në këtë mënyrë ata zhvillojnë zbatimin e metodave të ndryshme të njohjes, d.m.th. mësojnë të vrojtojnë, të sistemojnë, të bashkojnë, të rregullojnë, të hulumtojnë, të eksperimentojnë, të modelojnë, ndërsa po ashtu edhe të vënë re se metodat e njohjes mund t'i zbatojnë në situatat e ndryshme, d.m.th. të krijojnë zgjidhjet vetjake.

Gjatë strukturimit të disa veprimtarive të propozuara kemi theksuar mënyrat e ndryshme të stimulimit të proceseve mendore taksonomike më të larta e të ndërlikuara (analiza, sinteza, zbatimi, krijimi), me qëllim që t'i nxitim ata që të arsyetojnë me shtresëzime, t'i zgjidhin situatat problemore; të reagojnë në mënyrë kritike, të krijojnë qendrimin personal ndaj çështjeve të ndryshme. Mësuesit, duke shfrytëzuar përvojën praktike, mund të mendojnë e të krijojnë veprimtaritë e reja e tjetërsoj që u përgjigjen kërkesave të nxënësve dhe realizimit të qëllimeve të vëna në një mënyrë me frytdhënëse.

Meqë temat e mësimi janë të shumëllojshme e të hapura për veprimtaritë e përmbajtjet aktuale interesante e jetësore, të afërta me përvojën e fëmijëve, është e mundur që ato të lidhen e të ndërthuren me veprimtaritë në lëndët e tjera të mësimi e të krijojen projektet e vogla interdisiplinare. Me vendosjen e korelacioneve më fushat e tjera realizohet lidhja e natyrsme me jetën e përditshme dhe së fundi hapet rruga drejt njohurive të përdorshme.



RRITEMI

Në kuadrin e kapitullit të parë, *Rritemi*, kemi përmbledhur gjashtë tema mësimi të ngjashme: *Përsëri në shkollë, Kur të rritem, do të bëhem..., Familja ime, Në moshë gjithnjë e më të madhe, Si ka jetuar gjyshja e nënës, Miqtë.*

Qëllimet e këtij kapitulli janë që nxënësit: të vënë re ndryshimet tek vetja dhe tek të tjerët (rriten, u ndërrohen dhëmbët ...), të vënë re dallimet nga këndvështrimi i mënyrave dhe organizimit të jetës së familjes së tyre, sot dhe në të kaluarën; hulumtojnë dhe mësojnë për jetën në të kaluarën; shqyrtojnë rëndësinë dhe veçantitë e sjelljes në periudhat e caktuara të zhvillimit (fëmijëria, rinia, pjekuria, pleqëria), dallojnë dhe pranojnë ngjashmëritë reciproke, mësojnë të respektojnë dallimet; dhe me shprehjen e tyre lirishëm ata bëhen të vetëdijshëm për nevojat e veta, duke respektuar të drejtat dhe nevojat e tjerëve; vendosin marrëdhënie reciproke miqësore, respekti, kujdesi për të tjerët, tolerance, empatie

Jeta fillon me lindjen, ndërsa rritja dhe zhvillimi bëhen sipas ligjësive të caktuara natyrore. Bisedohet me nxënësit për jetën e njeriut në etapa të veçanta të zhvillimit jetësor: fëmijëria, rinia, moshë e pjekurisë, pleqëria. Çdo etapë e zhvillimit ka veçantitë e veta dhe mundësitë e veçanta. Nxënësit ndjekin rritjen dhe zhvillimin e vet në bazë të treguesve të ndryshëm; kujtojnë se çfarë kanë veshur, krahasojnë pamjen e sotme me atë në fotografitë e disa viteve më parë, krahasojnë madhësinë e gjurmës së këmbës së tyre tani me atë të vitit të kaluar, mësojnë sesi kanë folur, kanë ecur dhe kanë vizatuar, kur kanë qenë në kopsht duke u bazuar në kujtimet e prindërve Vënë re se, përveç ngjashmërive me të tjerët, ata janë të veçantë dhe unik për nga mundësitë, për nga talenti, për nga dëshirat dhe për nga interesimet e tyre. Dikush ka afinitet për artin, dikush është i aftë në veprimtaritë sportive, në matematikë, ose, ndoshta, në ndonjë fushë tjetër. Nxënësit nxiten që të jenë tolerantë ndaj dallimeve, d.m.th. të respektojnë dallimet e ndërsjella në kërkesa, në interesime dhe në dëshira.

Nxënësit dallohen për nga gjinia, moshë, dija, llojet e përvojave, rrethanat familjare dhe vendi ku jetojnë Bisedohet për profesionet e ndryshme, në fillim për ato që janë të afërt me përvojën e nxënësve; me se merren prindërit e tyre, gjyshja dhe gjyshi, të njohurit Bisedohet për rëndësinë e profesioneve të veçanta për individin dhe për shoqërinë. Duke u rritur dhe duke zhvilluar, pikëpamjet për botën dhe për jetën ndryshojnë pra edhe dëshirat, edhe kërkesat, edhe interesimet e nxënësve për profesionet e veçanta. Përveç dallimeve të dukshme dhe natyrore midis tyre, nxënësit dallojnë ngjashmëritë, interesimet e përbashkëta dhe dallueshmëritë; mësojnë t'i përshtatin nevojat e veta me ato të tjerëve dhe në këtë mënyrë ta zhvillojnë cilësinë e jetesës së përbashkët. Në këtë rast, mund të kujdesen dhe zhvillojnë pa pengesë veçantinë e vet, të zgjedhin miqtë, lojrat, veprimtaritë e ndryshme, profesionet dhe të ardhmen.

Respektimi i dallueshmërive nënkupton edhe respektimin e kulturës familjare të çdo individi. Për këtë, atyre mund t'u ndihmojnë prindërit dhe anëtarët e tjerë më të rritur të familjes së tyre të ngushtë apo të gjerë. Prej prindërve/të moshuarve mund të mësojnë diçka më shumë për atë sesi kanë jetuar, me se janë marrë, si kanë mësuar, çfarë lojërash kanë luajtur etj. Vërejnë se familjet dallohen për nga numri dhe për nga përbërja, për nga mënyra e funksionimit të tyre dhe për nga profesionet me të cilat merren të rriturit. Pavarësisht nga dallimet në familje, ajo që është e përbashkët për to



është afërsia, kujdesi për njëri-tjetrin, si dhe detyrimet që kanë të gjithë në familje; prej më të voglit deri tek më i moshuari. Bisedohet për atë sesi duket sot jeta në familjen e tyre, ç'role dhe ç'detyrime kanë, si i ndajnë detyrat, në ç'mënyrë i ndihmojnë njëri-tjetrit dhe si e kalojnë kohën e lirë. Vënë re se çdo anëtar i familjes ka të drejtën e barabartë për kohën e lirë dhe për plotësimin e nevojave të veta dhe se për këtë arsye është e rëndësishme që ta ndihmojmë njëri-tjetrin dhe t'i ndajmë në mënyrë të barabartë detyrat. Nxënësit mësojnë se është e nevojshme ndihma reciproke në familje, që ata të sillen me përgjegjësi dhe të kryejnë detyrimet e veta. Kjo do të jetë baza për respektimin e mëtejshëm rigoroz të detyrimeve edhe në komunitetet e tjera.

Në klasën e parë fëmijët kanë filluar të mësojnë për të kaluarën e tyre duke shikuar fotografitë dhe sendet e ndryshme, të cilat i kanë përdorur në moshën më të hershme (kur kanë qenë bebe, kur kanë qenë 3 apo 4 vjeç ...). Njohja e së kaluarës vazhdon me njohjen e jetës në të kaluarën; si kanë qenë shtëpitë, mjetet e transportit e sendet dhe si janë zbavitur njerëzit ... Në mënyrë që fëmijët të mësohen me hulumtimin e historisë, i nxitim ata që të kërkojnë dhe të shfrytëzojnë burimet e ndryshme historike, të cilat dëshmojnë për jetën në të kaluarën: burimet materiale (fotografitë, sendet, filmat, muzeumet „...“), burimet gojore, të dëgjojnë rrëfimet e të moshuarve për jetën në të kaluarën (gjyshja, gjyshi ...), ndërsa më vonë, kur të kenë mundësi, do të shfrytëzojnë edhe burimet e shkruara. Bisedohet me nxënësit për jetën e gjysheve dhe gjyshërve të tyre. Sendet e ndryshme dëshmojnë për mënyrën e dikurshme të jetesës. Vënë re specifikat nga pikëpamja e materialeve prej të cilave janë punuar sendet në të kaluarën, e vjetërsisë së tyre, e funksionit dhe mund të bëjnë krahasimin me sendet e sotme me funksion të ngjashëm. Nxënësit do të zgjedhin mënyrat e ndryshme për të shënuar se çfarë kanë mësuar dhe se prej kujt kanë dëgjuar diçka, si edhe se çfarë tjetër mund të kërkojnë (me vizatim, me shënim, duke qarkuar fjalët ...). Sendet që janë përdorur dikur janë tjetërsoj. Nxënësit do ta konfirmojnë këtë me vrojtimin dhe me krahasimin e sendeve të ndryshme. Këto janë rastet për të biseduar për mënyrën e jetesës në të kaluarën dhe për vënien re të disa veçantive në raport me jetën aktuale. Gjithashtu ky është rasti për të nxitur përsosjen e të shprehurit të tyre gojoro-gjuhësor dhe të përdorimit si duhet të përcaktimeve kohore (dje, sot, dikur, më parë, më pas ...). Njohja me jetën në të kaluarën u ndihmon nxënësve që ta kuptojmë më mirë të sotmen. Informacionet që marrin, nxënësit mund t'i transmetojnë me gojë, me vizatim dhe përmes lojës, ndërsa mësojnë gradualisht që të shënojnë atë që kanë dëgjuar dhe mësuar për jetën në të kaluarën.

Nxënësit ushtrohen që t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe të rriturve. Mësojnë që të dëgjojnë me vëmendje njëri-tjetrin dhe të respektojnë të drejtat e të tjerëve për shprehjen nga ana e tyre në mënyrë unike të nevojave, të interesimeve dhe të mënyrës së kryerjes së disa detyrave. Qëndrimi i përgjegjshëm ndaj vetes dhe të tjerëve do t'u mundësojë atyre kapërcimin me sukses të problemeve, zgjidhjen e konflikteve dhe shprehjen e empatisë. Djemtë dhe vajzat nxitën për veprimtari të përbashkëta dhe përpiqemi që situatat e tilla të bëhen të zakonshme dhe të natyrshme. Në klasë/shkollë ka edhe nxënës, të cilëve u nevojitet një përkrahje shtesë. Duke shfrytëzuar situatat aktuale, nxitet tek nxënësit sjellja kooperuese, reciprociteti i tyre i shëndetshëm dhe përkrahja e ndërsjellë, pavarësisht nga mundësitë e tyre të ndryshme.



PËRSËRI NË SHKOLLË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re se çdo vit jemi më të rritur• të zgjerohen njohuritë për dallimet midis vetes e të tjerëve (moshatarëve e të rriturve)• të vihen re ndryshimet tek vetja dhe tek njerëzit në mjedisin përreth• të zhvillohet mirëkuptimi për dallimet midis njerëzve
Fjalë kyçe	pushim veror, pushim shkollor; pushim, përcaktim kohor: tani, më parë, më vonë, më i rëndë, më i lehtë; më i gjatë, më i shkurtër, ndryshim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit tregojnë sesi i kanë kaluar pushimet verore. Ku i kanë kaluar? Çfarë kanë bërë? Tregojnë ndodhitë interesante. Çfarë u ka pëlqyer më tepër? Ç'gjë të re kanë mësuar? Kush u ka ndihmuar për këtë gjë? Me kë kanë kaluar më shumë kohë? Çfarë nuk u ka pëlqyer? Pse?
2. Bisedohet me fëmijët për ditëlindjet. Kush e ka festuar ditëlindjen gjatë pushimeve verore? Ku e kanë festuar dhe si e kanë festuar? Sa janë më të rritur në raport me vitin e kaluar.
3. Ndërtohet histogrami e nxënësve në të cilin do të paraqitet sesa nxënës kanë mbushur moshën shtatë vjeç dhe sa do ta mbushin atë gjatë vitit shkollor në vazhdim.
4. Maten lartësitë trupore të nxënësve. Nga dosja e nxënësve e vitit të kaluar merren të dhënat e shtatlartësisë dhe krahasohen me shtatlartësinë e tashme. Sa janë rritur?
5. Në shkallën e shtatlartësisë shkruhet emri i nxënësit më shtatlartë e më shtatshkurtër në klasë. E njëjta gjë përsëritet edhe në fund të vitit dhe vihen re ndryshimet.
6. Nxënësit vrojtojnë në çifte dhe vënë re ndryshimet tek shoku/shoqja e tyre. Thonë se në ç'gjë kanë ndryshuar. I komentojnë ndryshimet në çifte. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë se, përveç se që janë më të rritur e të ndryshëm, janë: më shtatlartë, u është rritur shputa e këmbëve, u janë ndërruar dhëmbët, se disa mbajnë syze, ndërsa disa të tjerë proteza, se kanë mësuar diçka të re.
7. Nxënësit ndërtojnë në çifte konturet e shputave të këmbëve, i presin ato me gërrshërë dhe i krahasojnë me atë të vitit të shkuar. Komentojnë ndryshimet dhe madhësitë e stampave të shputave të këmbëve të shokut/shoqes së vet.

Puna me Tekstin mësimor

1. Komentohen fotografitë në të cilat është paraqitur se çfarë kanë bërë gjatë verës Ana dhe Markoja. Tregojnë sesi i kanë kaluar pushimet verore ata vetë. Ku i kanë kaluar? Me kë kanë kaluar pjesën më të madhe të kohës? A kanë zënë shokë/shoqe të reja? Çfarë u ka pëlqyer dhe çfarë nuk u ka pëlqyer? Komentojnë atë që kanë mësuar gjatë kohës së pushimeve verore? (Mbajnë mend se çfarë ka mësuar çdo anëtar i grupit; zgjedhin prezentuesin e grupit).



Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit paraqesin me anë të vizatimit, sesi i kanë kaluar pushimet verore.
2. Shohin vizatimet e fëmijëve dhe vënë re ndryshimet në shtatlartësi. Kush është më shtatlartë se Markoja dhe kush është më shtatshkurtër se Ana?
3. Fëmijët peshohen dhe kjo peshë krahasohet me peshën e vitit të shkuar (dosja e nxënësve). Nxënësit komentojnë ndryshimet në peshë për secilin. Sa kilogramë më shumë peshojnë? Kush ka shtuar më shumë kilogramë? Kush ka shtuar më pak? Kush ka peshën më të rëndë dhe kush peshën më të lehtë në klasë? Sa u është rritur shputa e këmbëve? Ç'numër këpucësh kanë mbajtur vitin e shkuar dhe ç'numër mbajnë tani? Kujt nuk i është rritur shputa e këmbëve? Kush e ka numrin më të madh të këpucëve dhe kush më të voglin?
4. Nxënësit komentojnë vizatimet. Shënojnë se çfarë kanë mësuar gjatë verës. Ç'gjë tjetër kanë mësuar.

Mjetet ndihmëse

matësi i shtatlartësisë, peshorja, bojërat tempera, gërshërët.

KUR TË RRITEM, DO TË BËHEM...

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re se njerëzit që jetojnë ose që punojnë bashkë, vendosin raporte të caktuara reciproke (respekt, dashuri, miqësi, bashkëpunim, kujdes, situata të ndryshme konfliktuale etj.)• të zhvillohet mirëkuptimi për dallimet midis njerëzve• të vihet re se edhe fëmijët, sikurse edhe të rriturit, gëzojnë lirinë e zgjedhjes, pavarësisht nga gjinia• të mësohet se lojërat, shokët dhe shoqet mund të zgjidhin lirisht
Fjalë kyçe	respekt, dashuri, miqësi; bashkëpunim, kujdes, konflikt, fëmijë, i rritur, profesion, zgjedhje e lirë, dallim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit tregojnë se çfarë u pëlqen më shumë që të punojnë. Çfarë u pëlqen të punojnë kur të rriten? Përshkruajnë profesionin që u pëlqen ta ushtrojnë në të ardhmen. Thonë pse u pëlqen më shumë. Çfarë duhet të dijnë që ta ushtrojnë këtë profesion? Ku mund ta mësojnë këtë gjë? A merret ndokush në familjen e tyre apo aty pranë me këtë profesion.
2. Paraqitin me vizatim profesionin që u pëlqen më shumë.



3. Nxënësit bisedojnë me pjesëtarët e rritur të familjes për profesionin që këta kanë preferuar më shumë kur kanë qenë të vegjël. Çfarë kanë dëshiruar të bëhen kur të rriten? A u janë plotësuar dëshirat? Nëse nuk u janë plotësuar, cili është shkaku?
4. Bisedohet për profesionet interesante, të rrezikshme ose të rralla. Thonë shkaqet se për ç'arsye mendojnë se këto profesione janë interesante, të rrezikshme ose të rralla.
5. Lexohen tekstet dhe shikohen filmat për profesionet e pazakonshme e të rrezikshme. Bisedohet për mundësitë e barabarta të të dy gjinive. Nxënësit thonë supozimet e veta për atë që është e rëndësishme për kryerjen e një pune (dashuria, dëshira, dija, përkushtimi ...).
6. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Formohen dy grupe dhe organizohet stafeta e vrapimit. Në njërin grup caktojmë "ngatërrestarin", i cili do ta pengojë punën e grupit, d.m.th. që nuk do të vrapojë sipas rregullit. Fëmijët e tjerë nuk duhat ta dijnë detyrën e këtij nxënësi. Pas vrapimit të parë, të njëjtën gjë e bëjmë edhe në grupin e dytë (caktojmë "ngatërrestarin"). Nxënësi i grupit të parë që e ka penguar punën, tani vrapon sipas rregullave. Pas stafetës bisedojmë për shkaqet e dështimit të ekipit. Nxënësit duhet ta dallojnë "ngatërrestarin", i cili s'ka dashur të vrapojë, ka vrapuar në drejtimin e kundërt, ka pirë ujë gjatë vrapimit etj. Vënë re rëndësinë e punës në grup.
7. Bisedohet për profesionet që kryhen në grupe; puna në grup. Dallojnë profesionet e tilla (mjek, tregtar, mësues, futbollist ...). Si duhet të sillen anëtarët e grupit? Çfarë ndodh, nëse dikush sillet në mënyrë të papërgjegjshme, nëse nxehet, grindet Çfarë ndodh, kur ata kryejnë ndonjë veprimtari, nëse nuk kanë harmoni ose nxehen?
8. Nxënësit thonë lojërat e tyre të preferuara, pse u pëlqejnë ato, me kë luajnë më shpesh. Përshkruajnë rregullat.
9. Bisedohet për shokët e shoqet. Pse u pëlqen të luajnë me to? Çfarë u pëlqen më shumë tek ata. Si veprojnë kur ka grindje?

Puna me Tekstin mësimor

1. Nxënësit shohin vizatimet dhe komentojnë atë që është paraqitur në to. Për çfarë mendon Ana? Çfarë dëshiron të bëjë Markoja dhe çfarë Stefani. Çfarë dëshirojnë të bëhen, kur të rriten? Bisedojnë për atë që do të dëshironin të bëhen, kur të rriten? Ku mund ta mësojnë këtë gjë?
2. Bisedohet për fotografitë ilustruese. Komentohet çdo fotografi veçmas dhe lexohet teksti i shkruar poshtë tyre. Ç'punë bëjnë personat në fotografi. A i kryen këto punë ndonjë prej pjesëtarëve të familjes, të kushërinjve apo të miqve të tyre? A janë të kënaqur ata me punën që kryejnë?

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit vizatojnë se çfarë dëshirojnë të bëhen kur të rriten.
2. Shkruajnë për shokun/shoqen e vet më të mirë. Si quhet? Cila është loja e tyre e preferuar? Çfarë dëshiron të bëhet, kur të rritet?
3. Komentojnë vizatimet. Çfarë është paraqitur në vizatimin me sjellje miqësore dhe çfarë në vizatimin me sjellje jomiqësore? Lexohen fjalët "sjellje miqësore" dhe "sjellje jomiqësore"; i lidhin ato me vizatimin e duhur.



4. Bisedohet për lojërat dhe për veprimtaritë e preferuara: “Mos u inatos”, basketbolli, piktura, loja me kompjuter, muzika. Mbi bazën e shpjegimit, ngjyrosin numrin e shkallëve në tabelë. Sipas lartësive të shtyllave të përfutuara, nxirret përfundimi se çfarë dëshirojnë të bëjnë nxënësit më shumë dhe çfarë më pak në klasën e tyre.

FAMILJA IME

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të zhvillohet qëndrimi pozitiv ndaj punës së të gjithë pjesëtarëve të familjes• të kuptohet vlera e punës e të gjithë pjesëtarëve të familjes
Fjalë kyçe	familje, pjesëtar (anëtar) i familjes, detyrë, bashkëpunim, ndihmë, përzgjedhje, mundësi, kohë e lirë

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit bisedojnë për familjet e veta. Sa pjesëtarë (anëtarë) ka familja e tyre? Kush është më i moshuari dhe kush më i ri? A ka ndryshuar numri i pjesëtarëve të familjes në raport me vitin e shkuar apo me disa vite më parë? Si ka ndryshuar (a ka lindur apo ka vdekur ndokush)?
2. Nxënësit vizatojnë pjesëtarët e familjes së vet dhe profesionet e prindërve. Hartojnë histogramin e profesioneve të prindërve. Vënë re sa prindër kanë të njëjtin profesion. Cilat profesione janë më të rralla?
3. Bisedohet për rëndësinë e marrëveshjes dhe harmonizimit të detyrave. Si i arrijnë marrëveshjet në shkollë? Cilat punë kryejnë vetë? Kur u nevojitet ndihma? Prej kujt mund ta marrin atë? Theksohet rëndësia e bashkëpunimit dhe e mirëkuptimit reciprok. Theksohet se ka rëndësi mirëkuptimi ndaj ndryshimeve.
4. Formohen grupet duke patur në secilën nga katër nxënës. Çdo grupi i japim një fletë letre dhe i “ndajmë” ambientin e caktuar të banesës (kuzhinën, dhomën e ditës, banjën, oborrin). Nxënësit në grupe bien dakord për aparatet, për mjetet ndihmëse dhe për preparatet për mirëmbajtjen e higjienës në këto ambiente. Vizatojnë, sipas marrëveshjes, preparatet apo aparatet.
5. Nxënësit bisedojnë për punët që kryejnë në shtëpi. Në ç’mënyrë mund t’u ndihmojnë ata prindërve të vet? Si bien dakord për kryerjen e këtyre punëve?
6. Bisedohet për kohën e lirë: Ç’është koha e lirë dhe si e kalojnë ata? Si e kalojnë kohën e lirë prindërit e tyre? Çfarë u pëlqen më shumë që të punojnë? Çfarë



u pëlqen atyre që të punojnë me prindërit e vet? Çfarë ndodh, nëse dikush prej pjesëtarëve të familjes ka më shumë detyra, sesa duhet? Si bien dakord në këtë rast? Si mund mund të bien ndryshe dakord? Qëllimi është që fëmijet të kuptojnë se çdo pjesëtar i familjes e ka të drejtën e barabartë për kohën e lirë dhe për plotësimin e kërkesave të veta.

Puna me Tekstin mësimor

1. Nxënësit shohin vizatimet dhe vënë re se çfarë bëjnë pjesëtarët e familjes së Anës. Thonë punët e shtëpisë. Si bien dakord dhe si ndihmojnë ata njëri-tjetrit në familjet e tyre? Pse ka rëndësi që të arrijmë marrëveshje? Ç'dobi kanë ata vetë, nëse marrin pjesë në kryerjen e punëve/detyrimeve shtëpiake?
2. Shohin vizatimet dhe vënë re se çfarë bëjnë pjesëtarët e familjes së Anës në kohën e lirë. Bisedojnë për atë që bëjnë në kohën e lirë.
3. Lexohet teksti pranë figurës së piknikut. Kush e ka propozuar piknikun? Kush luan badminton? Me kë luan vëllai i Anës? Kush po përgatit drekën? Lexohen tekstet e shkruara pranë vizatimeve që tregojnë, sesi bien dakord për të shkuar në piknik pjesëtarët e familjes së Anës. Ç'detyra kanë patur? Pse nuk ka dashur të shkojë në piknik nëna? Kush vendosi që t'i ndihmonte? Çfarë duhej të bënte vëllai? Nxënësit thonë supozimet e veta për atë që ka bërë vëllai i Anës (e ka thirrur Stefanin dhe i ka kërkuar të falur, duke i premtuar se do t'i shkojë për vizitë, kur të kthehet nga pikniku; i ka shkuar për vizitë para se të shkojë në piknik; nuk i ka shkuar për vizitë ...).

Puna me Fletoren e punës

1. Bisedohet për veprimtaritë paraqitura. Ngjyrosin më ngjyrë të gjelbër atë që bëjnë, me ngjyrë të kuqe atë që nuk bëjnë, vënë shenjën X para veprimtarive që do të mund të bëjnë (tani e kryen dikush tjetër).
2. Nxënësit emërtojnë aksidentimet në shtëpi. Kë do të thërrasin në rast lëndimi, zjarri, shpërthimi të ujit Poshtë figurës shkruajnë numrin e duhur të telefonit (prindi ____, policia 122, zjarrfikësi 123, ndihma e shpejtë 124).



NË MOSHË GJITHNJË E MË TË MADHE

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen periudhat e ndryshme të jetës së njeriut• të mësohet se qeniet e gjalla lindin, rriten, plaken dhe vdesin• të vihet re se çdo vit bëhemi më të rritur
Fjalë kyçe	tani, më parë, më vonë, ka ndodhur, do të ndodhë, e kaluara, e tashmja, e ardhmja, fëmijë, është rritur, plak (i moshuar), fëmijëri, rini, person i rritur, pleqëri; rritje, vogli (i), lindje, vdekje.

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet për nxënësit në moshë më të madhe e më të vogël. Kush është shtatë vjeç, kush do t'i mbushë shtatë vjetët? A është me moshë më të madhe ai që do të mbushë shtatë vjet më parë apo më vonë? Hartojnë shiritin kronologjik të ditëlindjeve të nxënësve të klasës së vet (duke filluar nga 1 shtatori).
2. Nxënësit pyesin në shtëpi se kush është anëtari më i moshuar dhe më i ri i familjes së tyre. Sa vjeç është pjesëtari më i moshuar dhe sa pjesëtari më ri?
3. Nxënësit sjellin fotografi të fëmijërisë së vet dhe i komentojnë ato. Sa kanë ndryshuar? I renditin kronologjikisht fjalitë. Bëjnë supozime, sesi do të jenë kur të rriten. Me se do të merren kur të rriten?
4. Nxënësit presin nga revistat fotografi të njerëzve të moshave të ndryshme. Fotografitë i ngjitin në stendë sipas grupimeve: fëmijët, të rriturit, të moshuarit.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shiriti i kohës tregon jetën e gjyshit të Markos. Nxënësit tregojnë sipas fotografive. Si është dukur ai si bebe? Sqarohet se jeta në kaluarën ka qenë ndryshe, se nënat kanë punuar shumë dhe se fëmijët, për t'i mbartur më lehtë, i kanë mbështjellë me breza të posaçëm. Fëmijët e lidhur në këtë mënyrë nuk kanë mundur të bien nga djepi. Për këtë gjë nxënësit mund të bisedojnë me pjesëtarët më të moshuar të familjes së tyre më të gjerë. Komentohet periudha e gjyshit në shkollë. Si ka shkuar në shkollë ai? Si i ka mbajtur librat? Çfarë është bërë, kur është rritur? Si e ka kaluar kohën me Markon? Çfarë ka ndodhur me gjyshin në fund të tregimit për gjyshin? Çfarë i kujtohet me më dëshirë Markos? Nxënësit tregojnë për gjyshet e gjyshat e vet që janë apo nuk janë të gjallë.
2. Nxënësit komentojnë shiritin e kohës të Markos. Çfarë përfaqëson figura e parë, e dyta dhe treta? Ku qëndron ndryshimi midis Markos si bebe dhe gjyshit të tij kur ka qenë bebe? Pse ndodh kështu? Sa vjeç është Markoja në figurën që përfaqëson të tashmen? Çfarë dëshiron të bëhet Markoja në të ardhmen?

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit vizatojnë ndodhitë më të çuditshme nga jeta e tyre.
2. Nxënësit shkruajnë të dhënat për veten e tyre: datën e lindjes dhe sa vjet kanë kaluar që atëherë. Sa vjeç do të jenë pas tre vjetësh? Shkruajnë se ç'lodër kanë pasur të preferuar më parë dhe cilën kanë tani.

Mjetet ndihmëse

fotografitë personale, revistat, gërshtëret, letra hamer



SI KA JETUAR GJYSHJA E NËNËS?

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re se jeta e njerëzve në të kaluarën ka qenë ndryshe• të vlerësohen sendet e së kaluarës• të njihen nxënësit me aspektet e ndryshme të jetës së njerëzve në të kaluarën dhe sot
Fjalë kyçe	dikur, më parë, e kaluara (e shkuara), plak, stërgjyshe; stërgjysh, emërtimet e sendeve të së kaluarës.

Veprimtaritë e propozuara

1. Interpretohet veprimtaria “stuhi në mendje”. Shkruhen në dërrasë të zeze fjalët që kanë të bëjnë me të kaluarën. Nxënësit thonë nocionet që u kujtojnë këto fjalë. Shkruhen ato rreth fjalës “e kaluara”.
2. Bisedohet me nxënësit për atë që ka ndodhur para se të vinin në shkollë. Ç’punë kanë bërë? Ç’punë kanë bërë dje? Ç’punë kanë bërë gjatë pushimeve verore? Ç’punë kanë bërë para se të shkonin në shkollë, kur kanë qenë të vegjël ...? Nxënësit vënë re se ajo që ka kaluar, ka ndodhur tashmë dhe se ajo i përket së shkuarës.
3. Nxënësit bisedojnë me gjyshen a gjyshin e vet (me stërgjyshen a stërgjyshin) për fëmijërinë e tyre. Si kanë luajtur? Si kanë shkuar në shkollë? Si kanë qenë librat e tyre të mësimi? Çfarë kujtojnë me më shumë dëshirë nga fëmijëria e tyre?
4. Nxënësit sjellin në klasë sendin më të vjetër që kanë në shtëpinë e vet. Përshkruajnë pamjen e tij. Kush ua ka sjell atë? Supozojnë sesa i vjetër është.
5. Vizatohen në kartona të vegjël sendet që kanë përdorur më parë dhe sendet që përdoren tani. Kartonat i grupojnë në bazë të kriterit dikur e tani.
6. Nxënësit grumbullojnë sendet e vjetra e të reja që kanë të njëjtin funksion. Vërejnë e komentojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.
7. Nxënësit nxirren në shëtitje. Vëzhgojnë objektet përreth shkollës. Bëjnë supozimim se cili objekt është më i vjetri dhe cili më i ri. Mbi ç’bazë e kanë bërë supozimin?
8. Vizitohet një shtëpi e vjetër apo muzeu. Nxënësit vizatojnë në klasë shtëpinë e vjetër, muzeun ose sendet e vjetra që kanë parë atje.
9. Në almanakun e shkollës shohin fotografitë e shkollës dikur dhe tani. Në ç’gjë ka ndryshuar pamja e shkollës? Çfarë tjetër ka ndryshuar në shkollë?

Puna me Tekstin mësimor

1. Lexohet teksti i shkruar sipër figurës. Nxënësit shohin fotografitë dhe komentojnë sesi ka jetuar stërgjyshja e Anës. Përshkruajnë pamjen e jashtme të shtëpisë. Vërejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet me shtëpitë e sotme. Prej nga e merrnin dhe si e sillnin ujin? Si duket pjesa e brendshme e shtëpisë? Prej ç’gjëje janë bërë orenditë? Ku gatuanin? Me ç’gjë kanë udhëtuar në të kaluarën njerëzit? Si janë veshur? Si janë argëtuar? Nxënësit përshkruajnë pamjen e lahutës.
2. Në çfarë i ka shkruar stërgjyshja e Anës shkronjat e numrat? Nxënësit krahasojnë jetën e stërgjyshes së Anës me jetën e tyre.



3. Bisedohet për sendet që janë përdorur në të kaluarën. A i kanë parë ndonjëherë dhe ku i kanë parë? Përshkruajnë supozimet e veta se për çfarë janë përdorur. Çfarë përdoret sot në vend të këtyre sendeve?

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit dallojnë në figura se çfarë i përket së kaluarës.
2. Janë dhënë vizatimet e sendeve që janë përdorur dikur. Nxënësit vizatojnë sendet përkatëse me të njëjtin funksion që përdoren sot.

Mjetet ndihmëse	sendet e vjetra (hekuri për hekurosje me prush, feneri, djepi, pendë pate ..., hekuri për hekurosje me korent, shtrati për fëmijë, stilografi ...), kartonat e vegjël me vizatimet e sendeve dikur e tani
----------------------------	---

SHOKË E MIQ

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re se njerëzit që jetojnë ose që punojnë së bashku vendosin marrëdhënie të caktuara reciproke• të zhvillohet mirëkuptimi për ndryshimet midis njerëzve• të vihen re ndryshimet midis marrëdhënieve të dashurisë, të respektit, të kujdesit, të miqësisë e të bashkëpunimit
Fjalë kyçe	mik, fqinj, i njohur, dashuri, kujdes, bashkëpunim, respekt

Veprimtaritë e propozuara

1. Lexohet tregimi (p.sh. "Xixëllonja kërkon shokun") ose shihet filmi. Nxënësit nxjerrin përfundimin për llojin e marrëdhënieve në tregim ose në film (kushërinj, shokë, miq, të njohur). Vënë re veprimet e personazheve. Cilat veprime tregojnë dashuri, cilat kujdes, bashkëpunim e respekt? Kush nuk e tregon një respekt të tillë? Ç'mendim kanë nxënësit për këtë gjë?
2. Nxënësit tregojnë se me kë u pëlqen më shumë që të shoqërohen. Çfarë u pëlqen më shumë tek këta fëmijë? Me kë nuk do të mund të shoqëroheshin? Ç'cilësi nuk u pëlqejnë tek fëmijët e tjerë? Bisedohet për miqtë e familjes. Si shoqërohen? Kur bëjnë më shpesh vizita tek njëri-tjetri.
3. Komentohen situatat në të cilët shfaqet dashuria, respekti, kujdesi e bashkëpunimi. Kur dhe në ç'mënyrë mund t'i shfaqim ato?
4. Nxënësit tregojnë sesi u ndihmojnë shokëve e shoqeve të veta. Si u ndihmojnë njerëzve përreth tyre? Kë ndihmojnë më shpesh? Pse e ndihmojnë pikërisht këtë person?



5. Bisedohet për sjelljen në dyqan. Si pritet në radhë? Nxënësit tregojnë sesi veprojnë, nëse dikush u lutet ta kalojnë radhën? Si veprojnë, nëse edhe ata nxitojnë? Cilat fjalë përdorin (më falni, ju lutem, urdhëroni ...). Si duhet të silllemi në teatër, në bibliotekë ...? Si veprojnë, nëse është fjala për personat me kërkesa të veçanta?

Puna me Tekstin mësimor

1. Komentohen veprimtaritë e fëmijëve në figurë. Kush po bën garë? Në çfarë po bëjnë garë? Si sillen fëmijët pranë pistës së vrapimit? Nxënësit duhet të vënë re sjelljen miqësore të shokëve të Stefanit.
2. Nxënësit shohin fotografinë. Kush u ndihmon nxënësve në klasë? Kush tjetër, përveç mësueses, mund t'u ndihmojë atyre? Ata e kuptojnë se mund t'u ndihmojnë edhe shokët e shoqet.
3. Nxënësit shohin fotografitë e figurat dhe lexojnë tekstet e shkruara poshtë tyre. Përcaktojnë raportet midis personave në fotografi e figura. A janë këta shokë/shoqe, miq, prindër apo të njohur? A bashkëpunojnë, duhen, kujdesen për të tjerët...? Nxënësit flasin për përvojën vetjake.

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit shohin prerjen tërthore të banesës. Cilat familje jetojnë në banesë? Ata u përgjigjen pyetjeve në bazë të vizatimit.
2. Bisedohet për fqinjët (komshinjtë). Kush janë fqinjët e tyre? Me kë shoqërohen më shumë? Cila familje ka më shumë fëmijë? Cila ka më pak? Kush është më i moshuari ndër fqinjët e tyre? Kush e ndihmon më shpesh dhe në ç'mënyrë? Nxënësit plotësojnë fjalitë për fqinjët.
3. Nxënësit shohin vizatimet dhe tregojnë se çfarë është paraqitur në to. Ç'lloj marrëdhëniesh pasqyrojnë ato? Në ç'mënyrë është pasqyruar kjo gjë? Çdo vizatim lidhet me fjalën e duhur.
4. Nxënësit tregojnë me vizatime sesi e shfaqin ata dashurinë dhe kujdesin për të tjerët.

Mjetet ndihmëse

tregimi, filmi



SHKOLLA JONË

Kapitulli i dytë, Shkolla jonë, përmban katër tema mësimi të përafërta: *Në shkollë, Rregullojmë klasën, Këndi i gjallë, Në këndin e lojërave*. Qëllimet që realizohen janë: të çohet përpara dhe të zhvillohet tek nxënësit ndjenja e përkatësisë komunitetit të shkollës me pjesëmarrjen më aktive në ngjarjet e ndryshme në shkollë; të merret pjesë në rregullimin e ambientit në të cilin banojnë dhe në këtë mënyrë të zbatojnë më tej metodat njohëse; klasifikimin, organizimin, bashkimin ... (për ç'gjë është folur më shumë në Librin e mësuesit për klasën e parë), ndërsa hapësirën e bëjnë më funksionale dhe më "të veten"; të mësojnë për nevojat e qenieve të gjalla, duke i kultivuar a mbarështruar ato në ambientin, të cilin e quajmë këndi i gjallë; të mësojnë më shumë për hapësirën e brendshme të shkollës, ndërsa më pas edhe për mjedisin përreth si pjesën përbërëse e ambientit të përgjithshëm për mësim; të dallojnë specifikat e materialeve të ndryshme që përdorin si dhe mënyrat në të cilat ato mund t'i përpunojnë; të mësojnë t'i vënë gjërat në vend dhe të hedhin mbeturinat që krijohen gjatë punës ku duhet; të mësojnë dhe të njohin më shumë për lëvizjen e trupit të vet dhe të sendeve duke njohur gjendjen e baraspeshës.

Ky është viti i dytë që nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën e shkollës. Ata bëhen gjithnjë e më të pavarur dhe më të angazhuar në punë dhe shoqërim. Mësojnë se shkolla ka gazetën, informatorin, garat, seksionet e veta Nxënësit nxiten që të bashkëpunojnë, që të përfshihen në ndonjë veprimtari jashtëshkollore dhe që të informohen për jetën në shkollë. Në këtë mënyrë, nxënësit do të ndjekin e do të marrin pjesë në mënyrë më aktive në ngjarjet në shkollë, do të marrin dhe ndajnë përgjegjësitë për suksesin e shkollës në disa fusha. Ata nxiten që të përfshihen në disa prej këtyre aspekteve të organizimit të nxënësve. Me njohjen më të mirë të hapësirës së shkollës, nxënësit janë të motivuar që këtë ambient ta ndjejnë gjithnjë e më shumë si të vetin. Nxënësit e rregullojnë klasën e vet në mënyrë funksionale dhe sipas kriterëve të përcaktuara në mënyrë të përbashkët, i renditin dhe i sistemojnë sendet, duke ia përshtatur kështu ambientin nevojave vetjake dhe të komunitetit të klasës.

Ata vazhdojnë të njohin veçoritë e materialeve të ndryshme (letrës, kartonit, gurit), si dhe mënyrat e punës me to. E quajmë të dobishme që këtu të përmendet se midis nocionit fortësi dhe i fortë, duhet të bëhet dallimi. Ndërsa fjala fortësi ka të bëjë me gjëndjen agregate, nocionet i butë dhe i fortë përshkruajnë fortësinë e lëndës. Natyrisht, nxënësit e kësaj moshe nuk janë në gjendje t'i vërejnë dhe t'i bëjnë këto dallime, por është e rëndësishme që mësuesi t'i kushtojë kujdes kësaj gjëje, kur bën sugjestionet fillestare. Bisedohet me nxënësit për vetitë e materialeve dhe për mënyrat e punës me to. Disa materiale i modelojmë duke i prerë, duke i këputur apo duke i smeriluar. Materialet e tjera, p.sh. argjilën apo plastelinën, i modelojmë me ngjeshje; prej tyre mund të heqim apo të shtojmë pjesë. Bisedohet me nxënësit se çfarë u nevojitet atyre për punë, si përgatitemi për punë dhe si i planifikojmë veprimtaritë në mënyrë që e tërë ecuria të jetë më e suksesshme. Gjatë punimit të materialeve dhe gjatë punës në

përgjithësi, krijohen mbeturinat, të cilat duhet të hiqen ose, nëse është e mundur, të përdoren për qëllime të tjera. Nxënësit mësojnë se është e rëndësishme që mbeturinat të hiqen siç duhet dhe si kjo gjë mund të bëhet e dëmshme për mjedisin natyror, nëse nuk i kushtojmë kujdesin e duhur.

Në klasën e parë nxënësit kanë sjellë bimë në saksi, ose kemi mbjellë së bashku disa bimë, për të cilat ata janë kujdesur. Në kuadrin e temës së mësimit *Mbjelli* kemi mësuar se çfarë u nevojitet bimëve për rritje dhe për zhvillim. Nxënësit vazhdojnë të kujdesen për bimët e veta edhe gjatë këtij viti shkollor. Mësojnë se çfarë u nevojitet bimëve (të cilat i kultivojnë në këndin e gjallë në klasë ose në oborrin e shkollës) për të jetuar (uji, dheu, ajri, drita). Për këndin e gjallë zgjedhin kafshët kanakare (peshqit e akvariumit, miun, breshkën e ujit ...), të cilat u përshtaten mundësive e kushteve. Për nevojat e kafshëve mësojnë duke i ushqyer dhe duke u dhënë apo ndërruar ujin. Ky është rasti që të mësojnë për mirëmbajtjen e rregullt të higjienës të këtij ambienti. Nëse shfaqen vështirësi të caktuara shëndetësore tek kafshët në zoo-këndin e klasës, ata mësojnë se duhet kërkuar këshilla e specialistit; e veterinerit. Në të gjitha këto veprimtari, fëmijët mësojnë të ndajnë dhe t'i respektojnë detyrat dhe detyrimet në përputhje me marrëveshjen e bërë bashkarisht.

Ambienti për mësime nuk është i lidhur vetëm me hapësirën e klasës. Pjesë e ambientit të përgjithshëm të punës është edhe oborri i shkollës, por edhe vende dhe raste të tjera në të cilat fëmijët mund të mësojnë. Me nxjerrjen e nxënësve në oborrin e shkollës apo në parkun më të afërt, krijohet rasti që përmes lojës të bisedohet për lëvizjen. Nxënësit vënë re se çfarë i vë ata në lëvizje kur janë në kolovajzë. Ata vënë re se për lëvizje nevojitet energjia. Vrojtjnë shilarthin; me çfarë është ndërtuar ai, ku ndodhet mesi, ku janë ndenjset në raport me mesin. Vënë re se boshti ndodhet në mesin e traut, ndërsa ndenjset janë në skaje dhe të baraslarguara nga mesi i traut. Vërejnë se çfarë ndodh, kur ndonjë fëmijë ulet në njërin skaj të shilarthit. Supozojnë se si do të lëvizë trau; poshtë apo lart, kur në të janë ulur dy fëmijë. Vërejnë se pesha ndikon në lëvizjen e traut. Çfarë do të ndodhë, kur fëmijët të zhvendosen drejt mesit të traut? Në ekuilibrin e shilarthit ndikojnë dy madhësi të ndryshueshme: pesha dhe largësia nga boshti/mesi. Nxënësit nxjerrin përfundimin se trupi është në gjëndje qetësie, kur është pozicioni baraspeshe. Krahasohet shilarthi me peshoren. Baraspesha e peshores është e kushtëzuar vetëm nga njëra prej madhësive të lartpërmendura; nga pesha. Për drejtimin dhe mënyrën e lëvizjes të trupit, nxënësit e nxjerrin përfundimin në bazë të gjurmëve.



NË SHKOLLË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të dijnë nxënësit se shkolla ka gazetën e vet, ekipin sportiv• të zhvillohet ndjesia për përkatësinë “shkollës së vet”
Fjalë kyçe	emërtim i shkollës, emërtim i veprimtarive të lira (rrethi i piktorëve, kori, ekip sportiv, rrethi i valleve ritmike ...), titull i revistës së shkollës, klasat nga e 1 ^a deri tek 9 ^a , shenja e klasës (numri, shkronja); gazetë e shkollës, e drejtë, detyrë.

Veprimtaritë e propozuara

1. Organizohet vizita në ambientet e shkollës. Kërkohet tabela me mbishkrimin e emrit të shkollës. Sipas kujt e ka marrë emrin shkolla? Nëse bëhet fjalë për një person, për ç’gjë është i njohur ai? Nxënësit shohin pastaj Tabelën e lajmërimeve. Çfarë gjendet në të? Kujt i dedikohen njoftimet që gjenden në të? Nxënësit vënë re shenjat në dyert e ambienteve të ndryshme. Ata komentojnë funksionin e këtyre ambienteve.
2. Në sallën e mësuesve nxënësit shohin etazhenë për vendosjen e regjistrave.: Vënë re shenjat poshtë regjistrave. Përse nevojiten këto shenja? Kërkojnë vendin ku gjendet regjistri i klasës së tyre. Kërkohet Tabela e lajmërimeve në Sallën e mësuesve. Kujt i dedikohet ajo? Nxënësit vërejnë ndryshimet midis Tabelës së lajmërimeve për mësuesit e asaj për nxënësit.
3. Nxënësit ndahen në dy grupe. Çdo grupi i caktohet nga një profesion i personave të punësuar në shkollë. Nxënësit përgatitin pyetjet, i bëjnë vizitë personit dhe mësojnë sa më shumë për punën dhe detyrat e tij në shkollë e jashtë saj, si edhe për vështirësitë që ndesh në punën e tij. Bëhet informimi për atë që është mësuar.
4. Nxënësit njihen me rrethet/veprimtaritë jashtëshkollore që zhvillohen në shkollën e tyre dhe se çfarë bëhet në këto rrethe/veprimtari jashtëshkollore. Ata zgjedhin sipas interesimit personal.
5. Hartohet histogrami i rretheve jashtëshkollore të zgjedhura. Cili prej tyre frekuentohet nga më shumë nxënës? Çfarë u pëlqen më shumë? Edhe nxënësit e tjerë i komentojnë arsyet për zgjedhjen e rrethit/veprimtarisë së caktuar.
6. Bisedohet për gazetën e shkollës. Si titullohet ajo? Ç’kuptimi ka titulli i saj? Si mund të ndihmojnë nxënësit në redaktimin e gazetës së shkollës.
7. Ndiqen ndeshjet sportive që zhvillohen në kuadër të shkollës. Si duhet të sillemi gjatë ndeshjeve sportive? Bisedohet për tifozllëkun e sjelljen e kulturuar.
8. Nxënësit merren vesh për ekspozitën e klasës dhe për tematikën e saj. Në ekspozitë ftohen prindërit, nxënësit e tjerë, punonjësit e shkollës ...

Puna me Tekstin mësimor

1. Nxënësit shohin fotografitë. Lexojnë së bashku tekstet e shkruara. Vënë re ndryshimet midis shkollave. A mund të konkludohet në bazë të pamjes së



- ndërtesës se ajo është shkolla? Si? Cila prej shkollave ngjason për nga pamja e jashtme me shkollën tënde?
2. Nxënësit dallojnë në fotografi veprimtaritë e ndryshme. Midis veprimtarive, kërkojnë ato që zhvillohen në shkollën e tyre. Si zhvillohen ato? Çfarë bëhet në veprimtaritë e ndryshme? Cila veprimtari u pëlqen më shumë? Në cilat veprimtari marrin pjesë? Në cilën veprimtari do të dëshironin të merrnin pjesë?
 3. Nxënësit shohin figurat dhe i komentojnë ato. Cilat figura paraqesin të drejtat e nxënësve? Cilat pasqyrojnë detyrat? Lexojnë së bashku tekstin e shkruar poshtë figurave. Çfarë do të ndodhë, nëse nuk i respektojmë ato? Bisedohet edhe për disa të drejta e detyra të tjera që nxënësit kanë në shkollë. Cilat të drejta e detyra kanë ata në shtëpi?

Puna me Fletoren e punës

1. Bisedohet për emërtimin e shkollës që frekuentojnë nxënësit. Nxënësit ndihmohen që ta shkruajnë saktë emrin e shkollës, ose ai shkruhet në dërrasë të zezë.
2. Nxënësit gjejnë veprimtaritë që zhvillohen në shkollën e tyre. Çfarë bëhet në veprimtaritë e veçanta? Cila prej tyre u pëlqen më shumë? Në cilat marrin pjesë? Në cilat do të dëshironin të merrnin pjesë? Me vizatim pasqyrojnë veprimtarinë që ekziston në shkollën e tyre, por që nuk është paraqitur me vizatim ose veprimtarinë që do të dëshironin ta kishin.
3. Vizatojnë atë që u pëlqen më shumë të bëjnë kur janë në shkollë.
4. Nxënësit tregojnë se me kë nga klasa dëshirojnë të shoqërohen më shumë. Pse? Shkruajnë në dërrasë të zezë emrat e shokëve e të shoqeve të klasës. Fëmijët ndihmohen gjatë shkrimit. Vëmë re nxënësit që kanë shkruar më pak emra. Bëhen përpjekje që sa më shumë prej tyre të përfshihen në veprimtaritë që kanë të bëjnë me bashkëpunimin reciprok.
5. Bisedohet për vizatimin. Çfarë do të bënin ata, po t'u ndodhte atyre kjo gjë? Lexohet teksti i shkruar dhe ngjyrosen katrori i duhur. Nxënësve u thuhet se për të gjitha problemet që mund të ndodhin në shkollë, ata duhet t'i drejtohen mësuesit të vet, por edhe punonjësve të tjerë të shkollës.

RREGULLOJMË KLASËN

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të modelohen trupa prej materialeve të ndryshme• të përdoren materiale, vegla e procese të ndryshme punimi: kartoni, letra (modelohet, pritët, ngjitet)• të lidhen materiale e procese të ndryshme punimi• të përgatiten nxënësit për punë dhe për sistemimin pas punës• të vihet re se gjatë punës shkaktohen mbetjet që duhet të mënjanohen
Fjalë kyçe	material, letër, karton, proces punimi (modelim, përkulje, palosje, prerje, bashkangjitje, ngjitje, mbetje, rregullim, përgatitje, heqje (largim).



Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit merren vesh për të rregulluar klasën. Ku do t'i vendosin dosjet e nxënësve, dosjet e punëve, lapsat me ngjyra e bojërat, flomasterët e plastelinën? Po gërshërët e zamin ku do t'i vendosin? Bisedohet për rëndësinë e respektimit të kësaj marrëveshjeje. Çfarë do të ndodhë, nëse nuk respektohet kjo marrëveshje?
2. Bisedohet për veglat e punës që përdoren, p.sh. gërshërët. Për vendosjen e stendës mësuesi përdor çekiçin ose diçka të tillë. Organizohet loja e roleve: një fëmijë nxjerr figurat e profesioneve, e sheh atë dhe me pantomimë përpigjet ta luajë rolin e profesionit të pasqyruar në figurë.
3. Nxënësit sjellin në klasë kutinë e këpucëve, rrotullamen prej letërfshirëseje e kutinë rrumbullake të biskotave. Kutitë i zbukurojnë me letër kolazh e me penj dhe i pikturojnë ato. Pas përfundimit të punës i emërtojnë proceset e punimit: kemi palosur, kemi përkulur a përdredhur, kemi prerë, kemi modeluar. Kutitë e zbukuruara mund të shërbejnë për vendosjen e lapsave, të furçave etj. në një vend paraprakisht të caktuar. Vihen re mbetjet që krijohen gjatë punës. Nxënësit e kuptojnë rëndësinë e sistemimit të klasës pas punës.

Puna me Tekstin mësimor

1. Në figurë dallojnë veprimtaritë e ndryshme. Çfarë bën Ana e Iva? Çfarë po zbukurojnë? Me se do ta zbukurojnë? Prej nga i kanë marrë guralecat? Lexohet teksti i shkruar. Ç'mjete pune duhen? Çfarë po bën Markoja? Me çfarë e ka prerë shishen plastike? Çfarë i duhet gjithsej që të bëjë "macen"? Për ç'gjë mund të shërbejë ajo?
2. Vihen re veprimtaritë e ndryshme të nxënësve në klasë. Rëndësi ka që të gjithë në një farë mase të japin ndihmesë në rregullimin e ambientit ku qëndrojnë. Komentohet rëndësia e marrëveshjes.

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit ndjekin udhëzimin dhe bëjnë kutinë e lapsave. Ata udhëzohen se fillimisht duhet të hartojnë planin e punës; me ç'radhë do t'i kryejnë veprimtaritë. Në rrotullamën prej letërfshirëseje ngjitin sipas dëshirës letër kolazhin, vizatojnë sytë e gojën dhe pastaj presin flokët e krahët prej letër kolazhi duke i ngjitur po në rrotullamën prej letërfshirëseje.
2. Komentohet procesi i punimit të detyrës së parë. Shënohet veprimtaria përkatëse.

Mjetet ndihmëse

rrotullame me letërfshirëse, letër kolazhi, gërshërët, zami (ngjitësi), flomasterët, kuti biskotash, penj.



KËNDI I GJALLË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të emërtohen karakteristikat e qenieve të gjalla që jetojnë në mjedisin përreth nxënësve• të thuhet se çfarë u duhet qenieve të gjalla për të jetuar• të kuptohet se qenieve të gjalla u nevojitet ushqimi dhe strehimi• të bëhet lidhja midis materialeve të ndryshme e proceseve të punimit
Fjalë kyçe	gjallesë, kafshë, bimë, ushqim, strehim

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit sjellin në klasë bimë të ndryshme. Ato mbillen në saksi. Bisedohet për vendin ku do të vendosen. Bëhet lidhja me temën "Mbjelli" nga klasa e parë. Çfarë u nevojitet bimëve për të jetuar? Zgjidhet vendin me dritë. Caktohen nxënësit që do të kujdesen e do t'i ujitin rregullisht bimët.
2. Përshkruhet pamja e bimëve. Nga se ngjasojnë ato? Nga se ndryshojnë? Nëse bima ka lule, përshkruhet ajo. Vihet re se bimët kanë gjethet, kërcellin dhe rrënjët? Vihet re se disa bimë kanë lule dhe disa nuk kanë. Nëse nxënësit e kanë sjellë bimën nga shtëpia, ata thonë se kur do të çelë lule dhe si do të jetë lulja.
3. Nxënësit sjellin në shkollë shishe plastike të lëngjeve të frutave dhe penj të ngjyrave të ndryshme. Shishet i ndajnë përgjysmë. Pjesën e poshtme e shpojme në disa vende. Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grupi i jepet nga një fund shisheje i prerë. Bëjnë vazon duke e lyer shishen me zam universal, ndërsa pastaj e veshin me penj. Në saksitë kështu të zbukuruara mund të mbillen lule, grurë ...
4. Arrihet marrëveshja për ndërtimin e zoo-këndit. Cilat kafshë mund t'i mbarshtojme në klasë? Bisedohet për kushtet e nevojshme për mbarështimin e këtyre kafshëve: sa shpesh ushqehen, me se ushqehen, si mirëmbahet higjiena ...? Zgjidhen kafshët që u përgjigjen kushteve të jetesës në klasë (peshqit, miu, breshka e ujit ...). Nxënësit merren vesh për kujdesin ndaj kafshëve.
5. Prej kutisë së kartonit për vezë bëjmë "merimangën". Nevojiten: kutia e kartonit për vezë, katër tela, letër kolazhi, gërsërë dhe sellotejpi. Pritet një majë kutije ("trupi i merimangës"), telat i përdredhim përgjysmë dhe i ngjitim në anën e brendshme të kutisë, në mënyrë që secila gjysmë të formojë dy këmbë të merimangës (gjithsej katër palë). Me letër kolazh bëjmë "sytë" e merimangës dhe e zbukurojmë atë. Në majë përshkojmë një fije spangoje, në mënyrë që merimanga të mund të qëndrojë varur.

Puna me Tekstin mësimor

1. Bisedohet për bimët e kafshët për të cilat nxënësit mund të kujdesen, t'i mbarështojnë e t'i kultivojnë në klasë. Komentohet figura. Çfarë po bëjnë Lejla, Milica dhe Aleksi. Nxënësit që kanë akuariume në shtëpi, tregojnë sesi



- i ushqejnë peshqit në to. Sa shpesh e ndërrojnë ujin e akvariumit dhe si e bëjnë këtë gjë? Tregohet sesi ndërrohet uji në akvarium (peshqit hidhen me rrjetë në enën me ujë, zbrazet uji nga akvariumi dhe mbushet ai me ujë të freskët të ndenjtur, ndërsa pastaj i kthejnë peshqit. Supozohet pse duhet të ndërrohet rregullisht uji. Çfarë nevojitet për rritjen e rregullt të bimëve? Si kultivohen ato?
2. Komentohet vizatimi. Kush është miku i paftuar (merimanga)? A kanë parë ndonjëherë merimangë në shtëpinë vet? Ku e bën më shpesh rrjetën e vet merimanga? Për ç'gjë i shërben ajo? Bisedohet për kafshët e tjera që janë "miq të paftuar" në shtëpi (mizat, milingonat ...).

Puna me Fletoren e punës

1. Ndërtohet shtëpia për merimangën. Rëndësi ka që mbi kavanoz të vihet garza dhe që merimanga të ushqehet. Lexohen tekstet e shkruara në enciklopedi për merimangën dhe mësohet se me çfarë ushqehet. Vrojtohet sesi e ndërton rrjetën merimanga. Me se duhet ta ushqejmë merimangën?
2. Vizatohet rrjeta e merimangës. Krahasohet ajo me rrjetën që kanë mësuar ose me rrjetën që ndërton merimanga në kavanoz, Vihet re se rrjeta shërben si mjet gjuetie.

Mjetet ndihmëse

kavanoz qelqi, garza, lastik për kavanoza, dheu, degë e vogël druri, pak gjethe, shishe plastike për lëngje frutash, penj, ngjitës (zam) universal, kuti kartoni për vezë, letër kolazh, gërshërët, teli.

NË KËNDIN E LOJËRAVE

Qëllimet

- të njihet gjendja e baraspeshës
- të vihet re se trupat në lëvizje mund të ndalen

Fjalë kyçe

drejtim (kahje) e lëvizjes (poshtë, përpjetë, para, prapa), lëkund, kolovit, pjatë, më rëndë, me lehtë, ndal, baraspeshë.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës ose në këndin e lojërave, ku është shilarthi, kolovajza Vrojtajnë e përshkruajnë se prej ç'pjesësh përbëhet shilarthi. Prej ç'materiali janë pjesët e tij? Prej ç'materiali tjetër mund të ndërtohen ato? Si është lidhur shilarthi me truallin? Ku gjenden ndenjëset në shilarth? Sa ndenjëse janë? Si janë të vendosura ndenjëset në raport me boshtin?



2. Zgjidhen dy fëmijë me peshë të ndryshme. Çfarë ndodh, kur ulen në ndenjësë (fëmija më i rëndë lëviz poshtë, kurse fëmija më i lehtë zhvendoset lart)? Cila ndenjësë është zhvendosur lart dhe cila poshtë? Pse? Çfarë ndikon në lëvizjen e shilarthit? Nxënësit vënë re se me anën e shilarthit mund të përcaktojnë se kush është më i rëndë dhe kush është më i lehtë.
3. Zgjidhen dy fëmijë me peshë përafërsisht të njëjtë. Fëmijët ulen në shilarth duke qenë të baraslarguar nga mesi i traut. Nxënësit e tjerë shohin lëvizjen dhe largësinë e skajeve të shilarthit nga trualli. Atyre u bëhet e ditur se shilarthi do të jetë në baraspeshë, nëse në të qëndrojnë dy nxënës me të njëjtën peshë. Nxënësit ndërrohen në mënyrë alternative dhe përcaktojnë se kush është më i rëndë, kush është më i lehtë dhe kush ka peshë të njëjtë. Qëllimi është që ata të kuptojnë se shilarthi është në baraspeshë, kur skajet e tij janë të baraslarguara nga trualli.
4. Nxënësit me peshë përafërsisht të njëjtë ulen në shilarth. Njëri prej tyre zhvendoset në drejtim të mesit të traut. Çfarë vihet re? Qëllimi është që nxënësit të nxjerrin përfundimin se lëvizja e shilarthit nuk varet vetëm nga pesha e nxënësit, por edhe nga largësia prej mesit të traut.
5. Vizitohet shilarthi në baraspeshë.
6. Në këndin e lojërave vrojtojnë kolovajzën. Përshkruhet pamja e saj. Prej ç'pjesësh përbëhet ajo? Prej ç'materiali janë pjesët e saj? Prej ç'materiali tjetër mund të ndërtohen ato? Bisedohet për funksionin e pjesëve të veçanta. Si lëvizet në kolovajzë? Nxënësit tregojnë në kolovajzë, sesi lëvizin me anën e lëvizjeve të trupit. Emërtohen lëvizjet: para, prapa. Çfarë bëjnë, kur duan të lëvizin më shpejt? Çfarë bëjnë, kur duan të ndalen?
7. Vizitohet tregu i fruta-perimeve. Nxënësve u sqarohet paraprakisht se do të shohin peshoret për matjen e peshës. I krahasojnë peshoret për nga pamja dhe për nga mënyra e peshimit. Vrojtohet peshorja me pjata. Vihet re se ajo funksionon sipas të njëjtit parim sikurse shilarthi; pjatat janë të vendosura në baraslargësi nga mesi, vetëm se në njërin pjatë vihet malli që blihet, kurse në tjetrën guri i peshores me peshë të caktuar. Si e dijmë se kemi blerë 1 kg patate?
8. Sillet në klasë peshorja me pjata. Nxënësit matin sendet e ndryshme të klasës (fletoret, këllëfët e mjeteve të mësimin ...) dhe përcaktojnë se çfarë është më e rëndë. Pesha mund të përcaktohet me gurët e peshores. I matin peshat duke i vënë gurët e peshores deri sa pjatat të jenë në baraspeshë.
9. Prej varëses prej teli përgatitet peshorja. Në skajet e varëses varen dy shishe plastike. Shishet shpohen poshtë cepit në tri vende dhe në to përshkohen tri spango me gjatësi të barabartë. Spangot i lidhim nyje dhe i varim në anët e varëses. Varësen e varim në shkopin e vendosur mes dy karrigeve. Nxënësit lënë në gota sende të ndryshme dhe i krahasojnë sipas peshës.
10. Shohin peshoret e së kaluarës ose fotografitë e tyre. I krahasojnë me peshoret që përdoren sot. Ç'peshore kanë në shtëpi? Çfarë matin me të?



Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet dhe komentohet figura. Çfarë bëjnë fëmijët në figurë? Çfarë po bën Markoja? Si luhatet fëmija pranë tij? Vihet re se Markoja luhatet vetëm, ndërsa fëmijën pranë tij e luhat një person tjetër. Shihen dy fëmijë në shilarth. Kush prej tyre është më i rëndë? Si e kuptojnë këtë? Çfarë do të ndodhte, nëse djaloshi do të ulej në ndenjësën e parme të shilarthit?
2. Shihen e përshkruhen lëvizjet që bën Markoja, që të luhatet. A i lëviz vetëm këmbët? Si ndalet (ndërpret lëvizjen)? Nxirret përfundimi se mund të luhatemi vetëm, nëse bëjmë lëvizje me trup dhe se, nëse nuk ka më forcë (prej tjetrit a prej vetes) kolovajza me kalimin e kohës do ta ndërpresë lëvizjen, d.m.th. do të ndalet.

Puna me Fletoren e punës

1. Nga Shtojca numër 1 ngjiten fotografitë e fëmijëve, pesha e të cilëve i përgjigjet pozicionit të shilarthit.
2. Nxënësit ndërtojnë peshoren prej vazos plastike e vizores. Ndhimohen që të caktojnë mesin e vizores. Në cepat e vizores vendosen monedhat metalike prej 20 centësh. I renditin monedhat dhe e vënë vizoren në baraspeshë. Vihet re se peshorja do të jetë në baraspeshë, kur në të dyja anët e vizores vihen numri i njëjtë i monedhave (në ç'rast monedhat duhet të jenë të baraslarguara nga vazoja).
3. Ç'gurë të peshores duhet të vihen në pjatën boshe, që peshorja të jetë në baraspeshë?

**Mjetet
ndihmëse**

vizorja, monedha metalike, vazo plastike, peshorja e vjetër, varësja prej teli, ena plastike, spangoja.



RETË DHE ERA

Në kuadrin e kapitullit “Retë dhe era”, do të shqyrtojmë katër tema mësimi të ngjashme dhe logjikisht në lidhura me njëra-tjetrën: *Moti, Ka ardhur vjeshta, Më thuaj me figura dhe Dita e nata.*

Qëllimet kryesore janë: nxënësit të shohin dhe të përshkruajnë ndryshimet në natyrë; motin (kushtet klimatike), ndryshimet e bimëve, ndryshimet në veprimtarinë e kafshëve; të gjejnë lidhjen midis motit dhe ndryshimeve tek bimët e veprimtaritë e kafshëve dhe të vërejnë se dukuritë në natyrë përsëriten në mënyrë ciklike, të vënë re dhe të përshkruajnë veprimtaritë e njerëzve në vjeshtë; të përshkruajnë dhe të kuptojnë ndërrimin e ditës dhe të natës, të vënë re lëvizjen imagjinare të Diellit gjatë ditës, të vënë re se gjatësia e ditës në periudhën e vjeshtës dallohet me atë në periudhën e verës; të mësojnë se njerëzit mund të merren vesh me shenja dhe me simbole e vizatime paraprakisht të caktuara.

Vitin e kaluar shkollor e kemi filluar rrëfimin për stinët e vitit. Nxënësit kanë vënë re ndryshimet tek bimët dhe veprimtaritë e kafshëve e të njerëzve. Gjatë një jave kanë ndjekur motin, kanë vrojtuar pamjen e bimëve në vjeshtë, dallimet midis bimëve jogjetherëne dhe gjethembajtëse, kanë bërë koleksione të gjethëve, kanë vëzhguar kafshët dhe veprimtarinë e njerëzve në vjeshtë. Edhe gjatë këtij viti shkollor do të mësojnë për ndryshimet ciklike në natyrë, d.m.th. për ndërrimin e stinëve të vitit përmes veprimtarive të ndryshme dhe duke zbatuar mënyrat e ndryshme të njohjes (vëzhgimin, krahasimin, sistemimin ...). Nxënësit ndjekin motin dhe mbajnë shënime për të. Ata thellojnë njohuritë për bimët; krahasojnë gjethet e drurëve gjetherëne me halat e drurëve gjethembajtës, vërejnë se shumë bimë në vjeshtë prodhojnë frytet etj. Vrojtajnë zogjtë e kafshët e tjera dhe veprimtaritë e tyre në vjeshtë. Vërejnë sesi “përgatiten” kafshët për dimër. Kushtet klimatike në vjeshtë dhe në përgjithësi ndryshimet në natyrë pasqyrohen edhe në veprimtarinë e njerëzve. Bisedohet për veprimtaritë që ndërmarrin njerëzit në fshat, për atë që ngjan në qytet, për atë që ndërrojnë nxënësit në sjelljen dhe në veprimtaritë e veta në këtë periudhë. Do të ishte mirë, sa herë që të krijohet rasti, t’u mundësohet nxënësve që të dalin në natyrë dhe të mësojnë përmes përvojës së drejtpërdrejtë.

Nxënësit thonë veprimtaritë e veta në pjesë të ndryshme të ditës: çfarë bëjnë në mëngjes, gjatë ditës, në mbrëmje? Vënë re karakterin ciklik të veprimtarive, i cili i përgjigjet ndërrimit ditë-natë. Rrjedha e kohës dhe radha e veprimtarive tona në sekuencat e ndryshme të kohës, varet nga rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit. Toka rrotullohet rreth boshtit të vet gjatë një dite (24 orëve). Gjatë rrotullimit, një pjesë e sipërfaqes së saj është e ndriçuar, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në errësi. Pasoja e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj është ndërrimi i pjesës së ndriçuar të ditës me pjesën e errët të saj (dita me ditë dhe nata). Dielli e ndriçon dhe e ngroh Tokën, për ç’arsye ndryshon temperatura e ajrit gjatë ditës dhe natës. Gjatë natës është errësi, prandaj edhe bën më ftohtë sesa gjatë ditës. Ndërrimi i ditës me natën pasqyrohet edhe në sjelljen e bimëve, të kafshëve e të njerëzve. Disa bimë i mbyllin lulet e veta gjatë ditës. Edhe kafshët janë aktive me ndryshime ditën dhe natën. Disa janë më aktive gjatë ditës, ndërsa disa të tjera gjatë natës, p.sh. bufi gjuan natën, fluturat e natës dhe lakuriqët e natës orientohen me lehtësi natën. Pozicioni i Diellit në qiell tregon se ç’pjesë e ditës



është; në mëngjes Dielli ndodhet poshtë mbi horizont, në mesditë ndodhet lart, pastaj ulet dhe në mbrëmje ndodhet poshtë në qiell.

Dielli ngroh jo vetëm ajrin, por edhe sipërfaqet ujore në Tokë. Uji avullon, ngrihet lart në shtresat më të larta të atmosferës, kondensohet. Kështu krijohen retë. Bisedohet me nxënësit për këtë. Ata shohin jashtë retë në qiell, formën e tyre, ngjyrën dhe drejtimin e lëvizjes. Era i shtyn retë dhe u ndryshon atyre formën. Ajo mund të ketë forcë të ndryshme. Erërat marrin shpesh emërtimin sipas drejtimit nga fryjnë. Në vende të caktuara fryjnë shpesh erëra të caktuara. Era e veriut sjell ajrin e ftohtë, ndërsa juga ajrin e ngrohtë dhe sjell re, sepse fryn nga deti drejt tokës. Era mund të jetë e fuqishme dhe të shkaktojë dëme. Por, shpesh flasim për efektet pozitive të saj. Era mundëson shpërndarjen e bimëve (përhap polenin dhe farërat) dhe u lehtëson zogjve fluturimin. Energjia e erës është shfrytëzuar dikur për lëvizjen e anijeve me vela, ndërsa sot shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

Nxënësit nxiten që të përshkruajnë ndryshimet e motit, të vërejnë lidhjet midis periudhës së ditës dhe temperaturës së ajrit, reve dhe reshjeve, temperaturës së ajrit dhe erës. Për t'i ndjekur ndryshimet, ata mbajnë evindencën për motin. Vrojtjnë kushtet klimatike dhe shënojnë në tabela me simbole e me figura. Vitin e kaluar shkollor kanë njohur disa simbole (mot me diell, mot me re, mot me shi), ndërsa tani e zgjerojnë këtë gjë dhe mësojnë simbolet e reja; mot pjesërisht me re, mot me erë, mot me mjegull. Në këtë mënyrë e ndjekin motin më saktësisht dhe paksa më gjatë, mësojnë më shumë për lidhjen e tij me dukuritë e tjera natyrore; lidhin reshjet me retë, temperaturën me erën dhe kohën e ditës, si dhe me vendin ku jetojnë. Vënë re lidhjen midis motit dhe veprimtarive të njerëzve. Në këtë mënyrë mësojnë për kushtëzimin reciprok dhe varësinë e ndërsjellë midis dukurive e proceseve natyrore. Këto nocione fillestare do t'i zgjerojnë me përmbajtje, me lidhje e kuptime të reja gjatë shkollimit të mëtejshëm.

Informacionet i marrim me anë të shenjave të ndryshme, d.m.th. të mesazheve, që përmbajnë. Shenja për postën është letra, kur i është rënë vizë do të thotë se diçka s'ka ose se është e ndaluar etj. Me shenjat nxënësit janë marrë edhe vitin e shkuar shkollor; kanë mësuar se shenjat e qarkullimit rrugor janë krijuar si rezultat i marrëveshjes precize të njerëzve për mënyrën e sjelljes në qarkullimin rrugor dhe se ato mundësojnë orientimin funksional të pjesëmarrësve me jetën e komunikimit. Kuptimi i mirë i shenjave është i rëndësishëm, ndërsa për këtë nevojitet përvoja. Shenjat mund të jenë dakorduar e të përcaktuar në disa rrethe të ngushta, p.sh. në shkollë, në klasë dhe ato për të gjithë ne kanë mesazhin e përbashkët. Shenjat e vizatuara të plotësuara me tekst janë të thjeshta e të kuptueshme. Gjithashtu shenjat mund të krijohen edhe me ndonjë marrëveshje më të gjërë, si për shembull, shenja për parkingun ose për farmacinë.

Mesazhet mund të jenë të vizatuara dhe të shkruara (lajmërimet, pllakatet ...), me zë (boria e makinës së policisë ose e ambulancës) të shprehura me lëvizje (polici i qarkullimit rrugor). Mesazhet e vizatuara kuptohen lehtë edhe për të huajt, bile edhe për analfabetët. Mesazhet mund të jenë personale ose publike. Transmetimi i informacioneve mundëson realizimin e komunikimit në nivele të ndryshme dhe organizimin efikas të jetës shoqërore.

Me anën e shenjave të vizatuara mund të paraqiten dukuritë, objektet dhe ligjësitë në shkencat natyrore dhe në teknikë. Në këtë mënyrë sigurohet paraqitja tërësore dhe e qartë e ndonjë objekti, dukurie apo ligjësie. Vizatimi është më ekonomik sesa të shkruarit dhe shpjegimet verbale, sepse me më pak shenja jepet shpjegimi më tërësor dhe më i plotë. Sa më shumë të përdorim shenja të ndryshme, e kuptojmë më lehtë kuptimin e tyre të vërtetë.



MOTI

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruhen dukuritë që përsëriten në natyrë • të njohin dukuritë e motit: re, shi, erë • të vënë re se ndryshimet në mjedisin përreth janë nganjëherë të këndshme dhe nganjëherë të dëmshme për kafshët e bimët
Fjalë kyçe	mot: i kthjellët, i vrenjtur (me re), pjesërisht i vrenjtur, me mjegull, me erë; reshjet: shi, borë; fatkeqësi natyrore: përmytje, thatësi.

Veprimtaritë e propozuara

1. Vëzhgohen kushtet e motit. Përshkruhet moti ekzistues (me re, me erë, me shi, me mjegull, i ftohtë, i ngrohtë ...). Bisedohet për veprimtaritë e njerëzve në përputhje me kushtet e motit.
2. Përgatitet stenda për kushtet e motit duke përdorur simbolet figurative për motin.
3. Gjatë ditëve me shi, mblidhet shiu në një tas të cekët. Në shishen prej qelqi ngjitet etiketa e ditës (e hënë, e martë ...) dhe shiu i mbledhur në tasin e cekët hidhet në shishe. Nxirret përfundimi se kur ka rënë më shumë e më pak shi gjatë vrojtimit.
4. Mblidhet shiu në enë të formave të ndryshme (shishe, gotë, tas). Krahasohet se në cilën enë është mbledhur me shumë shi. Cila enë është më përshtatshme për mbledhjen e ujit (e ngushtë dhe e thellë, e gjerë dhe e cekët, e gjerë dhe e thellë)?
5. Nxënësit nxirren në shëtitje në një ditë me erë. Vihet re se çfarë vë në lëvizje era. Si përkulen drurët? Cila pjesë e bimës përkulet?
6. Përgatitet shkopi me shirita prej letre. Mbi bazën e lëvizjes së shiritave përcaktohet drejtimi në të cilin fryn era.
7. Nxënësit vizatojnë një ditë me shi e me erë.
8. Vrojtohen retë. Çfarë u kujtojnë ato nxënësve? Nxënësit vizatojnë renë më të bukur.
9. Nxënësit përgatitin çadrën e shiut me fije penjsh. Nevojiten: një gjysmë tape shisheje; 7-8 kruese dhëmbësh, penj, gjysmë shkopi për shishqebap. Në pjesët anësore të tapës ngulin krueset e dhëmbëve në distancë të barabartë nga njëra-tjetra. Një copë peri e lidhin pas një kruese. Mund ta ndërrojnë bojën e perit. Në pjesën e poshtme të tapës ngulin një shkop shishqebapi si doreza e çadrës.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura dhe lexohet teksti. Pse i pëlqen Markos e Anës kur fryn erë? Ç'gjë tjetër në figurë vë në lëvizje era? Komentohen simbolet e kushteve të motit.
2. Shihen fotografitë dhe lexohet teksti. Si ndryshon koha? Kur lahemi në det? Çfarë sjellin retë? Çfarë ndodh, kur bëhet ftohtë menjëherë? Kur bie më shpesh bora? Bisedohet për kushtet e motit në stinët e ndryshme të vitit.



3. Shihen fotografitë dhe lexohet teksti. Çfarë vë në lëvizje era? Ç'fatkeqësi natyrore mund të shkaktojë era? Tregohet përvoja vetjake lidhur me situatat me erë të fortë. Ku dhe si mund të përdorin fuqinë e erës?
4. Bisedohet për ujin e shiun. Për çfarë përdoret uji? A i duhet uji bimëve e kafshëve? Çfarë ndodh, kur ka me tepri ujë? Tregohet përvoja vetjake lidhur me këtë gjë. A është lagur ndonjëherë ndokush? Sa ujë pijnë gjatë një dite? Kur pihet më shumë shi? Shihen figurat dhe lexohet teksti. Çfarë ndodh, kur bie shumë shi? Si është sipërfaqja e tokës në figurë? Pse është plasaritur toka? A është një tokë e tillë e butë apo e fortë? Në cilën stinë të vitit bie mjaft shi? Kur bie më pak shi?

Puna me Fletoren e punës

1. Duke shfrytëzuar simbolet për të cilët bihet dakord, shënohet koha (moti) i çdo dite gjatë dy javëve. Kjo gjë mund të bëhet për dy stinët e vitit. Kur të plotësohen, tabelat krahasohen. Kur ka pasur më shumë ditë me diell dhe kur me re? Kur ka rënë më shumë shi? Kur ka rënë borë?
2. Vizatohet dita me shi.
3. Shihen vizatimet, komentohen dhe ngjyroset gjëja që vihet në lëvizje nga era.
4. Vihet re se në ç'drejtim fryn era? Në ç'mënyrë është treguar kjo gjë? Në çdo vizatim tregohet me shigjetë se në ç'drejtim fryn era.
5. Duke ndjekur udhëzimet e shtojcës numër 2, nxënësit ndërtojnë helikat prej ere. Palosin letrën siç duhet dhe e ngulin në shkopin prej druri. Helikat prej letre tregojnë drejtimin nga fryn era.

Mjetet ndihmëse	enë të ndryshme (të gjera, të ngushta, të cekëta, të thella), shkopin, shirita prej letre, tapa e shishes, kruese dhëmbësh, penj, shkopin shishqebapi.
----------------------------	--



KA ARDHUR VJESHTA

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të përshkruhen ndryshimet e natyrës që ndodhin në vjeshtë• të vihen re veprimtaritë e njerëzve, të bimëve e të kafshëve në vjeshtë• të zhvillohet kuptimi për lidhjen reciproke midis qenieve të gjalla
Fjalë kyçe	vjeshtë, stinë e vitit, zog shtegtar, zog joshtegtar, drurë gjetherënës, drurë gjethembajtës, fryt, fryt pylli

Veprimtaritë e propozuara

1. Në oborrin e shkollës ose në mjedisin përreth kërkohet druri gjetherënës dhe druri gjethembajtës. Vihen re dhe thuhet dallimet në pamjen e tyre. Krahasohen gjethet e drurit gjetherënës me gjethet e drurit halor gjethembajtës. Nga se dallohen? Vrojtohet toka nën drurin gjethembajtës. A i bien gjethet edhe drurit gjethembajtës?
2. Vizatohet druri gjethembajtës dhe druri gjetherënës.
3. Mblidhen gjethet. Krahasohen për nga forma, ngjyra, madhësia e trashësia. Supozohet se ç'drurëve aty pranë i përkasin (nuk duhet të mësojnë emërtimet e drurëve).
4. Mblidhen e presohen gjethet. Në hamer bëhet kolazhi i vjeshtës, ndërsa kjo gjë mund të jetë edhe një tregim me figura. Për këtë duhet letra hamer, gjethet e thata të ngjyrave e të formave të ndryshme, zam (ngjitës) universal.
5. Përgatitet në klasë druri i vjeshtës. Prej druri, polisteroli ose kartoni bëhet trunci. Mbështillet trunci me pëlhurë me ngjyrën e duhur. "Trunci" varet në një hamer më të madh që është i varur në mur. Përqark truncut vizatohen degët dhe ngjiten gjethet.
6. Bisedohet për motin (kohën). Si ka ndryshuar ai në krahasim me fillimin e vitit shkollor? Përgatitet kalendari i motit për një javë.
7. Lexohen tekstet e shkruara për zogjtë (janë të përshtatshëm tekstet e shkruara nga Libri i leximit: "Për herë të parë" dhe "O dimër, kujdes zogjtë"). Bisedohet për shtegtimin e zogjve. Thuhet mendimet personale për atë se ku shtegtojnë zogjtë dhe pse shtegtojnë ata.
8. Nxënësit ulen në rreth. Një nxënës duhet të thotë fjalinë për një zog të zgjedhur që njihet edhe nga nxënësit e tjerë. Çdo nxënës shton nga një fjali për të njëjtin zog, derisa thuhet të gjitha njohuritë për të. Lojtari në vazhdim mund të zgjedhë një zog tjetër. Në të njëjtën mënyrë mund të zhvillohet loja me temë kafshët e pyllit (iriqin, ariun, ketrin ...).
9. Organizohet vizita në parkun ose në pyllin e afërt. Vihen re ndryshimet në natyrë dhe komentohen. Çfarë ka ndryshuar në raport me verën? Mblidhen boçe pishë dhe frytet e tjera (lënde pylli, gështenja, arra, lajthi) dhe përgatitet materiali për punën në klasë.
10. Bëjnë hutin prej boçe. Me ngjitjen e me ngjyrosjen e farave të boçes bëjnë figura muri e korniza dhe zbukurojnë kutitë.



Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura e pyllit në vjeshtë. Emërtohen banorët e pyllit. Komentohet pamja e drurëve. Vihet re se gjethet dallohen për nga ngjyra.
2. Emërtohen frytet e pyllit në vjeshtë. Cilët prej tyre përdoren si ushqim nga njerëzit? Çfarë mund të përgatitet prej tyre? Çfarë mund të përgatitet prej gështenjave? Kush ushqehet me lënde (boçe) druri?
3. Shihet figura e qytetit në vjeshtë. Ç'Veprimtari zhvillohen në qytet? Ç'punë bëjnë të rriturit? Në ç'gjë mund të ndihmojnë fëmijët?
4. Bisedohet për zogjtë. Emërtohen zogjtë shtegtarë e joshtegtarë. Çfarë do të thotë fjala "shtegtarë" dhe fjala "joshtegtarë"? Cilët prej këtyre zogjve i kanë parë në mjedisin përreth? A shtegtojnë zogjtë në grupe apo një nga një? Si quhet grupi i zogjve?

Puna me Fletoren e punës

1. Vizatohet druri në stinën e vjeshtës.
2. Bëjnë varkën me lëvore arre, me plastelinë, me kruesen e dhëmbëve dhe me gjethe.
3. Përkrah fotografisë së zogut (të dhënë në tabelë) shkruhet emri i duhur (dallëndyshe, huti, mëllenja, çafka, harabeli, pëllumbi), ndërsa pastaj shenjën që tregon, nëse zogu është shtegtar apo joshtegtar.

Mjetet ndihmëse

letër hameri, kartoni, pëlhura, stiropori, letër kolazhi, bojërat akuarel, lëvorja e arrës, lënde druri, kruese dhëmbësh, gjethe, plastelina

MË THUAJ ME FIGURA

Qëllimet

- të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve
- të ushtrohen nxënësit që me teknologji të thjeshta t'i përdorin e t'i ruajnë të dhënat

Fjalë kyçe

ajër, vizatin, sinjal zanor, kompjuter, telefon celular, shigjetë, renditje.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren në shëtitje. Shohin mbishkrimet në ndërtesa, në objektet me funksione të ndryshme dhe shenjat e qarkullimit rrugor. Bëhet e ditur se në këtë mënyrë mund të ruhen disa të dhëna. Komentohen sinjalet zanore që dëgjohen.



2. Bëhet stenda me fotografitë e përgatitura. Nxënësit mund t'i vizatojnë mbishkrimet e shenjat që kanë parë gjatë shëtitjes dhe ua shtojnë ato fotografive.
3. Organizohet loja me pantomima. Me lëvizjet e trupit i jepen udhëzime shokut/shoqes që të fshijë dërrasën e zezë, t'i lajë duart, ta mprehë lapsin, t'i ujisë lulet ...
4. Bisedohet për gjuhët e huaja. Thuhen fjalët që dihen në gjuhë të huaj. Bëhet e ditur se ç'gjuhë është kjo dhe ç'kuptim kanë fjalët.
5. Prezantohen shenjat me të cilat merren vesh personat shurdhmemec. Vihen re se ata merren vesh me lëvizjet e duarve e të gishtërinjve.
6. Sqarohet sesi lexojnë njerëzit me shikim të dobët (miop). Sillet një ekzemplar teksti i shkruar me alfabetin e Brajtit. Me mollëzat e gishtërinjve preken puprizat në letër.
7. Bihet dakord për veprimtaritë që do të zhvillohen në klasë (ujitja e luleve, ajrimi i klasës, fshirja e dërrasës së zezë ...). Veprimtaritë paraqiten me vizatime dhe ngjiten në stendë. Poshtë stendës ngjitet fletushka me emrat e nxënësve që do t'i kryejnë ato gjatë javës. Javën pasardhëse ndërrohen emrat e nxënësve.
8. Organizohet vizita në dyqanin e vetëshërbimit në afërsi të shkollës. Vihen re shenjat që ndodhen në hyrje të dyqanit të vetëshërbimit. Ç'kuptim kanë ato? Kërkohen shenjat brenda dyqanit të vetëshërbimit. Çfarë është theksuar në to? Cilat shenja janë nxjerrë në pah? Pse? Çfarë tregojnë ato?
9. Në dokumentin e veçantë, në kompjuter, shkruajmë emrat e nxënësve dhe numrat e telefonave. Nxënësit bëjnë propozime për emërtimin e dokumentit.
10. Në Tekstin mësimor dhe në Fletoren e punës kërkohen shenjat që paraqitin veprimtaritë e ndryshme. Sqarohet se ç'kuptim kanë këto shenja dhe si lexohen ato.
11. Nxënësit sjellin në shkollë stripin. Formohen grupet e nxënësve dhe çdo grupi i jepet nga një ekzemplar stripi. Lexohet stripi. Çfarë do të ndodhë, nëse e ndërrojmë renditjen e vizatimeve?

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura ilustruese e familjes së Anës. Për çfarë bisedojnë? Pse dëshiron të dijë Ana se ç'mot do të jetë nesër. Çfarë do të ndodhë, nëse bie shi? Në ç'mënyrë do të marrë vesh Ana sesi do të jetë koha? Si mund ta mësojmë ndryshe parashikimin e motit?
Komentohet vizatimi në të cilën është paraqitur parashikimi i motit i dhënë në gazetë. Komentohet moti për tri ditë. Si do të jetë moti në ditët e ardhshme? A do të shkojë Ana në piknik? Mbi ç'bazë nxirret ky përfundim?
2. Bisedohet për atë se disa informacione mund të mësohen me anë të figurës ose të sinjalit zanor. Shihet fotografia a autoambulancës së ndihmës së shpejtë: Nga ç'gjë do ta marrim vesh se autoambulanca po vjen edhe para se ta shohim atë (nga sinjali zanor; sirena)? Ç'automjete të tjera mund të sinjalizojnë në të njëjtën mënyrë (automobilat e policisë e të zjarrfikësve)? Tregohet, nëse dihet për ndonjë sinjalizim tjetër zanor (zilja e shkollës, bilbili i policit, sirena e trenit ...).
Shihen vizatimet dhe shpjegohet kuptimi i tyre. Ku vihen re këto shenja?



3. Bisedohet për përdorimin e telefonit celular. Ç'gabim ka bërë Lluka? Kur nuk duhet ta përdorim telefonin celular (në orën e mësimet, në teatër, në kinema, gjatë vizitës tek mjeku...)? Nxënësit duhet të mësojnë se duhet të tregojmë kujdes që me sjelljen tonë të mos u bëjmë dëm të tjerëve. Kjo gjë është e mundur, nëse i respektojmë rregullat. Disa rregulla janë të shkruara, për disa bihet dakord me gojë. Rregullat duhen respektuar.

Puna me Fletoren e punës

1. Lexohen tekstet e shkruara dhe ngjiten figurat nga Shtojca numër 3.
2. Çfarë paraqitin figurat? Ku tjetër janë parë figura si këto? Shihen figurat dhe shkruhet kuptimi që kanë. Nuk është e nevojshme të shkruhen tekstet e plota, mjafton të shkruhet shkurtimisht përshkrimi i kohës, përkatësisht i përmbajtjes së udhëzimit për përgatitjen e supës dhe ai i fazave të rritjes së bimës.

Mjetet ndihmëse

aparati fotografik, stenda me alfabetin për shurdhmemec, alfabeti i Brajtit, stripi.

DITA DHE NATA

Qëllimet

- të vihet re lidhja midis lëvizjes së Diellit dhe pjesëve të ditës
- të zhvillohet kuptimi për ditën me dritë e natën

Fjalë kyçe

ditë, natë, mëngjes, paradite, mesditë, pasdite, mbrëmje, muzg, Dielli lind, Dielli perëndon, lindje, perëndim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Përshkruhet ndryshimi midis ditës (ditës me dritë) e natës.
2. Bisedohet për veprimtaritë me të cilat fillohet ditën (ngrihemi, lahemi, lajmë dhëmbët, ha mëngjes). Çfarë bëhet pas kësaj? Kur bëhet nisja për në shkollë? Çfarë bëhet më shpesh, pas kthimit nga shkolla? Ç'detyrime (detyra) janë të përcaktuara për paradite dhe cilat për pasdite? Çfarë bëhet zakonisht pas ngrënies së drekës? Me ç'veprimtari përfundohet zakonisht dita? Në ç'orë shkohet për të fjetur? Sa orë flihet? Bisedohet për rëndësinë e gjumit. Nxënësit duhet ta kuptojnë se për një jetë të shëndetshme është e nevojshme të flihet më e pakta tetë orë.
3. Çfarë bëjnë gjatë ditës anëtarët e familjes? A punon ndonjë prej tyre gjatë natës?
4. Bisedohet për mënyrën sesi e imagjinojnë nxënësit fillimin dhe mbarimin e ditës. Ku "shkon" Dielli? Shpjegohet se sipas pozicionit të Diellit mund të dijmë se ç'kohë e ditës është. Vihet re se kur është më lart në qiell Dielli.



5. Nëse ekziston mundësia (Shkolla në natyrë) organizohet vrojtimi i perëndimit të diellit. Gjatë vrojtimit mund të vizatohet ajo që shihet.
6. Organizohet loja me asociim. Zgjidhja kryesore është DITA, ndërsa zgjidhjet e kolonave janë:
 - a) zgjimi, larja, larja e dhëmbëve, ngrënia e mëngjesit; MËNGJESI,
 - b) dreka, kryerja e detyrave të shtëpisë, pushimi, faamilja së bashku: PASDITJA.
 - c) larja në dush, larja e dhëmbëve, darka, leximi i librit interesant; MBRËMJA.
7. Në një fletushkë shkruhet pjesa e preferuar e ditës. Shkrimet sistemohen në stendën e klasës sipas kategorive: mëngjes, paradite, pasdite, mbrëmje. Shpjegohet pse është e preferuar pjesa e zgjedhur e ditës. Lexohet ajo që është shkruar në stendë ...
8. Bisedohet për zërat (zhurmat) që dëgjohen në pjesët e ndryshme të ditës. Kur është qetësia dhe zhurma më e madhe? Bëhet lidhja e zhurmës me veprimtaritë e njerzve e të kafshëve, kjo në vartësi të vendit ku jetojnë nxënësit (fshat apo qytet).

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet e komentohet fotografia e lindjes dhe e perëndimit të Diellit.
2. Shihet (në mënyrë imagjinare) lëvizja e Diellit. Komentohen figurat dhe lexohen tekstet e shkruara: Dielli lind. Mëngjes. Dielli është në pikën më të lartë. Mesditë. Dielli perëndon. Mbrëmje.
Me lëvizjen e dorës imitohet lëvizja e Diellit dhe përshkruhet trajektorja e tij.
3. Shihen hijet në kohët e ndryshme të ditës. Kur është më e gjatë hija?
4. Shihen figurat me të cilat është përshkruar një ditë e Anës. Bisedohet për figurat dhe lexohen tekstet e shkruara pranë tyre. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë e të përvetësojnë nocionet me të cilat emërtohen pjesët e ditës (mëngjes, paradite, pasdite, mbrëmje). Çfarë bën Ana kur zgjohet? Çfarë bën paradite? Në cilën pjesë të ditës është dreka? Kur i bën detyrat e shtëpisë Ana? Çfarë bën ajo pas detyrave të shtëpisë? Kur e përgatit çantën e shkollës? Nxënësit tregojnë ditën e vet nga mëngjesi deri në mbrëmje. Çfarë kanë ata të përbashkët me ditën e Anës?

Puna me Fletoren e punës

1. Shihen figurat dhe lexohen tekstet e shkruara. Kur do të përshëndetet me "Mirëmëngjes!" dhe kur me "Mirëdita!". Vizatohet pozicioni i Diellit në mëngjes dhe në drekë. Cila pjesë e ditës është paraqitur e fundit me figurë? Si përshëndet atëherë? Shkruhet përshëndetja në vijën poshtë figurës.
2. Rregullojnë lojën me figura nga Shtojca numër 4. Zgjidhja e lojës me figura është GJELLI.
3. Në figura janë paraqitur profesionet e ndryshme. Bisedohet për shërbimet që na ofrojnë ato dhe në cilat pjesë të ditës mund t'u drejtohem atyre për ndihmë. Nxënësit kuptojnë se disa punë kryhen gjatë ditës ose gjatë natës. Ngjyroset shenja e duhur (dielli, hëna ose të dyja), në varësi të kohës kur punojnë njerzët që ushtrojnë profesionet e paraqitura.
4. Vizatohet ajo që u pëlqen më shumë fëmijëve të bëjnë pasdite.



GJATË UDHËTIMIT

Në klasën e parë kemi folur për rregullat dhe për dispozitat ligjore të qarkullimit rrugor. Me këtë tematikë vazhdohet edhe gjatë vitit të dytë të shkollës. Kapitulli "Gjatë udhëtimit" përmban gjashtë tema të përafërta: *Shenjat e qarkullimit rrugor, Udhëtojmë, Të jemi të kujdesshëm, Këmbalkat dhe patericat, Prej ç'gjëje janë sendet, Shpejt, më shpejt.*

Qëllimet kryesore janë që nxënësit: të dallojnë shenjat e rëndësishme të qarkullimit rrugor në rrugën nga shtëpia deri në shkollë, të njohin rregullat e sjelljes në mjetet e ndryshme të udhëtimit, karakteristike për vendin në të cilin ata jetojnë; të njohin rreziqet e mundshme në qarkullimin rrugor në situata të ndryshme, të kuptojnë rëndësinë e sjelljes së duhur e të sigurt në rrugën deri në shtëpi; të njohin mjetet për lëvizje dhe mjetet ndihmëse, të dallojnë gjurmët e lëvizjes; të arrijnë në përfundimin se trupat në lëvizje mund të ndalen, të njohin gjendjen e baraspeshës; të vërejnë dhe të krahasojnë sendet dhe materialet prej të cilave janë punuar mjetet për lëvizje e mjetet ndihmëse.

Dispozitat ligjore të qarkullimit rrugor na mundësojnë lëvizjen më të sigurt në hapësirën për jetesë. Përmes përvojës së drejtpërdrejtë, vëzhgimit, bisedës dhe evokimit të njohurive të fituara më parë në klasën e parë nga kjo fushë dhe përmes ndodhive nga jeta vetjake e deritanishme, nxënësit i thellojnë dhe i zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë për lëvizjen e sigurtë gjatë qarkullimit rrugor. Vitin e kaluar shkollor ata kanë mësuar sesi, në raport me objektet e caktuara, të orientohen si duhet në rrugën nga shtëpia deri në shkollë. Kanë mësuar si të lëvizin në mënyrë të sigurt, si të respektojnë sinjalistikën me drita, si të kalojnë në anën tjetër të rrugës. Këtë vit shkollor do të mësojnë se çfarë u tregojnë shenjat e qarkullimit rrugor, do të mësojnë t'i respektojnë ato, do të mësojnë për sjelljen e duhur në mjetet e udhëtimit, me ç'gjë i plotësojnë njohuritë për qarkullimin rrugor dhe fitojnë shprehitë që gjatë qarkullimit rrugor të sillen në mënyrë të përgjegjshme. Nxënësit vërejnë karakteristikat e përbashkëta të disa shenjave të qarkullimit rrugor, p.sh. se shenjat në formë trekëndëshi të qarkuar me ngjyrë të kuqe, paralajmërojnë për rrezikun, shenjat në formë rrethi të qarkuar me ngjyrë të kuqe ndalojnë diçka, ndërsa shenjat e kaltra në formë rrethi urdhërojnë, kurse shenjat e kaltra në formë katërkëndëshi bëjnë të ditur. Bisedohet për rreziqet e mundshme gjatë qarkullimit rrugor. Cilat janë rreziqet, nëse nuk respektohen dispozitat e qarkullimit rrugor? Nxënësit vëzhgojnë dhe marrin pjesë në qarkullimin e përditshëm rrugor dhe vërejnë situatat e mundshme të rrezikshme, në të cilat mund të gjenden duke parashikuar edhe pasojat. Të mbështetur nga ana e mësuesit, ata mësojnë se kur dhe si ta kalojnë rrugën, si dhe ku ta vozitin të sigurtë biçikletën, rolerët (patinat me rrota), vëzhgojnë me kujdes dhe nxjerrin përfundimin, sesi duhet të sillen për të qenë të sigurtë. Nxënësit rritin aftësitë për pjesëmarrjen e pavarur në qarkullimin rrugor. Bisedohet edhe për kushtet e motit, kur ato mund ta vështirësojnë lëvizjen në qarkullimin rrugor (bora, mjegulla, shiu ...). Si mund të ndikojnë kushtet klimatike në sigurinë gjatë qarkullimit rrugor? Cilat masa të sigurisë duhet të ndërmerren nga pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor në rrethana të pafavorshme të motit dhe pse? Nxënësit përshkruajnë situatat e ndryshme gjatë qarkullimit rrugor, i prezantojnë ata në shumë mënyra: duke interpretuar rolet, duke i paraqitur me vizatim etj.

Mjetet e transportit janë të ndara në ato për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave në tokë, në ujë dhe në ajër. Ato ndahen në mjete transporti (udhëtimi) publike dhe private. Në transportin (udhëtimin) publik udhëtarët duhet t'u përmbahen dispozitave ligjore, p.sh. të blejnë biletën, të respektojnë kohën e nisjes për udhëtim, ndërsa shoferët në transportin (udhëtimin) publik duhet të respektojnë orarin e nisjes dhe të tregojnë kujdes për rregulla të tjera të rëndësishme të sigurisë. Kur është fjala për transportin (udhëtimin) privat, ekzistojnë gjithashtu rregullat e sjelljes (duhet të vihet rripi i sigurisë, nuk duhet të pengohet shoferi), por, në raport me atë publik, transporti (udhëtimi) privat u ofron udhëtarëve më shumë liri në aspektin e kohës së nisjes, e vendit të nisjes, e bashkudhëtarëve, e drejtimit, e shpejtësisë së lëvizjes

Flitet për lëvizjen. U kujtohet nxënësve përvoja që kanë në vozitjen e biçikletës, të rolerëve (patinave me rrota), të trotinetëve. Si e vozitin biçikletën, trotinetin ...? Çfarë bëjnë për t'u ndalur? Ata vënë re se për t'u ndalur duhet kohë, parashikojnë pasojat e mundshme të veprimeve të gabuara në këto situata. Në këtë mënyrë nxënësit zhvillojnë vetëdijen për lëvizje, d.m.th. për ta drejtuar lëvizjen.

Flitet se për lëvizje nevojitet energjia. Nxënësit duhet të dallojnë se trupat e ndryshëm vihen në lëvizje me anë të energjisë së jashtme ose të brendshme. Nëse ndonjë trup vihet në lëvizje me anë të energjisë së jashtme, kjo do të thotë se atë e vë në lëvizje një forcë e jashtme lëvizëse (p.sh. era). Kur themi se trupi vihet në lëvizje me forcë të brendshme, atëherë energjia për lëvizje vjen nga brenda. Anija me vela vihet në lëvizje nga era, prandaj themi, se atë e vë në lëvizje energjia e jashtme. Automjeti vihet në lëvizje nga energjia e brendshme, ndërsa energjinë e fiton nga lënda djegëse (karburanti). Biçiklisti shfrytëzon energjinë vetjake, të cilën e fiton nga ushqimi (vihet në lëvizje nga energjia e brendshme). Nxënësit mësojnë gjithashtu se lëvizjen e mundësojnë apo e ndihmojnë edhe mjetet ndihmëse, siç janë bastuni, patericat, karroca e invalidit. Bisedohet për atë, se kush i përdor këto mjete ndihmëse, pse dhe si i përdor. Gjatë lëvizjes ngelin gjurmët. Nxënësit vrojtojnë gjurmët në tokën e butë, në rrëre apo në borë. Ata vënë re se thellësia e gjurmës varet nga pesha e ngarkesës dhe nga sipërfaqja që prek bazamentin.

Njohjen e materies (lëndës) fëmijët e fillojnë në klasën e parë. Në këtë moshë është e përshtatshme që materia (lënda) të kuptohet me njohjen e materialeve dhe të sendeve të ndryshme. Në klasën e parë ata kanë vënë re se materiale të ndryshme (letra, argjila, plastelina) kanë veti të ndryshme dhe se ato, për këtë arsye, i punojnë në mënyra të ndryshme. Gjithashtu kanë mësuar se sendet janë të punuara prej materialeve të ndryshme, gjë që është e lidhur drejtpërdrejt me vetinë përdoruese të sendit. Domethënë, duke vënë re veçoritë e sendeve (formën, madhësinë) dhe vetitë e materialit (ngjyra, era) fëmijët kanë filluar të formojnë konceptin për materien (lëndën). Edhe këtë vit shkollor ata vazhdojnë po këtë, duke njohur më tej vetitë e materialeve. Në kuadrin e kapitullit Shkolla ime dhe unë, është folur tashmë për vetitë e materialeve (kartonit dhe letrës). Tani bisedohet për atë, se prej ç'gjëje janë punuar sendet që ekzistojnë në mjedisin përreth nxënësve. Pse, p.sh. rrotat e automjeteve janë të bëra prej gome dhe jo prej druri? Nxënësit duhet të kuptojnë se funksioni i sendit varet nga vetitë e materialit (fortësia, elasticiteti, depërtueshmëria ...) prej të cilit është punuar. Nga vetitë e materialit varet edhe mënyra e punimit të tij, d.m.th. veglat e punës. Disa materiale i gjejmë në natyrë (p.sh.: druri, guri, rëra). Metali, qelqi dhe plastika janë materiale (lëndë) artificiale që përftohen nga lëndët e para të ndryshme.



SHENJAT E QARKULLIMIT RRUGOR

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve• të njihen shenjat kryesore të qarkullimit rrugor në rrugën nga shtëpia deri në shkollë• të përcaktohen njohuritë për lëvizjen e sigurt
Fjalë kyçe	shenjë e qarkullimit rrugor, formë e shenjave të qarkullimit rrugor (në formë rrethi, në formë trekëndëshi, në formë drejtkëndëshi, në formë katrori), ngjyrë e shenjave të qarkullimit rrugor (e kuqja, e verdha, e kaltra), mesazh i shenjave të qarkullimit rrugor (ndal, ndalohet, bëj këtë, këtu është, kujdes), mesazh i ngjyrave të semaforit; polic rrugor, pjesë të trasesë së rrugës (rrugë, trotuar, bordurë, pengesë, tra hekurudhor.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren në shëtitje. Vihen re shenjat e qarkullimit rrugor dhe përshkruhen ato. Ç'formë kanë? Të ç'ngjyre janë? Çfarë është vizatuar në to? Supozohen kuptimet e tyre. Shpjegohet se cili është kuptimi i formave dhe i ngjyrave. Në këtë rast përdoren fjalët e përshtashme për nxënësit e kësaj moshe, si: ndalohet, bëj këtë, këtu është, kujdes. Ç'shenja të qarkullimit rrugor ka më shumë përreth shkollës? Theksohen shenjat e qarkullimit rrugor që janë veçanërisht të rëndësishme për këmbësorët.
2. Vrojtohet udhëkryqi dhe sjellja e këmbësorëve dhe e shoferëve në të. Vihet re ndërrimi i ngjyrave me drita në semaforin për këmbësorë. Kush lëviz sipas rregullit dhe kush nuk lëviz sipas rregullit? Kush prej shoferëve nuk vepron sipas rregullit? Cilat janë pasojat e mosrespektimit të semaforit?
3. Modelohen prej plasteline ose prej kartoni shenjat e qarkullimit rrugor të formave të ndryshme. Komentohet se çfarë tregojnë shenjat e modeluara.
4. Ftohet në klasë polici rrugor. Ashtu sikurse edhe në rastet e tjera të ngjashme, ka rëndësi që nxënësit të mendojnë paraprakisht për pyetjet që do t'i bëjnë të ftuarit. Ai mund të pyetet: Pse duhet patjetër uniforma? A është uniforma e tyre e ndryshme nga uniforma e policëve të tjerë? Ç'pjesë ka uniforma e tyre? Cili është roli i "mëngëve" me shirita fluoroshent? Kur përdoret bilbili nga polici? Si u drejtohet shoferëve polici (duke përshëndetur me dorë)? Në cilat rrethana a situata e rregullojnë qarkullimin rrugor policët? Cilën shkollë duhet të kryejë dikush që të bëhet polic i qarkullimit rrugor? Cila është gjëja më e bukur në punën e policit rrugor? Kur e kanë më të vështirë policët rrugorë?
5. Nëse në afërsi të shkollës është stacioni hekurudhor apo rruga hekurudhore, nxënësit dërgohen atje që të shohin hekurudhën, traun hekurudhor, peronet Nxënësit duhet të vënë re, sesi bëhet e ditur se po vjen treni (me altoparlant), si e paralajmëron ardhjen treni (me sirenë); kur është i ulur dhe kur është i ngritur tra hekurudhor: Përshkruhen pasojat e mosrespektimit të rregullave.



Puna me Tekstin mësimor

1. Përshkruhet pamja e shenjave të qarkullimit rrugor në secilin grup (ngjyra, forma). Ç'gjë është e përbashkët tek shenjat e paraqitura? Lexohet se ç'kuptim kanë shenjat në formë trekëndëshi. Ç'shenja tregojnë se diçka është e ndaluar? Çfarë tregojnë shenjat rumbullake e ato katërkëndëshe me ngjyrë të kaltër? Cila shenjë ka formë të veçantë? (Stop). Për çfarë paralajmëron ai? Para së gjithash tërhiqet vëmendja tek shenjat e qarkullimit rrugor që janë të rëndësishme për këmbësorët dhe për ato që janë të shpeshta për mjedisin përreth.
2. Përshkruhet semafori: Vihet re ndryshimi midis semaforit për shoferët e semaforit për këmbësorët. Cila ngjyrë shënon NDAL dhe cila NISU?
3. Shihet figura dhe thuhet se çfarë paraqet ajo. Si sillen këmbësorët në figurë? Pse veprojnë kështu? Për çfarë paralajmëron trau hekurudhor i ulur?
4. Përshkruhet pamja e policit rrugor. Si është i veshur ai? Ku qëndron më shpesh polici rrugor? Pse? Si e rregullon qarkullimin rrugor polici rrugor? Shihet figura e vendkalimit për këmbësorë dhe lexohet teksti i shkruar. Në cilën anë të vendkalimit për këmbësorë duhet të ecet? Pse kështu? Çfarë tregon shenja e paraqitur në vendin e parkimit. Për kë është i caktuar ky vend parkimi?

Puna me Fletoren e punës

1. Në tabelë shkruhen kuptimet e shenjave të qarkullimit rrugor.
2. Vizatohen shenjat e qarkullimit rrugor që janë parë në mjedisin përreth shkollës.

Mjetet ndihmëse | plastelina, kartoni, gërshërët, zami (ngjitësi).



UDHËTOJMË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen me rregullat e sjelljes në mjetet e ndryshme të udhëtimit, karakteristike për vendin ku jetohet• të dallojnë rëndësinë e sjelljes së rregullt e të sigurt në rrugën nga shkolla deri në shtëpi• të njihen me mënyrat e ndryshme të transmetimit të informatave
Fjalë kyçe	mjet transporti (udhëtimi): personal (vetura), publik (autobusi, mikrobus), tren, aeroplan, anije; shofer, pilot, makinist, udhëtar, konduktor/e, hyrje, dalje; stacion autobusi, stacion treni, aerodrom, sportel, biletë udhëtimi, udhëtim i sigurt, sjellje e sigurt.

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet me nxënësit për mjetet e transportit. Me cilin mjet transporti udhëtojnë më shpesh? Cili është më interesanti, cili më komodi, cili më i shpejti, me cilin nuk kanë udhëtuar, por u pëlqen të udhëtojnë ..? Cili mjet transporti shërbën për transportin e numrit më të madh të udhëtarëve? Ku lëviz ai? Prej nga e fillon udhëtimin? Me çfarë transportohen mallrat.
2. Hartohet histogrami i mjeteve të transportit që nxënësit i përdorin më shumë për transport.
3. Vizitohet stacioni i autobusëve ose i trenit. Njihen me orarin e udhëtimit (nisjet, arritjet). Ku blihen biletat? Vrojtohet sjellja e njerëzve që janë në radhë. Kush sillet në rregull dhe kush jo? Ku mund të pyetet për orarin e udhëtimit, për vonesat etj.? Çfarë tjetër mund të mësojmë në sportelin e informacionit? Si duket peroni?
4. Kërkohet shoferi dhe organizohet një intervistë e shkurtër. Tash sa kohë merret me këtë punë? Çfarë nevojitet që ta kryejë këtë punë? Çfarë i pëlqen në punën e tij? Çfarë e ka të vështirë ai? A ka patur aksidente në rrugë? Pse?
5. Bisedohet se me çfarë udhëtohet më shpesht me familje. Kur përdorin veturën? Kur udhëtojnë me autobus? Nxënësit shpjegojnë se ku hyhet e ku dilet nga autobusi? Pse veprohet kështu? Përshkruhet sjellja e kulturuar gjatë udhëtimit. Çfarë nuk është mirë të bëjnë udhëtarët gjatë udhëtimit? Pse?
6. Përshkruhet një udhëtim personal nga nxënësit. Ku kanë udhëtuar dhe me kë kanë udhëtuar? Me çfarë kanë udhëtuar? Si u është dukur mjeti i udhëtimit? Çfarë ka qenë interesante? Çfarë nuk u ka pëlqyer gjatë udhëtimit? Ç'mbishkrime kanë vënë re në mjetin e udhëtimit? Për ç'gjë paralajmërojnë këto mbishkrime?
7. Sillen bileta të ndryshme udhëtimi (biletë autobusi, biletë urbani, biletë interurbani, biletë aeroplani, biletë treni). Komentohet përmbajtja e tyre, d.m.th. informatat që mund të mësohen nga biletat.
8. Nxënësit bëjnë bileta treni.
9. Shihen targat në automjete. Ç'shkruan në to? Vihet re se çdo targë fillon me shkronjë. Përpiqen të gjejnë se çfarë tregojnë shkronjat. Supozohet se



me ç'qytet kanë të bëjnë targat. Vihet re se çdo mjet udhëtimi ka diçka të veçantë në numrin e tij të regjistrimit. Thuhet supozimi vetjak pse është kështu.

Puna me Tekstin mësimor

1. Bisedohet për mjetet e transportit (udhëtimet). Shihen fotografitë e mjeteve të ndryshme të transportit (të sotme e të shkuara). Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grup zgjedh një mjet transporti dhe thotë se çfarë di për të dhe thotë mjetet e tjera të ngjashme me të.
Në ç'gjë dallohen mjetet e transportit në fotografi? Çfarë tregojnë vizatimet midis fotografive?
2. Lexohet mbishkrimet që shihen në autobus. Kush vepron ashtu siç duhet dhe pse? Shihet brendësia e autobusit. Pse duhet të lëvizin udhëtarët drejt daljes?
3. Komentohet sjellja e njerëzve në të dyja figurat. Jepet mendimi për atë, se si duhet të silllemi sipas rregullit para sportelit.

Puna me Fletoren e punës

1. Emërtohen mjetet e transportit (udhëtimet) dhe ngjyrosen ato në të cilët nxënësit kanë udhëtuar.
2. Vizatohet mjeti i udhëtimet që pëlqehet më shumë.
3. Shënojnë me X katrorin para fjalisë që paraqet sjelljen e rregullt në autobus.
4. Zgjidhet fjalëkryqi. Katrorët e ngjyrosur do të japin përgjigjen se prej ku nisët autobusi. Zgjidhja është STACIONI.

Mjetet ndihmëse

bileta udhëtimi autobusi



TË JEMI TË KUJDESSHËM

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen rreziqet në qarkullimin rrugor në situatat dhe kushtet e ndryshme të motit• të vihet re rrjedha e ndodhive të motit
Fjalë kyçe	gjendje në rrugë: e thatë, e lagur, e ngrirë, rrëshqitëse, rërë e derdhur, frenoj, ndal

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet me fëmijët për mjetet me të cilat udhëtojnë. A kanë pësuar ndonjëherë aksidente, kur kanë vozitur biçikletën, rolerët a skejtbordin? Si është shkaktuar aksidenti? A kanë pësuar dëmtime? Kush u ka dhënë ndihmën? Si?
2. Hartohet histogrami i mjeteve të udhëtimit: biçikleta, trotineti, roleri, skejtbordi dhe i nxënësve që dijnë t'i vozisin ato. Paralelisht bëhet edhe histogrami i nxënësve që kanë pësuar aksidente gjatë vozitjes. Krahasohen rezultatet e histogrameve.
3. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Në një pjesë të këndit të lojërave hedhim rërë. Një fëmijë e vozit biçikletën deri tek vendi, ku është hedhur rëra dhe aty frenon, ndërsa mësuesi e mban. Fëmija nuk duhet të vozisë shpejt, rëndësi ka që demonstrimi të tregojë rëndësinë e pranisë së rërës në rrugë. E njëjta gjë mund të bëhet edhe me rolerë. Nxirret përfundimi se rëra në rrugë mund të shkaktojë aksidente. Kuptojnë rëndësinë e mbajtjes së kaskës së kokës dhe të mbrojtësve të tjerë.
4. Gjatë kohës së ditëve të ftohta, kur në këndin e lojërave ka akull, nxënësit mund të provojnë ecjen me këpucë të ndryshme. Mjafton të vihet re se me disa këpucë rrëshqitet në akull dhe të kuptohet se, edhe këmbësorët edhe vozitësit, duhet të jenë të kujdesshëm në rrugën që ka akull.
5. Bisedohet për lëvizjen e sigurt në rrugën që s'ka trotuar. Pse është e nevojshme që të mbahet veshja me pjesët fluoroshente? Errësohet klasa dhe në vendin e errët vendoset çanta e shkollës, këpucët sportive, xhakoventoja me pjesët fluoroshente dhe dy-tri sende që nuk e kanë këtë gjë. I ndriçojmë sendet me llambën elektrike të dorës. Cilat sende i shohin më mirë? Vihet re se pjesët fluoroshente në sende shihen mirë në errësi. Komentohet sesi mbron kjo gjë në rrugë.
6. Nga gazetatat e ditës mblidhen disa artikuj për aksidentet rrugore. Cilat janë shkaqet e aksidenteve (shpejtësia e papërshtatshme, alkooli, kushtet e këqia të motit)? Pse duhet të jemi veçmas të kujdesshëm, kur ka mjegull dhe kur ka rënë a bie bora e shiu. Pse është e rrezikshme vozitja e automjetit në gjendje të pirë? Pse edhe këmbësori nuk duhet të jetë në gjendje të alkoolizuar.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen fotografitë e aksidenteve që mund të ndodhin në qarkullimin rrugor. Komentohet secila figurë. A janë gjendur ndonjëherë në situata të ngjashme me këto që janë paraqitur? Kur mund të ndodhin aksidentet? Si mund t'i shmangim ato?



Puna me Fletoren e punës

1. Shihet vizatimi i udhëkryqit dhe komentohet sjellja e fëmijëve. Shpjegohet se kush sillet e nuk sillet në rregull. Supozohet se çfarë mund t'i ndodhë Llukës, Stefanit e Milicës. Rrethi i vogël pranë personit që sillet në rregull në udhëkryq ngjyrosset me ngjyrë të gjelbër, kurse pranë atij që sillet jo në rregull ngjyrosset me ngjyrë të kuqe.
2. Në Shtojcën numër 5 janë vizatimet që duhet të rënditen në mënyrë kronologjike. Kur t'i ngjitin figurat, tregojnë tregimin. Pse është shkaktuar aksidenti? Në ç'gjë kanë gabuar Markoja dhe Ana? Çfarë ka ndodhur për shkak të sjelljes së tyre nënvleftësuese? Si do të duhej të veprohej, po të ishim në vend të tyre? Tregimi mund të zgjatet duke parashikuar vazhdimin

Mjetet ndihmëse

artikujt e gazetave, çantat, këpucët, veshja me pjesë fluoroshente, llamba elektrike me bateri, biçikleta, rolerët.

KËMBALKAT DHE PATERICAT

Qëllimet

- të njihet me mjetet lëvizëse dhe ato ndihmëse për lëvizje
- të njihen gjurmët që lë lëvizja
- të nxirret përfundimi se trupat në lëvizje mund të ndalen

Fjalë kyçe

lëvizje, zhvendosje, patericë, këmbalkë, bastun, gjurmë

Veprimtaritë e propozuara

1. Në klasë sillen patericat. Patericat mund të jenë të gjata, deri në sqetulla, ose të shkurtra, vetëm deri në bërryla. Nxënësit përpiqen të ecin me paterica duke u mbështetur vetëm në një këmbë. Prej çfarë janë bërë patericat? Përse shërbëjnë dhe kur përdoren? Me cilat paterica është më lehtë të ecet; me të gjata apo me të shkurtrat? Cilat paterica do t'ia rekomandonin një njeriu të moshuar? Pse?
2. Lihen gjurmët e këpucëve mbi letrën hamer. Vihet re se në ç'drejtim janë të kthyer gjurmët. Cilat gjurmë kanë të njëjtin drejtim dhe cilat të kundërt?
3. Shihen gjurmët në dheun e butë ose në borë. Supozohet se gjurmët e kujt janë dhe se në ç'drejtim ka lëvizur trupi, gjurmët e të cilit janë të pasqyruara.
4. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në borë ose në rërë. Sistemohen tullat. Në një vend janë dy tulla, në të dytin tri, në të tretin katër Ku kanë lënë gjurmën më të thellë tullat? Vihet re se thellësia e gjurmës varet nga numri i tullave, përkatësisht nga pesha. Sa më e madhe që të jetë pesha, aq më e thellë është gjurma.



5. Vendosen në borë tri tulla mbi sipërfaqet e tyre të ndryshme (shtrirë, anash, pingul). Zhvendosen tullat dhe shihen gjurmët. Cila tullë ka lënë gjurmën më të thellë dhe cila më të cekët? Tulla e vendosur me sipërfaqen më të madhe në borë ka lënë gjurmën më të cekët, kurse gjurma më e thellë i përgjigjet sipërfaqes më të vogël. Vihet re se thellësia e gjurmës nuk varet vetëm nga pesha, por edhe nga sipërfaqja me të cilën sendi prek bazamentin.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura dhe komentohet se kush përdor mjetet ndihmëse për lëvizje. Emërtohen mjetet ndihmëse që shihen: bastuni, patericat, karroca e invalidit. Bastuni shërben për t'u mbështetur. Pataricat mund të jenë të gjata (deri në nënsqetull) ose të shkurtra (deri në bërryla). Për patericat e shkurtra duhet forcë më e madhe dhe më shpesh përdoren nga njerëzit me moshë të re. Patericat e gjata u rekomandohen njerëzve të moshuar dhe personave që i kanë duart e dobëta. Karroca e invalidit përdoret nga individët me të meta fizike. Nëse ekziston një person i tillë në mjedisin përreth nesh, mund të bisedohet më të, për mënyrën sesi e vë në lëvizje karrocën e invalidit.
2. Komentohet fotografia në të cilën janë paraqitur këmbalkat. A i kanë parë ato ndonjëherë dhe ku i kanë parë? Sa të mëdha janë hapat me këmbalka? (Më të mëdha sesa pa to). Krahasohet gjatësia e gjymtyrëve me e pa këmbalka. A ekziston lidhja midis gjymtyrëve e gjatësisë së hapave? Në figurë është paraqitur vajza që shëtit qenin. Mbi bazën e gjurmëve, përcakto se të kujt janë gjurmët, d.m.th. kush lëviz dhe në ç'drejtim lëviz?

Puna me Fletoren e punës

1. Lidhet figura ilustruese me gjurmën përkatëse. Sipas gjurmëve, vihet re se kush ka lëvizur dhe në ç'drejtim ka lëvizur.
2. Në figurat ilustruese janë paraqitur fëmijët në dëborë. Slitat e kujt do të lënë gjurmën më të thellë. Pse? Kuptohet se thellësia e gjurmës varet nga pesha. Shënohet me X katrori pranë figurës përkatëse.

Mjetet ndihmëse

patericat, këmbalkat, tullat, letra hamer.



PREJ Ç'GJËJE JANË SENDET?

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të përcaktohen cilësitë e materialeve• të modelohen trupat prej materialeve• të bëhet lidhja midis materialeve të ndryshme dhe proceseve të punimit• të vihet re rëndësia e përgatitjes për punë• të vihet re se gjatë punës krijohen mbeturinat të cilat duhet të hiqen (të mënjanojnë)
Fjalë kyçe	send, material: letër, karton, dru, plastelinë, gomë, gur, pëlhurë, proces punimi (çarje, ndarje, prerje, palosje, përkulje, ngjitje, shtypje, presim ...); mbeturinë, heqje e mbeturinave.

Veprimtaritë e propozuara

1. Sillen në klasë materialet e ndryshme: krehëri, lastiku i flokëve, letërfshirësja, prerësja e thonjve, gërshërët, furça e dhëmbëve, klikerat, kutia e pastës, peri etj. Sendet nxirren një nga një, ndërsa nxënësit thonë se prej ç'gjëje është punuar. Pas gjetjes se prej ç'materiali është punuar, komentohen funksionet e sendeve; imagjinojnë se prej ç'gjëje tjetër mund të ishte punuar secili prej sendeve.
2. Lexohet përralla "Tre derrkucat". Komentohet se prej çfarë kanë qenë të ndërtuara shtëpitë. Pse njëri nga derrkucët e ka ndërtuar shtëpinë prej kashte? (Nuk i ka pëlqyer të punojë.) Prej ç'gjëje e ka ndërtuar shtëpinë derrkuci i dytë? Pse pikërisht prej dërrasash? Prej ç'gjëje e ka ndërtuar shtëpinë derrkuci i tretë? Pse pikërisht prej tullash? Cili prej derrkucave ka qenë më i vyeshëm dhe më i zgjuar? Pse e ka ndërtuar shtëpinë prej tullash derrkuci i tretë? (Ka patur dëshirë që ta ketë shtëpinë të fortë.) Çfarë ka ndodhur me shtëpinë prej kashte e prej dërrasash? Cila shtëpi i bëri ballë sulmit të ujkut? Përmes bisedës për përrallën, nxënësit nxiten të mendojnë e të flasin për rëndësinë që ka zgjedhja e materialit. Pas bisedës, nxënësit mund ta ilustronë përrallën; shtëpinë e një prej derrkucave.
3. Nxënësit i nxjerrin sendet nga çantat e veta. Shoku a shoqja e bankës gjen se prej ç'materiali është bërë sendi. Thuhet edhe disa sende të tjera të bëra po prej të njëjtit material.
4. Nxënësit, me sy të mbyllur, duke përdorur ndjesinë e të prekurit, gjejnë sendin që u jepet në dorë. Kur e prekin sendin, tregojnë me zë atë që ndjejnë: është i lëmuar, është i butë, është i fortë, mund të paloset a të përkulet, është i mprehtë ...
5. Shihen sendet në klasë dhe thuhet se prej çfarë janë bërë. Vihet re se sendet (dërrasa e zezë, rafti, këpucët, xhakoventoja ...) mund të jenë të bëra prej materialeve të ndryshme.
6. Nxënësit nxirren në shëtitje. Vrojtohen sendet dhe vihet re se prej ç'materialesh janë të ndërtuara ato. Prej ç'materiali është i ndërtuar rrethimi i oborrit të shkollës? Prej ç'materiali është dera hyrëse e shkollës, dritaret dhe tabela e lajmërimeve?



7. Në një letër vetëngjithëse shkruhet DRU, PLASTIKË, METAL, QELQ (nga dhjetë për çdo fjalë, përkatësisht material). Nxënësit ndahen në katër grupe, duke i dhënë çdo grupi mbishkrimin për një material. Ata i ngjitin mbishkrimet në sendet e klasës.
8. Në çdo kuti vihen sendet e ndryshme: goma, lapsi, vizorja, mprehësja e lapsave, flomasteri. Nxënësit përpiqen t'i përkulin duke treguar kujdes që të mos i thejnë. Çfarë mund të përkulet (goma, vizorja)? Çfarë nuk përkulet (mprehësja e lapsave, lapsi)? Shihet se sendet kanë cilësi të ndryshme. Qëllimi është që përveç cilësive të dukshme me sy, të kuptohet edhe cilësia e përkulshmërisë (elasticitetit).
9. Prej gotës plastike për jogurt bëhet arka e kursimit për të hollat në formë kërpudhe. Prej letër hameri të kuq presin me gërshërë rrethin. Rrethi pritët përgjysmë, bëhet "kapela" e vogël dhe ngjitet në gotë. Me lapëskorigjues bëhen rrathët e bardhë. Pas punës pastrohet vendi i punës.
10. Modelohen orenditë prej plasteline. Kutia e kartonit pajiset me orenditë që janë punuar prej vetë nxënësve.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet fotografia e veturës dhe thuhet se prej çfarë është bërë. Prej çfarë janë bërë gomat? Çfarë do të ndodhte, nëse ato do të ishin prej gome dhe çfarë po të ishin prej metali? Ç'material ka më shumë në veturë?
2. Shihen figurat e shtëpive. Në ç'gjë dallohen? Në ç'gjë ngjasojnë? Prej ç'materiali janë ndërtuar? Ku janë parë shtëpi të ngjashme si këto në figura? Çfarë pëlqehet më shumë tek këto shtëpi dhe çfarë nuk pëlqehet? Cila prej këtyre shtëpive ngjason më shumë me shtëpinë ku jeton secili? Kush prej kushërinjve apo miqve të nxënësve jeton në shtëpi të tilla? Cila prej shtëpive të paraqitura nuk mund të shihet në vendin ku banojnë nxënësit (kolibe prej bore)? Mund të tregohet tregimi për eskimezët dhe të thuhet se kolibet prej bore i kanë bërë me blloqe prej bore. Ato u kanë shërbyer si shtëpi të përkohshme, kur kanë shkuar për gjueti.
3. Në figura tregohet tregimi sesi krijohet buka. Çfarë nevojitet që të bëhet buka? Kuptohet se buka krijohet duke përzier lëndë (materie) të ndryshme. Cilat janë këto lëndë a materie? Si quhen personat që bëjnë bukën? Ku punojnë ato? A punojnë bukëpjeksit ditën apo natën? Pse punojnë kështu? Ku mund të blihet buka? Ç'lloje buke njohin nxënësit? Nga se ndryshojnë llojet e bukës që njohin?
4. Në figura janë paraqitur sende të ndryshme. Çfarë është e përbashkët për sendet e grupit të parë, të grupit të dytë dhe të grupit të tretë? Cilat sende mund t'ua shtojmë sendeve të grupit të parë, të dytë e të tretë? Kuptohet se prej materialeve të njëjta mund të bëjmë sende të ndryshme.

Puna me Fletoren e punës

1. Përshkruhet se prej çfarë është bërë skejtboardi. Komentohet se pse është kështu (p.sh. pse rrotat nuk janë prej druri).
2. Prej telave që përkulen, nxënësit bëjnë lulet dhe zogun.
3. Përcaktohen cilësitë e materialeve: shkruhet shenja X në vendin e cilësisë së duhur. Ndonjë prej materialeve mund të ketë disa prej cilësive të përmendura, p.sh., qelqi (i tejdukshëm dhe i fortë).



4. Shkruhen emërtimet e sendeve të bëra prej gome, druri, pëlhure, metali e qelqi. Le të jenë këto sende me funksione të ndryshme.
5. Në tabelë shkruhet emërtimi i materialit që ka cilësinë përkatëse.

Mjetet ndihmëse	sendet e ndryshme, gota plastike, letër hameri e kuqe, lapskorigjuesi; gërhërët; zami (ngjitësi), plastelina, kutia prej kartoni, teli.
------------------------	---

SHPEJT, MË SHPEJT

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen mjetet për lëvizje• të nxirret përfundimi se mjetet për lëvizje mund të ndalen
Fjalë kyçe	vë në lëvizje, shpejtoj, kthej, frenoj, ndal, ngadalësoj; lëvizje motorike e brendshme; lëvizje motorike e jashtme

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Provojnë sesi ndalet biçikleta. Pastaj tregojnë sesi e ndalin. Nxënësi e tërheq ngadalë dorezën e frenave. Vihet re se frenat e ndalin rrotën. Rrota e ndal biçikletën. E njëjta gjë eksperimentohet me lëvizjen e pedalit mbrapa. A ndalet menjëherë biçikleta pas lëvizjes së frenave? Vihet re se biçikleta lëviz edhe për një farë kohe. Pse duhet filluar frenimi pak më herët. Vihet re se për të frenuar duhet kohë. Çfarë do të ndodhë, nëse nxënësit fillojnë të frenojnë, atëherë kur duan të ndalen?
2. Shihen rolerët. Sa rrota kanë? Ku gjenden frenat? Nxënësit që dijnë t'i vozitin rolerët demonstrojnë frenimin. Vihet re se rolerët nuk janë ndalur menjëherë. Pse duhet filluar më herët me frenimin?
3. Ndërsa njëri nxënës vrapon, tjetri i thotë NDAL. Vihet re se do të kalojë një farë kohe, para se të ndalet ai që ka vrapuar. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë, se ndalja nuk bëhet menjëherë, por nevojitet një kohë e caktuar. E njëjta gjë mund të provohet me biçikletë, me trotinetë ose me rolerë.
4. Në poligon ushtrohet bërja e kthesës me biçikletë. Çfarë duhet të bëhet që të ndërrohet drejtimi? Ç'gjë tjetër në biçikletë kthehet, kur kthehet timoni?
5. Ngrihet lart biçikleta dhe shkëputet nga toka. Një nxënës e rrotullon pedalin. Cila rrotë rrotullohet? Nxënësit vënë re se cila rrotë ka forcën motorike (e vë në lëvizje biçikletën). Shtrëngohen frenat, kur rrota është duke u rrotulluar. Çfarë ndodh? Vihet re, frenat e ndalin rrotën që ka forcën motorike (që e vë në lëvizje biçikletën).
6. Bisedohet për lëvizjen e automjeteve e të trupave. Çfarë e vë në lëvizje automobilin? Çfarë ndodh, kur automobili mbetet pa karburant (lëndë djegëse)? Shpjegohet se automobili vihet në lëvizje me forcë motorike të



brendshme. Ç'mjet tjetër transporti vihet në lëvizje me forcë motorike të brendshme? (Autobusi, treni, motoskafi, aeroplani ...). Si vihet në lëvizje biçikleta? E vë në lëvizje biçiklisti me forcën e vet dhe kjo është lëvizje motorike me forcë të brendshme. Kush e vë në lëvizje gurin e mullirit dhe helikën e erës? Guri i mullirit dhe helika e erës vihen në lëvizje me forcën e jashtme motorike. Uji dhe era veprojnë me forcën e vet dhe i vënë në lëvizje ato.

7. Bisedohet për mjetet ndihmëse që nxënësit përdorin kur notojnë në ujë. Shpjegohet se për çfarë shërbëjnë ato. Kuptohet se ato përdoren që të mbetemi në sipërfaqen e ujit. Shihen kamerdaret e fryra të dorës prej gome dhe dysheku i fryrë prej gome për not. Prej ç'materiali janë bërë ato? Me se janë të mbushura? Vihet re se të gjitha janë të mbushura me ajër. Pse nuk janë bërë prej pëlhure apo prej kartoni? Imitohet lëvizja në ujë. Si lëvizet para? (Shtyhet uji prapa me duar e me këmbë). Me çfarë lëvizet? (Me duar, me këmbë, me fletët prej gome të këmbëve, me rrema).

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen figurat ilustruese të Anës në trotinet dhe lexohet teksti i shkruar. Si e vë në lëvizje trotinetin Ana? Si e bën kthesën? Çfarë duhet të bëjë që të ndalet? Nxënësit duhet të kuptojnë se Ana e vë në lëvizje dhe e ndal trotinetin duke përdorur forcën vetjake.
2. Komentohet se cili prej djemve lëviz më shpejt. Pse është më i shpejtë? Kujt i duhet me shumë energji (forcë)? Bisedohet për përvojat vetjake dhe për vozitjen teposhtë. Pse atëherë duhet të jemi shumë të kujdesshëm?
3. Shihen figurat ilustruese dhe përskruhen mënyrat e lëvizjes: Nga se dallohen mjetet e lëvizjes në borë prej automobilit, biçikletës ...? Si ndalen ata? Çfarë do të ndodhte, nëse do të përdreshin në borë rolerët, trotineti dhe biçikleta? A mundemi me mjetet e lëvizjes në borë (slitat, skitë, skejtboardi) të lëvizim edhe në rrugë? Kuptohet se rrotat fundosen në borë ose rrëshqasin mbi të. Prandaj, kur në rrugë ka dëborë, edhe shoferët edhe këmbësorët duhet të jenë të kujdesshëm. Bisedohet për mënyrën, sesi Markoja dhe Ana lëvizin në ujë (me duar e më këmbë e shtyjnë ujin prapa). Me lëvizjet e duarve, nxënësit imitojnë lëvizjet e tyre. Me ndihmën e kujt qëndrojnë mbi ujë Markoja dhe Ana? Me çfarë janë të mbushur dyshekët e ujit dhe kamerdaret prej gome të dorës për not.
4. Çfarë i vë në lëvizje trupat në figura? Kush e shfrytëzon fuqinë e erës (anija me vela)? Si vihen në lëvizje biçiklisti dhe kanotazhisti? Ata përdorin fuqinë (energjinë) e vet, të cilën e përftojnë nga ushqimi. Kush tjetër e shfrytëzon fuqinë e vet (leopardi)? Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë se për t'u vënë në lëvizje duhet energjia (fuqia), e cila përftohet nga lënda djegëse (karburanti), ushqimi, era.

Puna me Fletoren e punës

1. Shihet biçikleta dhe emërtohen pjesët e saj. Cila pjesë shërben për vënien e saj në lëvizje? Me cilën pjesë drejtohet dhe bëhet kthesa? Kush ndihmon për t'u ndalur? Si paralajmërojnë? Lidhen pjesët e biçikletës me foljet e shkruara.
2. Në figura janë vogëlushet që voziten në trotinetë në rrugë me bazamente të ndryshme (asfalt, bar, kalldrëm). Cila prej tyre lëviz më shpejt? Pse? Ngjyroset rrethi i vogël.



3. Shihen vizatimet dhe vihet re se kush vihet në lëvizje me forcë motorike të jashtme (mulliri me erë, snoubordi me velë), ndërsa kush me forcë motorike të brendshme (të tjerët). Me të njëjtën ngjyrë ngjyrosen vizatimet që paraqitin lëvizjen me të njëjtën forcë motorike.
Pastaj mund të komentohet, nëse motoskafi e autobusi shfrytëzojnë energjinë e lëndës djegëse (karburantit), mulliri me erë dhe snoubordi me velë energjinë e verës, ndërsa notari, biçiklisti, djali në trotinetë dhe vogëlushja energjinë vetjake.
4. Mbi bazën e pozicionit të rrotave, përcaktohet dhe tregohet me shigjetë drejtimi i lëvizjes.

**Mjetet
ndihmëse**

biçikleta, rolerët, trotineti, kartonët me mjetet e transportit (udhëtimit).



KA ARDHUR DIMRI


Kapitulli *Ka ardhur dimri* është vazhdim logjik, si i pjesëve paraprijëse, ashtu edhe i kapitullit me të njëjtin emërtim të vitit të shkuar shkollor. Ai përbëhet nga temat e mësimin si më poshtë: *Ka rënë borë, Uji dhe akulli, Kalendari, Festojmë*.

Qëllimet kryesore janë: nxënësit të vërtetojnë e të përshkruajnë ndryshimet në natyrë: motin (kushtet klimatike), ndryshimet tek bimët e kafshët dhe ndryshimet në veprimtaritë e njerëzve; të mësojnë për vetitë e lëngut, të vënë re se uji i ndryshon vetitë e veta, nëse nxehet apo nëse ftohet; të mësojnë se akulli dhe bora janë uji në gjendje të ngurtë; të vënë re se ndryshimi i ujit (lëngut) në akull (gjendje e ngurtë) janë procese të qarkullimit në natyrë; të njohin kalendarin, të vënë re se ekziston renditja në kohë e ndodhive dhe se ky cikël përsëritet; të kuptojnë dhe të shfrytëzojnë përcaktimet dhe nocionet për kohën (dje, sot, nesër, ditët e javës, muajt, viti).

Në klasën e dytë përsëritet dhe thellohet rrëfimi për stinën e dimrit. Nxënësit ndjekin dhe mbajnë shënime për motin dhe vënë re se dita me dritë zgjat më shkurt. Bisedohet për reshjet; për shiun, për borën. Bisedohet për pamjen e bimëve. Vërtetojnë drurët në mjedisin përreth. Vënë re ndryshimet në pamjen e drurit gjatë dimrit në vjeshtë dhe në dimër. Vënë re dhe komentojnë ndryshimet në sjelljen e kafshëve gjatë dimrit. Bisedohet për kafshët e viseve tona. Cilat kafshë janë aktive gjatë dimrit? Me se ushqehen ato? Cilat kafshë bien në gjumë gjatë dimrit? Çfarë ndodh me zogjtë gjatë dimrit? Si dhe ku e kalojnë dimrin? Cilët zogj shtegtojnë në viset e ngrohta dhe cilët nuk shtegtojnë? Bisedohet edhe për ndryshimet në sjelljen dhe në veprimtaritë e njerëzve gjatë periudhës së dimrit.

Vitin e shkuar shkollor nxënësit kanë filluar t'i njohin karakteristikat e lëngut dhe të lëndës së ngurtë. Këtë vit shkollor ata i zgjerojnë njohuritë për vetitë e materies (Shkollonjë, Në rrugë); në këtë kapitull mësojnë se disa materie i ndryshojnë vetitë e veta, nëse nxehen ose nëse ftohen, dijnë se nga uji përftohet akulli dhe nga akulli përftohet uji. Nxënësit krahasojnë vetitë e ujit në gjendje të lëngët dhe në atë të ngurtë, vënë re qarkullimin në natyrë të procesit. Bisedohet për atë që ndodh me ujin, kur e futim në frigorifer ose, anasjelltas, nëse copën e akullit e vendosim mbi tavolinë. Ata do të vënë re se vjen tek kalimi nga lëngu në materie të ngurtë (akulli) dhe anasjelltas, kalimi nga materia e ngurtë në lëng. Nxënësit mund të eksperimentojnë me akullin, me akulloren, me çokolletën ... Ata duhet të kuptojnë se shkrirja dhe ngrirja janë procese të kundërta.

Uji në temperaturën nën 0°C shndërrohet në akull. Uji në atmosferë kristalizohe dhe formohet bryma. Kristalet e formuara nga avulli i ujit në temperaturën prej -12 deri në -16°C kthehen në fjolla. Me grumbullimin e fjollave në shtresa, formohet mbulesa prej bore. Pasi në borë ka plot ajër, bora luan rolin e izolatorit të ngrohtësisë. Nëse bora shtresëzohet, ngjeshet, ajo e humbet ajrin, bëhet më e fortë dhe kthehet në akull. Bora, akulli dhe uji dallohen nga ngjyra dhe nga densiteti. Akulli noton në sipërfaqe të ujit, sepse është më i rrallë se uji, ndërsa bora është më e rrallë se akulli dhe se uji, sepse në të, midis kristaleve të akullit, ka ajër. Por, karakteristikat bazë të ujit si lëng nuk ndryshojnë gjatë procesit të qarkullimit të tij në natyrë.



Nxënësit vënë re se ndryshimet e motit vargëzohen sipas një renditjeje të caktuar (ditët, javët, muajt, stinët e vitit). Në klasën e parë ata kanë mësuar ditët e javës, ndërsa këtë vit do të mësojnë javën, muajt dhe vitin si njësi të kohës. Renditja e ditëve në javë përsëritet. Gjithashtu, sipas një radhe të caktuar, përsëriten edhe muajt gjatë vitit.

Njësitë e kohës (dita, java, muaji, viti) janë të renditura qartë në kalendar. Njerëzit në të kaluarën e kanë ndjekur dhe kanë matur kohën në bazë të ndryshimeve në natyrë dhe sipas lëvizjes së Diellit e Hënës. Tek ne dhe në pjesën më të madhe të botës është në përdorim kalendarit gregorian, i cili përfaqëson një kombinim të kalendarit diellor e atij hënor. Kalendarit i sotëm është në përdorim që prej shekullit të 16^{të}, ndërsa deri në atë kohë është përdorur kalendarit julian. Për numërimin e viteve është pranuar era kristiane, ndërsa vitet numërohen që nga lindja e Krishtit. Hebrenjtë i numërojnë vitet që nga viti 376 p.e.r, të cilin ata e konsiderojnë si vitin e krijimit të botës. Kalendarit islamik është kalendar hënor, d.m.th. është bazuar në fazat e ndërrimit të Hënës. Sipas këtij kalendarit, koha llogaritet nga vitit 622, kur Muhameti u nis nga Meka për në Medinë.

Përdorimi i kalendarit ua lehtëson njerëzve planifikimin dhe realizimin më efikas të veprimtarive të ndryshme. Planifikimi i kohës dhe organizimi në kohë janë aftësitë e domosdoshme për njeriun e sotëm. Me njohjen e kalendarit, nxënësit e plotësojnë dhe formojnë konceptin për kohën. Këtë vit fëmijët ushtrohen në orientimin në kalendar. Ata i shënojnë datat e rëndësishme e festat dhe i lidhin ato me veprimtaritë vetjake. Dallojnë ditët e punës dhe ditët e fundjavës, planifikojnë kohën e vet në varësi nga ajo se cila ditë e javës është (p.sh. cilat orë mësimi kanë ...) dhe cila stinë e vitit është. Bisedohet për festat e dimrit. Si i presin dhe si i festojnë festat? Kuptojnë nocionin festë. Festat familjare i shënojnë brenda rrethit familjar dhe ato kanë një rëndësi të veçantë për anëtarët e familjes. Festat fetare i festojnë pjesëtarët e një feje të caktuar. Festat shtetërore i festojmë të gjithë.



KA RËNË BORË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të përshkruhen ndryshimet e natyrës në periudhën e dimrit• të vihen re veprimtaritë e njerëzve e të kafshëve në dimër• të vihet re se ndryshimet në mjedisin përreth janë nganjëherë të këndshme, ndërsa nganjëherë të dëmshme për bimët e për kafshët
Fjalë kyçe	dimër, borë, akull, gjumë dimri, strofull (strofkë), katastrofë natyrore, dita më e shkurtër,

Veprimtaritë e propozuara

1. Mbahen shënime për motin gjatë një jave dhe krahasohen ato me motin në vjeshtë.
2. Vizatohet garderoba/veshmbathja e dimrit dhe e verës.
3. Kujtohet deri në ç'kohë mund të luajnë jashtë gjatë verës dhe sa zgjat dita. Vihet re se dita më e shkurtër është në dimër. Nxënësit matin në shtëpi kohëzgjatjen e ditës e të natës.
4. Shihen drurët në mjedisin përreth. Vihen re ndryshimet në pamjen e drurëve gjetherënës në vjeshtë dhe në dimër.
5. Vizatohet druri gjetherënës dhe gjethembajtës në dimër.
6. Emërtohen kafshët që shihen në mjedisin përreth. Komentohen veprimtaritë e tyre. Si e gjejnë ushqimin? Si mund t'u ndihmojë atyre fëmijët?
7. Përgatiten kuti ushqyese për zogjtë. Ajo mund të mos jetë kuti ushqyese klasike, si ajo që shihet në parqe dhe në oborre, por mund të bëhet me boçe, me fara, me thërrime buke, me margarinë e me spango. Farat, thërrimet e bukës dhe margarinën i përziejnë dhe me to mbushet boça e vjetër e pishës. Boçen e lidhin me spango dhe me ndihmën e të rriturve e varim në drurin më të afërt.
8. Improvizohet "stuhia e borës". Nevojitet kavanozi me kapak, plastelina, zami rezistent ndaj ujit, uji, orizi dhe flluskat prej sapuni. Në pjesën e brendshme të kapakut ngjiten me zam rezistent ndaj ujit shtëpiza dhe bregorja e vogël prej plasteline. Kavanozi mbushet gati plot me ujë, shtohen në të flluska sapuni shumëngjyrëshe, pak oriz dhe mbyllet kapaku. Tundet kavanozi dhe kthehet përmbys, në mënyrë që të krijohet "stuhia e dëborës".
9. Bisedohet për festat dimërore.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura ilustruese e pyllit në dimër dhe krahasohet me atë të vjeshtës. Si është dukur atëherë pylli dhe si duket tani ai? Ç'kafshë që tregojnë dimrin nuk gjenden në figurën ilustruese? Pse nuk gjenden ato? Ku janë ato? Vihet re akulli. Prej kujt është krijuar dhe si është krijuar?
2. Bisedohet për reshjet gjatë dimrit. Komentohet pamja e detit gjatë dimrit. Çfarë mund të ndodhë me degën, nëse në të ka shumë borë? A bie bora në vendet bregdetare? Si është moti në vendet e bregdetit?
3. Shihet figura ilustruese e vendbanimit në dimër dhe krahasohet me atë të vjeshtës. Bisedohet për veprimtaritë e njerëzve gjatë dimrit. Nxënësit tregojnë veprimtaritë e veta gjatë dimrit. Ç'lojëra luajnë në dimër?



4. Bisedohet për mënyrën e të ushqyerit të zogjve gjatë dimrit. Si mund t'u ndihmohet zogjve? Vihet re se dita është më e shkurtër. Sa zgjat dita tani në raport me ditën në verë dhe në vjeshtë? Lexohet teksti pranë figurës në të cilën është paraqitur kohëzgjatja e ditës dhe e natës. Kur është dita më e shkurtër dhe nata më e gjatë? Cila stinë e vitit fillon atëherë? Cila stinë e vitit ka përfunduar? Cila është stina pasuese?

Puna me Fletoren e punës

1. Vizatohet druri "vetjak" i dimrit.
2. Bëhen fjollat e borës prej letre sipas udhëzimit. Fjollat e borës mund të varen në "drurin e dimrit".
3. Plotësohet fjalëkryqi. Zgjidhja e fjalëkryqit është STROFKA. Shpjegohet se ç'është strofka; Cilat kafshë e kalojnë dimrin në të?
4. Lexohen vargjet dhe shkruhet se cila kafshë përshkruhet në to.

Mjetet ndihmëse

kavanozi me kapak, zami rezistent ndaj ujit, plastelina, orizi, guaca, boça e pishës, farat, margarina, spangoja.

UJI DHE AKULLI

Qëllimet

- të njihen gjendjet agregate të ujit (akulli, bora, uji si lëng.)
- të vihet re se akulli dhe bora janë ujë në gjendje të ngurtë
- të vihet re se prej borës e akullit përftohet uji në gjendje të lëngët dhe se uji mund të ngrijë

Fjalë kyçe

ujë, borë, akull, hej akulli, ngricë, brymë, shtrat bore, gjendje e ngurtë e ujit, ngrirje, ngrohje

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet për veshjen kur është ftohtë: ç'rrobe veshim, prej ç'materiali është e punuar veshja, ç'këpucë mbathim? Për dimër na duhen rrobet e ngrohta, për rrokullisjen në borë na duhen rrobet dhe këpucët e ngrohta dhe të padërtueshme nga uji. Pse lagemi në borë?
2. Kur bie borë, nxënësit nxirren në shëtitje. Shihet se ku është grumbulluar bora (në çati, në parmakë, në drurë ...), sa është trashësia e dëborës dhe si ka ndryshuar ajo në rrugën e shkelur?
3. Modelohet bora dhe bëhen skulpturat e formave të ndryshme. Bora shtypet, rrokulliset, shtohet dhe hiqet. Mund të vihet re se, nëse bora ngjishet, prej një topi bore mund të përftohet një top akulli. Me anë të ngjeshjes, nga bora nxirret ajri dhe atëherë krijohet akulli.



4. Mbushen dy kova me borë. Në njëërën, bora shtypet deri sa ajo të mbushet plot. Në tjetrën, mbushet me borë deri në majë, por pa e shtypur borën. Kovat sillen në klasë. Vihet re se çfarë ndodh me borën. Ku shkrin më shpejt bora? Supozohet se në cilën kovë do të ketë më shumë ujë. Kur të shkrijë bora, verifikohen supozimet.
5. Disa gota të tejdukshme mbushen me borë. Bora ngjyroset me bojërat që përdoren për ushqime. Ç'ngjyrë ka bora/uji i shkrire? Vihet re se uji ka ngjyrën e borës.
6. Në shtëpi përgatitet akullorja prej frutave. Në enën për akull hidhet shurupi i frutave. Në çdo porcion vihet pipi thithës dhe shkopi prej druri, pastaj bëhet ngrirja.
7. Hidhet kripa mbi akull. Vihet re sesi shkrihet akulli në vendin ku është hedhur kripa.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen e komentohen fotografitë. Çfarë ndodh, kur bën ftohtë? Prej kujt krijohet akulli?
2. Çfarë bie, kur është ftohtë? Çfarë bën iriçi? Ku fle ai? Çfarë u pëlqen fëmijëve të bëjnë, kur bie borë? Fëmijët flasin për përvojën që kanë ata me borën dhe me akullin. Çfarë shfaqet në cepat e çative? Shpjegohet se, kur koha ngrohet, hejet e akullit mund të thyhen dhe për këtë arsye duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Kur mbulohen nga avulli xhamat?
3. Shihen figurat ilustruese të fëmijëve me Burrin prej bore. Çfarë bëjnë fëmijët në figurën e parë? Si është qielli? Në ç'gjë ndryshon figura e dytë? Çfarë ka ndodhur? Pse ka ndodhur? Si mund të mbrohet Burri prej bore, që të mos shkrihet? Ai bëhet në një vend me hije.
4. Shihet figura dhe lexohen fjalët lart e poshtë: uji, akulli. Pastaj lexohen fjalët brenda shigjetave; ftohim; ngrohim. I gjithë shkrimi lexohet kështu: ujin e ftohim dhe krijohet akulli, akullin e ngrohim dhe krijohet uji. Ushtrimi përsëritet disa herë.

Puna me Fletoren e punës

1. Shkronjat janë të shpërndara. Shkronjat lidhen dhe përftohen fjalët: uji, akulli, bora.
2. Shihen vizatimet dhe vihen re ndryshimet.
3. Shihen uji, akulli dhe akullorja. Vihen re tiparet a vetitë dhe shkruhen ato në tabelë? Cilat janë ngjasimet dhe ndryshimet?
4. Në shtëpi bëhet eksperimenti. Në një shishe plastike hidhet uji, por pa e mbushur atë deri në majë. Me marker shënohet lartësia e ujit në shishe. Mbyllet shishja dhe vihet në frigorifer. Bëhet supozimi dhe vizatohet ajo që do të ndodhë. Pas disa orësh shishja nxirret nga frigoriferi. Çfarë ka ndodhur? Vizatohet dhe përshkruhet ajo që është vënë re.

Mjetet ndihmëse

kova e ujit, gotat e tejdukshme, bojërat për ushqime, kripa, shishja plastike, markeri.



KALENDARI

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihet kalendari• të dallohen ngjarjet sipas renditjes kohore: sot, dje, nesër, ditët e javës• të përdoren fjalët për kohën: ditë, javë, muaj, vit
Fjalë kyçe	ditë, javë, muaj, vit, ditë jave, fundjavë, dje, sot, nesër, ditë pune, ditë pushimi

Veprimtaritë e propozuara

1. Njihen llojet e ndryshme të kalendarëve (kalendar muri, kalendar xhapi, kalendar tavoline). Nxënësit njihen me simbolet e ndryshme në kalendare (shkurtime për emërtimet e ditëve, shënimi i festave, ngjyrat e ndryshme ..).
2. Nxënësit gjejnë dhe shënojnë në kalendar ditëlindjet e veta. Mësohet se cilët nxënës e festojnë ditëlindjen në të njëjtin muaj: Nxënësit dijnë ta thonë datëlindjen e vet.
3. Bëhet treni prej letre të fortë (hameri). Pritet lokomotiva dhe vagonët. Në lokomotivë është shenja e klasës (paraleles). Vagona janë aq, sa nxënës ka në klasë (paralele). Në çdo vagon, të renditur kronologjikisht sipas festimit të ditëlindjeve, është fotografia e nxënësit të klasës (paraleles).
4. Vihet re, se me cilin muaj fillon viti. Me cilin mbaron. Sa muaj ka viti? Nga sa ditë kanë muajt? Vihet re, se cilët muaj kanë numrin e njëjtë të ditëve.
5. Cili muaj ka më pak se tridhjetë ditë?
6. Bisedohet për ditët e javës. Në cilën ditë fillon dhe me cilën ditë mbaron java? Cila ditë është sot? Cila ditë ka qenë dje? Cila ditë do të jetë nesër? Cilat janë ditët e fundjavës (uikendit)? Ç'u pëlqen më shumë nxënësve të bëjnë atëherë? Me kë e kalojnë më shpesh fundjavën (uikendin).
7. Këndohet kënga "Java".

Puna me Tekstin mësimor

1. Lexohet teksti i shkruar dhe komentohet kalendari. Numërohen muajt (i pari-janari; i dyti-shkurti ...; kur përfundon viti, fillohet nga fillimi: i pari-janari, i dyti-shkurti dhe kështu me radhë). Bisedohet për rrotullimin e rrethit, në të cilin janë paraqitur muajt. Kur rrethi rrotullohet një herë, ka kaluar një vit. Cili muaj është tani? Gjehet muaji në të cilin ka lindur shoku ose shoqja më e mirë?
2. Shihet kalendari i tavolinës. Cili muaj është paraqitur në të? Sa ditë ka? Cila ditë është shënuar me ngjyrë të kuqe? Pse? Cilën ditë fillon dhe cilën ditë mbaron muaji? Në kalendarin e vitit gjehen muajt që kanë të njëjtin numër ditësh.
3. Lexohet teksti dhe komentohet shiriti i kohës. Vihen re shkurtime për ditët e javës. Si janë shkruar shkurtime (tri shkronjat e para për emërtimin e ditës së javës). Ç'veprimtari, përveç atyre shkollorë, kanë nxënësit gjatë javës?



Cilat ditë janë të parashikuara për pushim? Si i kalojnë këto ditë familjet e nxënësve?

Puna me Fletoren e punës

1. Gjehet data e sotme dhe shënohet me ngjyrën përkatëse.
2. Lexohet teksti që tregon se çfarë bën Markoja këtë javë? Cila ditë është sot? Çfarë bën Markoja të mërkurën? Ku ka qenë dje? Cila ditë është kjo? Ku do të shkojë të enjten? Cila është dita e parë dhe cila dita e dytë e fundjavës (uikendit)? Çfarë do të bëjë Markoja atëherë? Paraqiten me vizatime veprimtaritë e Markos? Cilat ditë nuk janë përmendur në tregimin e Markos (e hëna dhe e premtja)?
3. Cili muaj, sipas radhës, është muaji në të cilin ka lindur Markoja? Cili muaj është ky? Mbi bazën e kalendarit rrethor, shkruajnë muajin në të cilin ka lindur shoku/shoqja e tyre më e mirë.

**Mjetet
ndihmëse**

kalendarët e ndryshëm: i murit, i tavolinës, i xhepit, letra hamer, fotografitë e nxënësve.

FESTOJMË

Qëllimet

- të dallohen festat shtetërore dhe festat fetare
- të vihet re rrjedha kohore e ndodhive

**Fjalë
kyçe**

festë, traditë (zakon), urim

Veprimtaritë e propozuara

1. Të gjehen në kalendar ditët e shënuara me ngjyrë të veçantë. Çfarë tregojnë ato? Ç'festa festohen në familje? Si i festojnë festat? Cilat festa i festojnë me pjesëtarët e familjes dhe cilat me shokë e me miq? Cila festë u pëlqen më shumë dhe pse?
2. Vizatohet festa më e pëlqyer?
3. Përgatiten zbulurimet për Vitin e Ri. Zbukurohet klasa.
4. Përgatitet kartolina e Vitit të Ri. Kujt do t'i dërgohet?
5. Para festës (Ditës së Buzmit, Krishtlindjes, Bajramit) bisedohet për festën e pritme. Çfarë dihet për festën, si festohet, si do të kalohet koha e lirë?
6. Merret pjesë në festimet e kremtimit e shkollës. Përgatiten festimet në klasë (paralele).
7. Shihen fotografitë dhe lexohen tregimet e këngët për festat.



8. Nëse ekziston mundësia, fëmijët marrin pjesë në ballon me maska. Bisedohet për përshtypjet nga balloja me maska. Çfarë është pëlqyer më shumë? Çfarë nuk është pëlqyer? Kush ka ndihmuar më shumë në përgatitjen e maskave?


Puna me Tekstin mësimor

1. Lexohen tekstet dhe komentohen fotografitë. Cilat festa janë paraqitur në to? Si festohen ato? Si festohen këto festa nga nxënësit?

Puna me Fletoren e punës

1. Përgatitet kartolina e urimit. Copa e letrës së fortë (fleta e vizatimit) e formatit A5, paloset, pjesa e jashtme vizatohet, ngjyroset dhe modelohet.
2. Përktohet renditja e duhur e vizatimeve nga Shtojca numër 6 dhe ngjiten ato. Tregohet tregimi. Çfarë bën Markoja dhe babai i tij? Çfarë u mungon atyre? Cilin bredh të Vitit të Ri dëshiron babai dhe cilin Markoja? Cilin bredh e blenë ata? Kush merr pjesë në stolisjen e bredhit? Çfarë kanë bërë me bredhin pas festës së Vitit të Ri?
Nxënësit tregojnë se ç'bredh stolisin ata (natyral apo artificial)? Ç'mendim kanë nxënësit për dëshirën e babait të Markos për ta prerë bredhin në pyll. A u pëlqen atyre ajo për të cilën ata merren vesh? Nxënësit e kuptojnë se bredhin në saksi mund ta zbukurojnë disa vjet me radhë. Propozojnë se çfarë do të bëjnë me të, kur ai të rritet? Ku mund ta mbjellin pastaj bredhin?
3. Nxënësit vizatojnë festimin e Vitit të Ri në shtëpinë e tyre.
4. Bisedojmë për ditët e javës. Me ç'ditë fillon dhe me ç'ditë mbaron java? Cila ditë është sot? Cila ditë ka qenë dje? Cila ditë do të jetë nesër? Cilat janë ditët e uikendit? Çfarë dëshirojnë të punojnë atëherë më shumë? Me kë e kalojnë më shumë uikendin?
5. Këndojnë këngën "Java".

Mjetet ndihmëse	fotografitë, tregimet e këngët për festat, letër kolazhi, gërshtëret.
----------------------------	---




KUJDESEM PËR VETVETEN

Kapitulli Kujdesem për vetveten përmban tri tema mësimi: *Trupi im, Ushqimi, Jetoj në mënyrë të shëndetshme.*

Qëllimet që realizohen me këtë kapitull janë që nxënësit: të vënë re se për të jetuar nevojitet ajri, ushqimi, uji; të mësojnë se ushqimi përmban materiet që janë të nevojshme për rritjen dhe për zhvillimin e rregullt; të mësojnë se, përveç se futin materiet në organizëm, ata i përpunojnë ato në organizëm dhe diçka prej kësaj ia kthejnë mjedisit përreth (nxjerrin ajër, sekretojnë); të kuptojnë rëndësinë e veprimtarisë fizike për një jetë të shëndetshme; të fitojnë aftësi për ruajtjen dhe për zhvillimin e shëndetit; të zgjerojnë njohuritë për trupin e vet; të flasin për shqisat (aromën, shijen, prekjën).

Shëndeti i mirë ndihmohet nga ushqimi i rregullt, nga veprimtaria fizike, nga qëndrimi në ajër të pastër, nga higjiena vetjake dhe nga mbrojtja e ruajtja e tij. Ushqimi u nevojitet të gjitha qenieve të gjalla; prej tij përftohet energjia që nevojitet për lëvizje, për rritje, për shumëzim Qeniet e gjalla dallohen nga ajo se me se ushqehen. Bimët e prodhojnë vetë ushqimin, ndërsa kafshët janë të lidhura në ushqim drejtpërdrejt ose indirekt me bimët. Kafshët ushqehen me bimë (bimëngrënësit), me kafshë (mishngrënësit), disa me bimë e me kafshë (gjithçkangrënësit). Njerëzit dhe kafshët e marrin ushqimin përmes gojës (fillimi i organeve të tretjes), prej nga ai me përtpje dhe duke u përzier me pështymën shkon në stomak, ndërsa prej këtej në zorrë. Ushqimi shpërbëhet; tretet, ndërsa pastaj kalon në gjak dhe me anë të gjakut, shkon deri në të gjitha pjesët e trupit. Materiet e panevojshme dhe të papërpunuara i sekretojmë me anë të jashtëqitjes. Në jashtëqitje ndodhen bakteriet që ndihmojnë në prishjen e ushqimit, prandaj theksojmë sesa e rëndësishme është që, pasi të kemi qenë në banjo, t'i lajmë duart.

Bisedohet për shprehitë lidhur me mënyrën e të ushqyerit. Flitet për ushqimin që marrim dhe theksohet rëndësia e të ushqyerit të rregullt (me thënien ushqim i rregullt nënkuptohet ushqimi i shumëllojshëm dhe i balansuar). Ushqimin mund ta përgatisim në mënyra të ndryshme (ta ziejmë, ta pjekim, ta thajmë ...), por është mirë që sa më shumë produkte ushqimore t'i marrim në gjendje të freskët, të papërpunuar. Është e rëndësishme të konsumojmë mjaft perime dhe fruta (proteina, vitamina), ndërsa më pak yndyra dhe sheqer dhe ta shmangim të ashtq. ushqim i shpejtë, si dhe ushqimin që përmban konservantët, sheqernat dhe aromatikët artificialë. Gjithashtu, ushqimi nuk duhet kripur e ëmbëlsuar tepër. Bisedohet për kujdesin që tregohet në familje për të ushqyerit e rregullt. Fëmijëve u kujtojmë pasojat e konsumimit të tepërt të ëmbëlsirave (dhjamosja a shëndoshja, kariesi i dhëmbëve). Flitet për rëndësinë e larjes së rregullt dhe të mirë të dhëmbëve pas çdo vakti ngrënie. Bisedohet për reagimin e organizmit të fëmijëve, kur janë të uritur dhe si reagon organizmi i tyre kur hanë ushqim të tepërt!? Kur janë të uritur, ndjejnë kërcitjen e zorrëve, ose, nëse marrin sasi të tepruar ushqimi, ata ndjejnë ngarkesë në stomak. Ushqimi i prishur (afati i skaduar i përdorimit, mbrojtja



dhe ruajtja e papërshtatshme e ushqimeve) mund të shkaktojë helmim. Me anë të eksperimenteve të vogla, nxënësit vërtetojnë se çfarë ndodh me ushqimet e ndryshme në kushtet e ndryshme (p.sh. çfarë ndodh me qumështin, nëse lihet për një kohë të gjatë në një vend të ngrohtë).

Përveç ushqimit, organizmit i nevojiten edhe lëngjet. Organizmi ynë përmban mjaft ujë dhe trupi ynë mund të jetojë pa ujë shumë më shkurt sesa pa ushqim. Bisedohet për rëndësinë që ka marrja e mjaftueshme e lëngjeve, sidomos kur jemi fizikisht aktivë. Edhe veprimtaria fizike ndihmon për një shëndet të mirë dhe për zhvillimin e duhur të organizmit. Trupi ynë përmes lëkurës sekreton djersën, e cila përmban kripëra të tretura dhe materiet e panevojshme. Fëmijëve u kujtojmë se çfarë ndodh, kur ata janë fizikisht aktivë, ose kur kanë të nxehtë. Djersa avullon nga lëkura dhe u ftoh atyre lëkurën dhe tërë organizmin.

Shëndeti ndihmohet edhe nga mirëmbajtje e rregullt dhe siç duhet e higjienës. Bisedohet për rëndësinë e mirëmbajtjes së higjienës së trupit dhe për sjelljen e duhur që na ndihmon në ruajtjen e shëndetit. Flitet për rëndësinë e vizitave të rregullta tek dentisti a tek mjeku dhe për kontrollimin e rregullt të shëndetit.



TRUPI IM

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">të dihet se çfarë i duhet njeriut e qenieve të tjera për të jetuartë dihet se nga mjedisi përreth diçka merret, përpunohet dhe i jepet atij (jashtëqitja)
Fjalë kyçe	shqisë (të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të prekurit), ushqim, pije, ajër, përpunim, jashtëqitje, frymëmarrje, djersitje.

Veprimtaritë e propozuara

1. Thuhet se çfarë u duhet kafshëve që mbarështojnë në klasë (peshqve të akuariumit, merimangës, miut...) për të jetuar: ushqimi, uji, ajri. Çfarë do të ndodhte, nëse do të ndërpritej t'u jepej atyre ushqim dhe ujë? Pse duhet të nxirret qeni në shëtitje? Pse ndërrohet uji në akuarium dhe pse pastrohet kafazi në të cilin është zogu a miu? Çfarë u nevojitet bimëve? Çfarë ndodh me bimët, nëse lihen në një vend të errët, pa ujë ose nxirren prej dheut? Parashikohet se çfarë u nevojitet atyre për të jetuar. Si ndjehemi, kur kemi uri?
2. Nxënësit ndjekin frymëmarrjen e vet. Vrapojnë një rreth ose luajnë lojën "Dita e nata". Të vihet re ndryshimi në frymëmarrje para dhe pas vrapimit (lojës). Vihet re se frymëmarrja është e shpejtuar. Disa nxënës mund të kenë djersitur. Bisedohet për atë që ka ndodhur.
3. Nxjerrin frymën në pasqyrë. Vihet re se pasqyra është djersitur për shkak të të avullit të ujit që gjendet në mushkëri.
4. Organizohet loja "Lexojmë pa presje" (zgjidhet një tekst i njohur). Jepet detyrë që me një të marrë fryme të lexohen sa më shumë rreshta nga teksti i caktuar, ndërsa fitues shpallet nxënësi që lexon më shumë fjalë. Vihet re se nuk mund të lexohet pa marrë frymë.
5. Kyçi i dorës mbështillet me një qese plasmasi. Pas një farë kohe qesja do të djersitet, ndërsa lëkura poshtë saj do të jetë e lagët. Bisedohet për atë që ka ndodhur.
6. Bima e mbjellë në saksi mbështillet me një qese të tejdukshme plasmasi, lidhet dhe vihet në një vend të ngrohtë. Ndiqet ajo që ndodh. Çfarë ka ndodhur? Pas një kohe të caktuar, qesja është djersitur dhe shfaqen pikëza uji.
7. Bisedohet me nxënësit për atë që u pëlqen të hanë. A mund ta zgjedhin ushqimin, nëse nuk e shohin, por vetëm e nuhatin, e dëgjojnë ose prekin me gishta? Nxënësve u lidhen sytë me shami. U ofrohet një copë fruti, zarzavateje, biskote, çokollate, një gotë uji Gjejnë llojin e ushqimit me anë të aromës e të shijes. Përshkruhet aroma dhe shija e ushqimit. Nxënësit e kuptojnë se ushqimi ka aromë dhe shije.
8. Tregohet tregimi për rrugën e ushqimit. Nxënësit shprehin me vizatim përfytyrimin e vet për rrugën e ushqimit në trupin e njeriut.
9. Lexohen tekstet që bëjnë fjalë për frymëmarrjen. Si marrin frymë kafshët? Si marrin frymë kafshët që jetojnë në ujë? Pse duhet t'u ndërrohet shpesh uji peshqve të akuariumit?



Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen figurat ilustruese dhe lexohen tekstet e shkruara. Si reagon trupi ynë, kur është ftohtë (dridhet, tundet)? Me cilën pjesë të trupit shihet, dëgjohet ...? Nëse ndonjë nxënës mban syze, bisedohet për atë, sesa herë shkon ai për kontroll tek okulisti. Rikujtohen vizitat sistematike shëndetësore në shkollë. Pse janë të domosdoshme kontrollet e tilla? Përmes cilës pjesë të trupit ndjejmë të ftohtit (lëkurës)? Nxënësit tregojnë përvojën e vet, kur kanë patur ftohtë dhe për ç'arsye kanë patur ftohtë?
2. Bisedohet për atë, se për të jetuar (për të lëvizur, për t'u rritur, për t'u shumëzuar) nevojiten materiet e caktuara; uji, ushqimi, ajri. Ushqimi merret përmes gojës. Kafshohet një copë biskote, përtypet dhe gëlltitet. Me çfarë është kafshuar biskota (me gojë), me çfarë është lëvizur në gojë (me gjuhë). Ç'gjë tjetër ndodh me ushqimin në gojë? (Bëhet më i butë, njomet me pështymë.) Nxënësit përpiqen ta hanë biskotën pa i lëvizur dhëmbët ose gjuhën. Do të arrihet në përfundimin se dhëmbët dhe gjuha janë të domosdoshëm për përpunimin e ushqimit. Rruga e ushqimit nuk mund të shihet, por mund të supozohet se çfarë ndodh me të.
Përveç ushqimit, çdo ditë duhet të marrim edhe lëngjet. Një pjesë të lëngut e marrim përmes ushqimit, kurse pjesën tjetër përmes pijes. Për të jetuar nevojitet edhe ajri, të cilin e thithim nga mjedisi përreth me anë të organeve të frymëmarrjes. Nxënësit marrin e nxjerrin frymë. Cila pjesë e trupit ngrihet lart, kur thithet ajri (mushkëritë; krahërori). Çfarë ndodh kur nxirret frymë?
Kur futen ushqimi dhe pija në organizëm, ato qëndrojnë e përpunohen për një farë kohe në organizëm, ndërsa pjesa që nuk përpunohet ose që nuk duhet, nxirret jashtë me jashtëqitje (përmes urinës e feçës). Theksohet se ka shumë rëndësi që, pas çdo jashtëqitjeje, duart duhet të lahen patjetër, sepse në urinë e feçe ka shumë bakterie. Çfarë ndodh, nëse pihen shumë lëngje? Lëngjet nxirren jashtë edhe me anë të djersitjes Ujë sekretohet shumë më tepër, kur është nxehtë, sepse atëherë djersitemi më shumë. Prandaj është e nevojshme të merret sasia e mjaftueshme e ujit (fëmijët 1 litër në ditë). Me frymënxjerrje nxirret jashtë avulli që nuk i nevojitet më trupit. Edhe kafshët ushqehen dhe kanë jashtëqitje.
3. Shihet figura ilustruese dhe komentohet. Vihet re rruga që bën ushqimi. Matet madhësia e stomakut para marrjes së ushqimit dhe pas ngrënies; ndjehet ngarkesa në stomak. Bisedohet për atë se çfarë ndjehet, kur ndjehet uri. Kur kërcasin zorrët?

Puna me Fletoren e punës

1. Lidhen shqisat me fjalët përkatëse.
2. Zgjidhet rebusi: Zgjidhja e rebusit është: uji, ushqimi, ajri.
3. Shkruhet menyuja e ditës. Nxënësit bisedojnë për ushqimet që u pëlqejnë më shumë të hanë. Pse duhet të konsumohen ushqimet e shumëllojshme?

Mjetet ndihmëse

pasqyrat, qeset e najlonit, enciklopeditë, bimët në saksi, biskotat, metri.



USHQIMI

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re rëndësia e ushqimit të shumëllojshëm• të mësohet se ushqimi priset
Fjalë kyçe	ushqim: fruta, perime, qumësht, produkte qumështi, mish, ushqim i rregullt, ushqim i shumëllojshëm; ushqimi priset, thahet, myket: ngrirje e ushqimit, tharje e ushqimit.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit thonë se me çfarë ushqehen kafshët që mbajnë në klasë (peshqit e akuariumit, breshka, miu, merimanga ...). Bisedohet për atë, se me ç'gjë ushqehen kafshët e tjera: macja, qeni, lopa A mund të jetojnë pa ushqim kafshët?
2. Bisedohet për atë, se prej nga vjen ushqimi. Tregohet tregimi për krijimin e qumështit. Paraqitet me vizatim rruga e qumështit nga livadhi deri në tryezën e ngrënies. Supozohet se nga vjen pureja, sallata, kifla
3. Sillen në klasë ambalazhet e ndryshme, në të cilat ka qenë ushqimi: kuti biskotash e kornfleksi, qeset për makarona, tetrapak qumështi, gota plastike për jogurt me fruta, ambalazhim çokollatash, bonbonesh, salcash Bisedohet për përbërjen e ushqimit. Ndahen ushqimet në ato: prej mielli, prej perimesh, prej mishi, prej qumështi.
4. Ushqimi ka afatin e përdorimit dhe ky afat mund të jetë më i gjatë ose më i shkurtër në kohë: Buka myket, ndërsa frutat e perimet kalben ose vyshken. Ushqimi i prishur mund të shkaktojë helmim. Bisedohet me nxënësit se ku vendoset ushqimi.
5. Në shtëpi, nxënësit futin një bukë në një qese najloni, kurse një tjetër e lënë në një vend të hapur. Pas shtatë ditësh bukët sillen në shkollë. Shihet se çfarë ka ndodhur me to. Bisedohet për atë që është vënë re. A mund të mbetet buka e freskët për një kohë të gjatë? Jo, prandaj ajo blihet çdo ditë. A blejmë çdo ditë frutat, perimet dhe mishin? Si zgjatat afati i përdorimit të tyre?
6. Në një gotë zbrazet qumështi dhe lihet në një vend të ngrohtë (pranë radiatorit, në diell). Një ditë më pas qumështi zbrazet në një pjatë dhe shihet sesi ka ndryshuar (ka ndryshuar aroma dhe pamja, qumështi është i thartë, është trashur dhe më shumë ngjason me kosin). Si mund të pengohet prishja e qumështit? Qumështi nuk do të priset në frigorifer, sepse gjendet në një vend të ftohtë.
7. Molla ndahet përgjysmë. Mbi njërin gjysmë të mollës shtrydhet limoni, duke e mbuluar sipërfaqen e prerë. Në fund të orës së mësimin shihet ndryshimi në gjysmën e mollës. Çfarë ka ndodhur me gjysmën tjetër të mollës, në të cilën nuk kanë shtrydhur limonin? Si ka ndryshuar?
8. Nëse ekziston mundësia, nxënësit shkojnë në dyqanin më të afërt të vetëshërbimit, i cili është i pajisur mirë. Me vete marrin fletoren dhe stilolapsin. Nxënësit ndahen në tri grupe. Grupi i parë vizaton a regjistron gjithçka që është e ngrirë, i dyti regjistron ushqimet e konservuara, kurse i treti ushqimet e thata.



Puna me Tekstin mësimor

1. Komentohet vizatimi. Ku duhet ta vërë Stefani ushqimin nga tryeza, në mënyrë që ai të ruhet sa më gjatë?
2. Vlefshmëria e ushqimit zgjatet duke e mbajtur në frigorifer ose duke e ngrirë. Ushqimi mund të ruhet edhe duke e përpunuar siç duhet. Nëse nga ushqimi veçohet uji, ai mund të ruhet për një kohë më të gjatë. Kështu, një ushqim thahet (frutat, mishi ...), kurse një tjeri i shtohet sheqer, zihet, vihet në uthull ose i shtohet lëng limoni.

Puna me Fletoren e punës

1. Komentohen figurat ilustruese. Qarkohet se çfarë prej ushqimeve të paraqitura ruhet në frigorifer.
2. Shkruhet receta e gjellës së preferuar (pasta, akullorja ...).
3. Bisedohet për mënyrën sesi krijohet ushqimi. Vizatohet përfytyrimi i nxënësve për mënyrën si përftohet djathi, lëngu i frutave, mjalti dhe mishi i thatë

Mjetet ndihmëse

molla, limoni, ambalazhet e ushqimeve

JETOJ NË MËNYRË TË SHËNDETSHME

Qëllimet

- të vihet re rëndësia që ka ushqimi i shumëllojshëm për shëndetin e njeriut
- të vihet re se njerëzit ndjejnë më mirë, nëse janë rregullisht fizikisht aktivë
- të zgjerohen njohuritë dhe shkathtësitë që mundësojnë kujdesin për shëndetin vetjak
- të vihet re rëndësia që ka ruajtja e dhëmbëve të shëndoshë

Fjalë kyçe

shëndet, ushqim i rregullt, higjienë, higjienë personale, stomatolog (dentist), vaksinë, vitaminë.

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet me nxënësit për ushqimin që hanë më shpesh. Tregojnë sa shpesh hanë fruta, perime e mish. Sa ujë pijnë gjatë një dite? Pse s' duhet t'i konsumojnë më tepri ëmbëlsirat dhe të pijnë pijet e gazuara? Në një fletë dyshe paraqitet mënyja e "shëndetshme" dhe "jo e shëndetshme".
2. Bisedohet me nxënësit për ujin që pijnë gjatë një dite. Lexohen tekstet për rëndësinë që ka marrja e ujit nga organizmat e të gjitha qenieve të gjalla. Vrojtohet lëkura në gjendjet aktive. Kur djersitim më shumë?



3. Bisedohet me nxënësit për larjen e dhëmbëve; sa herë në ditë i lajnë dhëmbët, si i lajnë dhe sa kohë zgjat larja ...? Demonstrrohet larja e dhëmbëve. Komentohe se pse dhëmbët duhet të lahen tre minuta (kaq është e nevojshme që dhëmbët të lahen plotësisht).
4. Organizohet vizita tek mjeku stomatolog. Bisedohet për rëndësinë e higjienës së gojës e të dhëmbëve. Paraprakisht përgatiten pyetjet për intervistën.
5. Në kuti vihen mjetet për mirëmbajtjen e higjienës. Nxënësit i nxjerrin ato një nga një dhe përshkruajnë funksionet e tyre.
6. Ftohen në klasë përfaqësuesit e Shoqatës së pylltarëve, të alpinistëve ose të vrojtuesve të natyrës. Bisedohet për veprimtaritë e tyre dhe mësohet, sesi duhet të sillen në natyrë.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen figurat ilustruese dhe vihet re se ushqimi i ndryshëm ndikon në rritjen dhe në zhvillimin e trupit. Pse është i gëzuar Markoja në figurën që flet për shëndetin? Komentohe se ç'gjë tjetër duhet të hahet për rritjen dhe zhvillimin e mirë. Cili ushqim siguron fuqinë më të madhe dhe cili rritjen më të mirë? Vihet re rëndësia e ushqimit të shumëllojshëm.
2. Bisedohet për rëndësinë e mbajtjes së higjienës së trupit, për masat që duhen ndërmarrë dhe për mjetet që duhet të përdorim për ruajtjen e shëndetit. Shihen pajisjet për mirëmbajtjen e higjienës së trupit. Nxënësit duhet të kujdesen vetë për higjienën personale. Ata tregojnë sa shpesh bëjnë dush dhe i lajnë flokët. Pse nuk duhet të përdoret krehëri, furça e dhëmbëve dhe peshqiri i personave të tjerë?
3. Bisedohet për vizitat e rregullta tek stomatologu dhe për vaksinimin e rregullt. Pse është e domosdoshme të bëhet vakcina? Rikujtohen vizitat sistematike tek mjeku. Tregohet se pse është e rëndësishme vizita sistematike. Nxirret përfundimi se tek mjeku nuk duhet të shkohet vetëm kur jemi të sëmurë.
4. Tregohet se për shëndet duhet të dilet përjashta në ajër të pastër, të merremi me sport dhe të flejmë sa duhet. Loja, sporti, argëtimi dhe pushimi ndihmojnë për një shëndet të mirë. Shprehin supozimet e veta për thënien: "Mendje e shëndoshë, në trup të shëndoshë."

Puna me Fletoren e punës

1. Tregohet se çfarë mund ta hamë ashtu siç është dhe çfarë duhet ta gatuajmë.
2. Janë paraqitur pajisjet e ndryshme që përdoren për higjienën personale, për higjienën e shtëpisë dhe për mirëmbajtjen e veshmbathjes. Nxënësit duhet të hartojnë listën e mjeteve e të pajisjeve që përdorin për higjienën personale.
3. Bisedohet për atë që bëhet çdo ditë. Shihen dhe komentohe vizatimet. Nxënësit tregojnë se çfarë bëjnë çdo ditë. Çdo nxënës numëron veprimtaritë e shënuara. Nëse kanë më shumë se 7 shenja, do të thotë se jetojnë në mënyrë mjaft të shëndetshme.
4. Lexohen pohimet e shënuara dhe qarkojnë me PO, nëse është e saktë dhe me JO, nëse është e pasaktë. Verifikohen nga vetë nxënësit përgjigjet e zgjidhjeve poshtë detyrës.



PRANVERA ERDHI

Në kuadër të kapitullit me emrin “Pranvera erdhi”, përmes temave të zgjedhura të mësimimit dhe të lidhura me njëra-tjetrën, nxënësve u rikujtojmë atë që është shpjeguar gjatë vitit të shkuar shkollor dhe është thënë për ndryshimet natyrore gjatë vitit. Në kuadrin e përbashkët të këtij kapitulli kemi përfshirë gjashtë tema të lidhura me përcaktime të përafërta: *Pema ndryshon, Prej nga vjen ushqimi, Majdanozi dhe speci, Në livadh, Liqeni, Të ngjashëm, por të ndryshëm.*

Duke realizuar këto tema mësimi, nxënësit do t’i thellojnë njohuritë për ndryshimet në natyrë dhe për veprimtaritë e njerëzve në pranverë, do ta krahasojnë këtë stinë të vitit me stinën paraardhëse, do të vërejnë dallimet midis stinëve të vitit në aspekte të ndryshme, do t’i njohin dhe do të shqyrtojnë disa veprimtari të njerëzve të cilat janë karakteristike për stinët e caktuara të vitit, dhe, në këtë rast, do të mësojnë më shumë për mënyrat e kryerjes së këtyre veprimtarive; do të mësojnë për aftësitë e nevojshme gjatë përdorimit të veglave e të mjeteve të punës për prodhimin e ushqimit; do të zhvillojnë të kuptuarit për lidhjen midis qenieve të gjalla; do të vërejnë se qeniet e gjalla janë të lidhura me mjediset e ndryshme dhe se ato dallohen mjaft për nga disa karakteristika, por se ato kanë edhe disa karakteristika të përbashkëta

Edhe vitin e shkuar, edhe këtë vit shkollor është folur për ndryshimet në natyrë, tek bimët, tek kafshët dhe në veprimtaritë e njerëzve. Vazhdohet që, përmes veprimtarive të ndryshme, duke zbatuar metodat e ndryshme njohëse (hulumtimin, eksperimentimin, vëzhgimin, krahasimin ...) t’u mundësohet nxënësve që të mësojnë diçka më shumë për ndryshimet e shumta në pranverë. Dilet në oborrin e shkollës, shkohet në park, në livadh apo një lëndinë me bar dhe shfrytëzohet rasti që t’u mundësohet nxënësve që të dallojnë vetë ndryshimet në botën e bimëve (rritja, gjethimi, lulëzimi). Bisedohet për ndryshimet në jetën e kafshëve; zgjimi nga gjumi i dimrit, kthimi i zogjve, ndërrimi i puplave apo i gëzofit, pjellja e të vegjëleve

Bisedohet me nxënësit edhe për veprimtaritë e njerëzve në pranverë. Ata dallojnë veprimtaritë e ndryshme në pranverë; rregullohen parqet, bahçet, kopshtet, arat, ... prashiten bimët, krasiten e merren masat mbrojtëse për drufrutorët. Toka përgatitet për mbjelljen e perimeve e të luleve. Në këto veprimtari mund të marrin pjesë edhe fëmijët. Kemi biseduar tashmë për veprimtaritë e ndryshme të pranverës në qytet dhe në fshat. Të rriturit dhe fëmijët në qytet kujdesen për bimët dhe për lulet në banesat e veta, në ambientet e punës, në oborre, në kopshte, në parqe. Në fshat dhe në vendbanimet në periferi të qytetit, njerëzit e punojnë tokën dhe mbjellin; në punë përdorin vegla e mjete pune të ndryshme. Kujtohen veprimtaritë e njerëzve në arë, në livadh, në kopsht dhe në pemishte. Ç’vegla e mjete pune janë të nevojshme për këto punë? Duke përdorur Tekstin e mësimimit, filmat, enciklopeditë, aplikimet, por edhe përmes përvojës së drejtpërdrejtë dhe vrojtimit gjatë vizitës në një fermë fshati, nxënësit shkëmbejnë njohuritë dhe idetë për mënyrat e kultivimit, e mirëmbajtjes dhe të mbrojtjes së bimëve. Bisedohet për



rëndësinë e bimëve në ushqim. Pse na nevojiten domosdoshmërisht perimet e frutat? Ç'fryte konsumojmë në gjendje të papërpunuar (të gjalla) dhe cilat në gjendje të përpunuar?

Organizmat e ndryshëm jetojnë në mjedise të ndryshme, ndërsa e përbashkëta e tyre është se të gjithë ata i janë përshtatur mjedisit në të cilin jetojnë. Kafshët dhe bimët që jetojnë në mjedise jetësore (kushte) të ngjashme apo të njëjta, kanë edhe karakteristikat e përbashkëta.

Livadhi është ekosistemi që ruhet falë veprimtarisë së njeriut; me kositje. Për këtë arsye në livadh nuk zhvillohen format drusore, ndërsa nuk ka thuajse asnjë bimë njëvjeçare. Në livadh rriten bimët, lulja e të cilëve rritet fare pranë tokës, kështu që kosa nuk i dëmton (lulequmështorja, lulebora etj.). Në rrënjën apo në pjesën e nëndheshme të kërcellit (tuberi, qepujka) bimët livadhore mund ta ruajnë ushqimin rezervë, prandaj rriten e lulëzojnë shpejt në pranverë. Barërat kanë aftësi të madhe ripërtëritëse. Ato kanë rrënjë xhufkore, nuk mund ta thithin ujin nga shtresat e thella të tokës, por atyre u ndihmon shiu gjatë ditëve të pranverës. Disa bimë livadhore pllenohen nga era, ndërsa disa të tjera nga insektet. Bimët që pllenohen nga insektet kanë lule me ngjyra të spikatura, janë aromatike, e kanë polenin ngjites. Bimët që pllenohen nga era kanë lule jo të spikatura dhe joaromatike. Frytet dhe farat shpërndahen nga era, nga uji dhe nga kafshët, ndërsa shumë prej tyre i përhap edhe njeriu. Bimët që mbijnë e që rriten shpejt në sipërfaqe të ndryshme, quhen barëra të këqija. Barërat e këqija jetojnë shkurt, por prodhojnë shumë fara. Në livadh mund të vihen re shumë insekte. Në kërkim të ushqimit (polenit, nektarit) insektet i pllenojnë bimët; e përhapin polenin nga njëra lule në tjetrën. Kafshët që jetojnë nën tokë, i janë përshtatur mjedisit pa, apo me pak ndriçim dhe me shumë lagështirë. Në hapësirën e errët orientohen me ndihmën e shqisës së të prekurit dhe të nuhaturit.

Në dallim nga bimët me kërcell të livadheve, shumë bimë ujore kanë inde të forta Disa rriten pranë moçaleve apo liqeneve, pjesa më e madhe e kërcellit të tyre ndodhet mbi ujë (kallami i ujit, xunkthi). Të tjerat kanë gjethe dhe lule në sipërfaqen e ujit (zambaku i ujit, lulja e breshkës) apo janë të fundosura nën ujë (algat); duke shikuar nga bregu këto bimë s'mund të dallohen. Peshqit kanë formë hidrodinamike të trupit dhe organe të veçanta për lëvizje; pendët. Përveç peshqve, në ujë apo pranë sipërfaqes së ujit jetojnë edhe kafshët e tjera; çafka, pelikani, bretkosa, gjarpri i ujit. Këto kafshë e gjejnë në ujë ushqimin ose strehimin. Disa janë të lidhura me ujin në një fazë zhvillimi (bretkosat, larvat e disa insekteve).

Kafshët lëvizin në mënyra të ndryshme në varësi të ndërtimit të trupit dhe të mjedisit ku jetojnë. Kafshët përdorin për lëvizje pjesët e ndryshme të trupit; këmbët, pendët, bishtin, tentakulat ose lëvizin me të gjithë trupin. Kafshët në ujë notojnë, lëvizin me të gjithë trupin (p.sh. shushunja), rrëshqasin në sipërfaqe të ujit (heteropterët) apo zvarriten në fundin e ujit. Kafshët tokësore fluturojnë, kërcëjnë, zvarriten.

Qeniet e gjalla lindin, rriten, plaken dhe vdesin. Lënia e pasardhësve, d.m.th. riprodhimi, është vetia bazë e qenieve të gjalla. Bimët shumëzohen me organe të ndryshme; me qepujkë, me kërcell, me gjethe apo me pllenim (lulet). Njerëzit dhe kafshët kanë pasardhës që ngjajnë me prindërit e vet. Nganjëherë ngjashmëria midis prindërve dhe pasardhësve të tyre nuk është e dukshme në pamje të parë.



DRURI NDRYSHON

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të përshkruhen ndryshimet në natyrë që ndodhin në pranverë• të vihen re veprimtaritë e njerëzve dhe të kafshëve në pranverë
Fjalë kyçe	pyll, lajmëtar i pranverës, sythim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Vizitohet parku ose pylli në afërsi të shkollës. Ndiqen ndryshimet tek bimët që janë vrojtuar më parë. Ç'gjë është e re? Shihen sythet në degë. Përfytyrohet se çfarë do të zhvillohet prej tyre (gjethet, lulet).
2. Vrojtohen kafshët. Cilat prej tyre nuk kanë qenë gjatë dimrit? Pse nuk kanë qenë? Ku e kanë kaluar dimrin? Shumë kafshë pjellin të vegjlit e tyre. Supozohet se pse i pjellin tani në pranverë dhe jo në vjeshtë ose në dimër.
3. Përgatitet druri i pranverës. Përreth trungut vihen figurat e kafshëve që janë vënë re gjatë vizitës në park ose në pyll.
4. Vizitohet livadhi ose lëndina me bar pranë shkollës. Vihen re dhe emërtohen bimët. Krahasohen ato për nga pamja, ngjyra dhe aroma. Këputen lulet, presohen dhe përgatitet herbariumi.
5. Plotësohet tabela e kushteve të motit.
6. Bisedohet sesi ndikojnë koha e ngrohtë dhe ditët më të gjata në veprimtaritë e nxënësve. Si kalohet koha e lirë? Ku kalohet? Ç'lojëra mund të luhen në pranverë? Si ndjehemi në pranverë?
7. Vrojtohet sjellja e njerëzve dhe e kafshëve në kushtet e ndryshme të motit. Bisedohet për sjelljen individuale në një mot të tillë. Për çfarë paralajmëron qielli i vrenjtur? Ç'veshje veshim atëherë? Duhet të mbrohem edhe nga dielli i pranverës; shpjegohet se lëkura "mban mend" skuqjet.
8. Vihen re punët e njerëzve në kopsht, në arë, në pemishtë, në park. Në ç'kushte moti kryhen këto veprimtari? Pse? Si mund të marrin pjesë nxënësit në këto punë?
9. Lexohen tregimet ose shihen filmat për zgjimin e kafshëve nga gjumi i dimrit dhe për kujdesin e tyre ndaj të vegjëlve.
10. Lexohen kuriozitetet për kafshët.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen figurat ilustruese të natyrës në pranverë. Emërtohen banorët e saj. Cilat kafshë nuk kanë qenë në figurën ilustruese të natyrës në dimër? Vihen re ndryshimet tek bimët në raport me stinën e mëparshme. Ç'gjë është e re në figurë në raport figurën ilustruese të natyrës në dimër? Si është qielli? Supozohet se pse pikërisht në pranverë, numri më i madh i kafshëve i sjell në jetë të vegjlit e vet (është më ngrohtë, ka më shumë ushqim).
2. Emërtohen bimët në figura. Pse quhen ato lajmëtarët e pranverës? Ç'do të thotë fjala lajmëtar?



Cilat prej këtyre luleve i kanë parë dhe ku i kanë parë? Në ç'gjë ngjasojnë ato? Në ç'gjë ndryshojnë? A njohin lule të tjera të tilla, që nuk janë paraqitur në figura?

3. Ç'pamje ka qyteti në pranverë? Çfarë ndryshon në raport me dimrin? Çfarë bëjnë të rriturit dhe çfarë fëmijët? Çfarë tjetër mund të bëjnë fëmijët?
4. Ç'pamje ka parku në pranverë? Cilat pemë kanë lulëzuar? A gjethojnë në të njëjtën kohë të gjitha bimët? Shihet se disa bimë më parë çelin lule dhe pastaj çelin gjethe.
Përshkruhet dhia dhe kecat. Me çfarë është i mbuluar trupi i dhisë? Me çfarë ushqehet dhia? Me çfarë ushqehen kecat?

Puna me Fletoren e punës

1. Janë dhënë fjalitë që tregojnë ndryshimet në natyrë. Qarkohen pohimet e sakta.
2. Vizatohet druri "vetjak" në pranverë.
3. Këputet lulja në livadh dhe presohet: Shkruhet emërtimi i lules dhe vendi ku është këputur.

**Mjetet
ndihmëse**

pëlhura, letër kolazhi, gërshërët, filmi për kafshët, enciklopeditë.

PREJ NGA VJEN USHQIMI?

Qëllimet

- të nxirret përfundimi se njerëzit e prodhojnë ushqimin
- të vihet re se njerëzit, gjatë prodhimit të ushqimit, përdorin veglat e punës

**Fjalë
kyçe**

pemëtore (pemishte), vresht, arë, vjel, krasit, ushqej, mbjell, lëroj, vegla e mjete pune: shat, lopatë, gërshërë, pompë dore.

Veprimtaritë e propozuara

1. Vrojtohet pemishta, vreshti dhe ara. Emërtohen bimët që rriten atje. Vihen re ndryshimet në pamjen e bimëve që rriten në parcelat e ndryshme. Si e kanë ato kërcellin, gjethen dhe frytin? Komentohen ndryshimet në pamjen e bimëve e të fryteve të të njëjtit lloj.
2. Vizatohet ajo që është parë gjatë vizitës në natyrë: në pemishtë, në vresht, në arë.
3. Përgatiten stendat e sipërfaqeve të tokave për qëllime të ndryshme: pemishtë, vresht, arë. Në secilën stendë vendosim frytat e bimëve që rriten aty.



4. Thuhen veprimtaritë që kryhen në pemishtë, në vresht, në arë. Komentohen ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre. Si përgatitet toka për mbjelljet dhe për mbjelljen e drufrutorëve? Çfarë mund të bëjnë nxënësit për këtë gjë?
5. Vihen re dhe emërtohen veglat e mjetet e punës që përdoren në pemishtë, në vresht dhe në arë. Cilat prej tyre përdoren edhe në pemishtë, edhe në vresht? Për ç'loj pune i përdorim ato? Lidhet veglat e mjetet e punës me foljet që tregojnë veprimet. Emërtohen makineritë e paraqitura në figura. Në cilat sipërfaqe të tokës përdoren më shpesh makineritë? Pse?
6. Imitohet me lëvizjen e trupit mbjellja me hedhje të farës, mbjellja e drurëve, krasitja, vjelja, spërkatja, prashitja ...
7. Bisedohet për produktet që përftohen prej frutave, prej perimeve dhe prej drithërave. Pse përpunohen frytet? Frytet piqen në një kohë të caktuar të vitit. Bisedohet se cilat fryte piqen në pranverë (qershia, luleshtrydhet, vishnja) dhe cilat më vonë në verë e në vjeshtë (pjeshka, dardha, pjepri e shalqiri, fiku, shega ...).
8. Bisedohet për frutin e preferuar. Cili frut u pëlqen më shumë? Sa shpesh i konsumoni frutat? A rritet ky frut në vendbanimin tuaj? Pse duhet të lahen frutat para se të konsumohen?
9. Modelohen prej plasteline frutat, drithërat dhe veglat e punës që përdoren gjatë vjeljes së fryteve të bimëve dhe gjatë punimit të tokës.
10. Bisedohet për mënyrën e përgatitjes së bukës. Prej çfarë bëhet buka? Prej cilave drithëra bëhet buka? Cili lloj buke u pëlqen më shumë? Shkruhet receta e gatimit të bukës.
11. Bëhen fruta, zrazavate e drithëra prej brumi. Brumi i modeluar thahet dhe ngjyroset me bojë tempera me ngjyrën e duhur.
12. Bisedohet për kushtet e motit dhe për ndikimin e tyre në rritjen e bimëve. Si ndikojnë katastrofat natyrore në rritjen e bimëve? Çfarë do të ndodhë me bimët pas përmbytjes? Çfarë do të ndodhë, nëse është thatësirë? Si mund t'u ndihmojmë bimëve? Bëhen supozimet për këtë gjë.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura ilustruese dhe komentohet ajo që është paraqitur në të. Përshkruhet pamja e arës. Çfarë është mbjellë në arë (misër dhe grurë)? Ç'vegla pune e makineri përdoren në arë? Përshkruhet pamja e tyre. Për çfarë përdoren veglat e mjetet e punës të paraqitura? Për cilat punë përdoren makineritë? Ç'ushqime përftojmë prej misrit e prej grurit?
2. Shihet figura ilustruese dhe komentohet. Çfarë kultivohet në vresht? Si quhet prodhimi i hardhisë? Ç'pamje ka vila e rrushit? Shihet figura ilustruese dhe komentohet. Kur piqet rrushi? Komentohen veprimtaritë e të rriturve dhe të fëmijëve. Cilat vegla e mjete pune përdoren në vresht? Kur përdoren gërshërët? Kur përdoret pompa për spërkatje. Përse spërkatet hardhia? Bisedohet për produktet prej rrushi: Cili prej tyre rekomandohet për fëmijë dhe përse? Pse duhet të tregojnë kujdes të rriturit për sasinë e verës që pijnë?
3. Shihet figura ilustruese e pemishtës. Emërtohen drufrutorët në figurë. Emërtohen frutat. Përshkruhet pamja e frutave; ngjyra, forma. Komentohen ngjashmëritë dhe ndryshimet. Në cilën kohë vilen qershitë? A piqen të gjitha frutat në të njëjtën kohë? Tregohen veprimtaritë e të rriturve dhe të



- fëmijëve. Bisedohet për veglat e punës që përdoren në pemishtë. Cilat prej tyre nuk përdoren në arë (sharra)? Pse? Ç'produkte përftojmë prej frutave?
4. Shihet figura ilustruese dhe komentohet sesi sillen frutat e perimet në qytet.

Puna me Fletoren e punës

1. Shihen vizatimet dhe lexohen fjalët. Lidhin bimën dhe produktin që bëhet prej saj.
2. Gjejnë fjalët FRUTAT dhe PERIMET dhe i shkruajnë ato.
3. Zgjidhin fjalëkryqin. Zgjidhja e fjalëkryqit është VEGLAT.
4. Bisedohet për cilësitë e mollës (frytit). Me çfarë e ndjejmë aromën, ngjyrën dhe shijen? Çfarë ndjejmë me gishtërinj; me prekje? Poshtë vizatimit shkruhet cilësia që është ndjerë me shqisat e veçanta. Pse i spërkatin njerëzit frutat? Çfarë ndodh, nëse fruti nuk spërkatet? Në cilat fruta do të shfaqet krimbi; në atë të spërkatur, apo në atë të paspërkatur? Nxënësit e kuptojnë se më i ëmbël është fruti i paspërkatur, edhe pse ai duket më pak tërheqës.

Mjetet ndihmëse

plastelina, brumi

MAJDANOZI DHE SPECI

Qëllimet

- të nxirret përfundimi se njerëzit e prodhojnë ushqimin
- të njihen pjesët e ndryshme të bimës
- të vihet re se prej farave të ndryshme rriten bimë të ndryshme

Fjalë kyçe

kopsht (bahçe), pjesë bime: rrënjë, kërcell, lule, fryt, farë, qepujkë, fidan, shumëzim, sythim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Vizitohet kopshti. Bisedohet me pronarin; pyetjet përgatiten paraprakisht në shkollë., p.sh.: Çfarë kultivohet në kopsht? Si përgatitet toka e kopshtit për mbjellje? Cilat vegla pune përdoren në kopsht? Kur plehërohet sipërfaqja e tokës? Pse plehërohet sipërfaqja e tokës? Sa herë vaditet kopshti? Si mbrohen bimët nga dëmtuesit? Çfarë bëhet me prodhimet e kopshtit? Si paketohen e ruhen prodhimet e kopshtit? Nëse shiten prodhimet e kopshtit, ku bëhet kjo gjë?
2. Sillen në klasë farat e bimëve të ndryshme. Krahasohen farat për nga forma. Ku dallohen ato? Hapet fara e fasulës dhe shihet se çfarë është brenda. Çfarë përmban fara? Përgatitet koleksioni i farave i klasës.



3. Prej farave të ndryshme përgatiten figurat e murit: fillimisht vizitohet me laps ajo që dëshirohet. Pastaj lyejnë me zam dhe ngjiten farën.
4. Me lugë kapen farat e bimëve të ndryshme (kungullit, misrit, grurit, lulediellit) dhe numërohet sa fara janë në lugë. Hartohet grafiku i numrit të farave në një lugë. Prej ç'farave ka më shumë dhe më pak në një lugë?
5. Mbillen farat e bimëve të ndryshme. Shihet se çfarë do të zhvillohet prej tyre dhe kur do të zhvillohet. A mbijnë njëherësh farat e së njëjtës bimë? Cila farë ka mbirë e para dhe cila e fundit? Shihet rritja e fasules. Në kërcellin e fasules shënohen me flomastër tri viza në largësi gjysëm centimetri. Pas një jave shihet largësia midis vizave. Sa janë larg tani vizat nga njëra-tjetra?
6. Qepujka e zymbylit vihet në një enë të tejdukshme, në të cilën vetëm fundi është i mbuluar me ujë. Vrojtohet se çfarë ndodh me bimën dhe shënohen ndryshimet: Kur ka mbirë bima? Kur ka çelur lule?
7. Këputet një gjethe nga vjollca afrikane dhe mbillet në tokë. Vrojtohet se çfarë ndodh dhe kjo gjë shkruhet në bllokun e shënimeve.
8. Në një kuti kartoni vihet patatja e mbirë. Mbyllet kutia dhe lihet hapur një vrimë, në mënyrë që drita të hyjë vetëm përmes saj. Pas disa ditësh hapet kutia dhe shihet se çfarë ka ndodhur? Në cilën anë ka mbirë më shumë patatja? Pse?
9. Lexohen tekstet për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit. Pse i spërkatin drufrutorët dhe perimet prodhuesit? Pse është e mirë dhe pse e keqe kjo gjë? Si mund të pakësohet përdorimi i mjeteve mbrojtëse (insekticideve)? A mund të futen edhe në trupin e njeriut këto helme dhe si mund të futen? Nxënësit thonë supozimet e veta.
10. Në dy-tri gota të tejdukshme hidhet ujë dhe në secilën shtohet boja tush e ngjyrave të ndryshme: Në gota vihet nga një karafil i bardhë. Shihet se çfarë do të ndodhë me lulen. Pse e ka ndryshuar ngjyrën lulja? Cila ngjyrë ka arritur tek lulja? Lidhet ky fakt me përdorimin e mjeteve për mbrojtjen e bimëve.

Puna me Tekstin mësimor

1. Në figurën ilustruese është paraqitur kopshti. Emërtohen bimët që njihen. Thuhen pjesët e bimëve që mund të konsumohen. Përshkruhet pamja e pjesëve të ngrënshme; ngjyra dhe forma. Komentohen ngjashmëritë dhe ndryshimet. Cilat perime mund të konsumohen të pagatuara (të gjalla) dhe cilat jo? Flitet për veprimtaritë e njerëzve në kopsht. Në ç'gjë u ndihmojnë fëmijët të rriturve? Cilat vegla e mjete pune përdoren për punimin e tokës? Thuhen produktet që përftohen nga perimet (zarzavatet). Prej kujt përftohet salca, havjari dhe sallatat e ndryshme? Çfarë u shtohet sallatave? Cili produkt prej rrushi u shtohet sallatave?
2. Emërtohen pjesët e bimës. Lexohet se prej çfarë është krijuar fryti. Ku gjendet fara? Çfarë do të krijohet prej saj?
3. Nxënësit merren vesh që në klasë të ndërtojnë kopshtin e vogël. Hartohet plani se çfarë do të mbillet. Çfarë nevojitet gjithsej për këtë punë?
4. Disa bimë rriten nga fara, disa nga qepujka, ndërsa disa nga pjesa e gjethes. Si duket qepujka e qepës, dhe si bima e rritur?



Puna me Fletoren e punës

1. Lidhen bimët me sipërfaqen e tokës ku rriten.
2. Plotësohet grafiku mbi bazën e të dhënave nga tabela. Ç'zarzavate (perime) ka më shumë dhe më pak?
3. Emërtohen dhe shkruhen pjesët e drurit dhe të lules.
4. Lidhen farat dhe bimët e rritura.

Mjetet ndihmëse

enët për mbjellje, dheu, farat e bimëve të ndryshme, qepujka, gjethja e vjollcës afrikane, lopata e vogël, grabuja e vogël, gotat, boja tush, karafilët e bardhë.

NË LIVADH

Qëllimet

- të vihet re se në mjedise të ndryshme jetojnë qenie të ndryshme
- të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike për mjedisin ku jetojnë
- të vihet re se disa kafshë/bimë janë të ngjashme, ndërsa disa të tjera ndryshojnë shumë
- të zhvillohet të kuptuarit për lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla

Fjalë kyçe

gjallesë livadhore, gjallesë që jeton në tokë, pjesë bime: rrënjë, kërcell, gjethe, lule; pjesë trupi e gjallesës: këmbë, krah ...

Veprimtaritë e propozuara

1. Vizitohet livadhi. Shihet dhe përshkruhet pamja e bimëve. Vrojtohen gjallesat. Vihet re se disa janë mbi lule, disa në tokë, kurse disa të tjera nën tokë. Ç'gjallesa njihen nga nxënësit? Shihet pamja e gjallesave. Në ç'gjë janë të ngjashme? Në ç'gjë ndryshojnë?
2. Këputen dy bimë të ndryshme (me gjithë lule). Krahasohet pamja e kërcellit, e gjethës dhe e lules së tyre. Krahasohen aromat. Bëhet supozimi se pse kanë aromë lulet.
3. Kërkohet lulequmështorja dhe nxirret me gjithë rrënjë, duke pasur kujdes që të mos këputet. E njëjta gjë bëhet edhe me barin. Krahasohet rrënja e lulequmështores dhe e barit. Rrënja e barit është xhufkore, ajo e thith ujin nga shtresat sipërfaqësore të tokës. Rrënja e lulequmështores është e gjatë, ajo e thith ujin nga shtresat e thella të tokës.



4. Shihen insektet në livadh: Krahasohen ato. Ç'formë, madhësi dhe ngjyrë ka trupi i tyre? Vrojtohen kafshët nën tokë. Nxënësit thonë mendimin e vet, se pse gjallesat kanë shpesh ngjyrën e mjedisit në të cilin jetojnë.
5. Gjenden insektet në livadh dhe vihen në vazo. Tregohet kujdes që të mos dëmtohen. Vrojtohet sjellja e gjallesave. Mësohet se me çfarë ushqehen. Dallojnë pjesët e trupit duke shfrytëzuar lupën. Theksohet se gjallesat duhet të kthehen në ambientin natyror.
6. Zgjidhet një bimë livadhore dhe vizatohet.
7. Zgjidhet një gjallesë livadhore dhe vizatohet.
8. Përgatitet stenda me gjallesat livadhore. Bisedohet për gjymtyrët me të cilat lëvizin. Insektet grupohen sipas mënyrës së lëvizjes: fluturon, kërcen, zvarritet, ecën.
9. Lexohen tekstet për bimët dhe gjallesat livadhore.

Puna me Tekstin mësimor

1. Në vizatimin ilustrues shihen bimët dhe gjallesat dhe emërtohen ato. Bisedohet për karakteristikat e bimëve dhe të gjallesave livadhore. Cilat bimë shihen në figurë? Cilat kafshë shihen? Ku tjetër mund të shihen ato? A ka drurë në livadh?
2. Shihen vizatimet dhe komentohet se kush me kë ushqehet. Thuhet edhe shembujt e tjerë që dihen. Mësohet varësia reciproke midis bimëve e kafshëve. Vihet re se cili është barngrënës dhe cili është mishngrënës.

Puna me Fletoren e punës

1. Vizatohet livadhi në pranverë.
2. Tregimi për lulequmështoren është dhënë në katër figura ilustruese. Figura e parë është e vendosur, kurse tri të tjerat ngjiten nga Shtojca numër 7, sipas rrjedhës kohore.
Tregohet tregimi për lulequmështoren.
3. Shkruhen emrat e banorëve të livadhit.
4. Bisedohet për lëvizjen e kafshëve (gjallesave). Ngjyrosen kafshët (gjallesat). Lidhin kafshët që ecin, që fluturojnë dhe që zvarriten.

Mjetet ndihmëse

enët për ruajtjen e kafshëve, lupa e dorës, enciklopeditë.



LIQENI

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të vihet re se në mjedise të ndryshme jetojnë qenie të ndryshme• të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike për mjedisin ku jetojmë• të vihet re se disa kafshë/bimë janë të ngjashme, ndërsa disa të tjera ndryshojnë shumë• të zhvillohet të kuptuarit për lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla
Fjalë kyçe	bimë e kafshë uji, bimë e kafshë tokësore, kallam, lëkua, pilivesë, fulterzë, çafkë, kërmill.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nëse ekziston mundësia, nxënësit vizitojnë moçalin ose liqenin. Vrojtohen bimët që rriten në ujë. Cilat prej tyre janë të njohura? Ç'gjë kanë të përbashkët ato? Vihet re se shumica e bimëve që jetojnë në ujë e kanë kërcellin e gjatë. Bëhet supozimi se pse është kështu. Përshkruhet pamja e gjetes dhe e lules. Gjethja e lëkoit noton në ujë, ndërsa kërcelli është nën ujë dhe me rrënjë është i mbërthyer në tokë. Cilat bimë rriten në tokë; në bregun pranë ujit. Ku ndryshojnë ato prej bimëve që rriten në ujë?
2. Vrojtohen kafshët që rriten në ujë. Emërtohen ato që janë të njohura. Përshkruhen ato. Si e kanë trupin? Si lëvizin? Cilat jetojnë në sipërfaqe të ujit dhe cilat në ujë? Bëhen supozimet se pse jetojnë këtu; disa kërkojnë në ujë ushqimin, disa shumëzohen në ujë, kurse disa jetojnë në të.
3. Me një kovë të vogël marrim ujë nga moçali ose nga liqeni. Vrojtohen kafshët që kanë zënë me ujin. Kafshët mund të kapen edhe me rretë dhe të vihen në kovën me ujë. Si lëvizin kafshët e ujit (me pendë, me këmbë, me brirth; tentakule, me bisht ...)? Krahasohen me lëvizjet e kafshëve që jetojnë në livadh (zvarriten, fluturojnë, kërcejnë, ecin): Kuptohet se mënyra e lëvizjes dhe forma e trupit varen nga mjedisi në të cilin jeton.
4. Krahasohen bimët që jetojnë në ujë me bimët që jetojnë në livadh. Ç'gjethe dhe kërcell kanë bimët e ujit dhe bimët e livadhit. Këputet bima që rritet pranë ujit dhe bima që rritet në livadh. Cila prej tyre do të vyshket më parë? (Bima që jeton në bregun e liqenit ose në moçal nuk mund të jetojë gjatë pa ujë.)
5. Lexohet në enciklopedi për krimbin e shiut dhe për kërmillin. Bëhet supozimi se pse quhet kështu krimbi i shiut. Pse mund të shihen më shumë ato në kohën me lagështi? Çfarë mjedisi u përshtatet më shumë atyre (i lagësht). Kërkohen nën gjethe krimbi i shiut dhe kërmilli. Ç'kafshë të tjera shihen në po të njëjtin vend? Preket me dorë toka ku ato jetojnë. Ç'aromë ka ajo?
6. Nxënësve u ndahen vizatimet me kafshë e bimë uji, në të cilët mungon një pjesë e bimës apo e kafshës. Gjehet se ç'pjesë mungon dhe e shtojnë duke e vizatuar.
7. Vizitohet mjedisi përreth pas shirave të mëdha ose pas përmytjeve. Vrojtohet livadhi pas përmytjes ose bregu i liqenit (moçalit). Çfarë vihet re?



8. Vizatohen bimët dhe kafshët dhe bimët që jetojnë në ujë ose në tokë (breg).
9. Lexohen tekstet për zogjtë që jetojnë pranë moçalit ose liqenit. Mësohet se cilët zogj janë të rrezikuar. Ç'kafshë të tjera janë të rrezikuara? Cili është shkaku i numrit të tyre gjithnjë e më të vogël?

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen figurat ilustruese dhe vihen re kafshët që jetojnë në ujë. Si i janë përshtatur jetës në të? Cilat kafshë jetojnë pranë ujit ose në sipërfaqen e tij? Edhe bimët rriten pranë ujit, pjesërisht të zhytura në ujë (kallami, xunkthi), poshtë ujit dhe disa kanë gjethet notuese në sipërfaqen e ujit (lëkoi).
2. Lexohen tekstet për kafshët që jetojnë në ujë dhe pranë tij. Disa kafshë jetojnë vazhdimisht në ujë, ndërsa disa janë në ujë gjatë kohës që kërkojnë ushqim. Tek disa kafshë zhvillimi është i lidhur me ujin (bretkosa, pilivesa).

Puna me Fletoren e punës

1. Shtojnë me vizatim atë që i mungon pilivesës. Shkruajnë shkronjën që duhet, plotësojnë fjalinë dhe zbulojnë se çfarë i pëlqen pilivesës; natyra e pandotur.
2. Janë paraqitur jo të plota kafshët (kërmilli, bretkosa, çafka). Nga Shtojca numër 8 ngjiten pjesët e trupit që mungojnë. Shkruhet emri i kafshës, ndërsa duke e lexuar fjalinë, pse ajo kafshë jeton në ujë ose pranë ujit.

Mjetet ndihmëse

kovat plastike të vogla e të tejdukshme, rrjeta për gjuetinë e kafshëve, çizmet prej gome, enciklopeditë.



TË NGJASHËM, POR TË NDRYSHËM

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të nxirret përfundimi se njerëzit dhe kafshët kanë trashëgimtarët (zakonisht dy prindër)• të kuptohet se trashëgimtarët ngjajnë me prindërit dhe me njëri-tjetrin, por jo plotësisht• të mësohet se qeniet e gjalla lindin, rriten, plaken dhe vdesin
Fjalë kyçe	trashëgimtar, kushëri (i afërm), paraardhës, binjak, kope, tufë, grigjë, roj, lukuni, veteriner.

Veprimtaritë e propozuara

1. Bisedohet për ngjashmërinë e nxënësve me prindërit e vet. Ç'ngjyrë kanë sytë dhe flokët e nxënësve? Kush ka ngjyrë të tillë në familje? Komentohen edhe ngjashmëritë dhe ndryshimet e tjera.
2. Shkruhen karakteristikat dhe ngjiten në stendë. Nxënësit dallojnë karakteristikat si këto dhe shkruajnë emrin e vet poshtë fletushkës në fjalë. Kështu vihet re, se krahas ngjashmërive me prindërit, ekzistojnë edhe ndryshimet reciproke.
3. Hartohet grafiku i ngjashmërive të përmendura.
4. Bisedohet për jetën në grupe të kafshëve. Pse jetojnë në grupe? Pse shtegtojnë në tufa zogjtë? Pse në skaj të tufës fluturuese janë zogjtë më të vjetër, kurse në mes zogjtë më të rinj?
5. Bisedohet për kanakarët shtëpiakë dhe për kafshët shtëpiake. Si kujdesen nxënësit për kanakarët shtëpiakë? Me çfarë i ushqejnë? Si kujdesen për shëndetin e tyre? Kush i mjekon? A i vaksinonjë rregullisht? Pse është i nevojshëm vaksinimi i rregullt?
6. Modelohen në grupe familje kafshësh shtëpiake prej plasteline.
7. Vizitohet një fermë fshati. Shihen kafshët dhe të vegjëlit e tyre. Emërtohen pjesëtarët e familjes së kafshëve: lopa, demi, viçi; pela, kali, mezi ... Bisedohet për ngjashmëritë dhe për ndryshimet midis kafshëve të të njëjtit lloj dhe midis kafshëve të llojeve të ndryshme. Bisedohet me pronarin e fermës për mbarështimin e kafshëve. Ku i ka strehuar, si e mirëmban higjienën e stallës dhe përse i mbarështon ato ...?
8. Flitet për gjërat e këndshme e të pakëndshme që u ndodhin binjakëve. Nëse ka binjakë në klasë, thonë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre. Si i dallojnë? Çfarë kanë të ngjashme? Komentohen ndryshimet midis binjakëve që kanë njohur nxënësit. A kanë në familjen e tyre apo në fqinjësi binjakë të rritur? Në ç'gjë ngjasojnë dhe në ç'gjë ndryshojnë? Kuptohet se disa ngjashmëri dhe ndryshime janë të dukshme, kurse disa jo. Binjakët mund të kenë interesime, dëshira dhe prirje të ndryshme.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet fotografia e familjes. Kush janë prindërit dhe kush janë pasardhësit? Vihen re ngjashmëritë midis prindërve dhe pasardhësve. Në ç'gjë



ndryshojnë? Komentohet pamja e jashtme e binjakëve. Në ç'gjë ngjasojnë dhe në ç'gjë ndryshojnë?

2. Bisedohet për fazat e zhvillimit të fluturës e të bretkosës. Vihet re, se në fillim të jetës së tyre ato nuk ngjasojnë aspak me prindërit e vet.
3. Shohin figurat e grupeve të kafshëve: grigja e deleve, roi i bletëve, lukunia e ujqve, tufa e peshqve. Vihet re, se për disa grupe emërtimet janë të ndryshme, kurse për disa janë të njëjta. Supozohet se, përse grupohen kafshët në lukuni, në grigja, në kope, në tufa Lidhet kjo gjë me njeriun. Si grupohen njerëzit? Pse s'mund të jetojë i vetëm njeriu?
4. Bisedohet për stripin. Çfarë është paraqitur në çdo figurë? Çfarë ka ndodhur me qenin? Bisedohet për përvojën vetjake, nëse ata e kanë patur ose e kanë kanakarin shtëpiak. A e kanë çuar ndonjëherë tek veterinari dhe pse? Pse ngordhin kafshët? Po njerëzit, pse vdesin?

Puna me Fletoren e punës

1. Pranë çdo individi të rritur, shkruhet emërtimi i të voglit.
2. Lidhen me vijë kafshët me emërtimin përkatës të grupit.
3. Nënvizohet ai që s'i përket grupit. Kali është kafshë shtëpiake, të tjerat janë kafshë të egra; papagalli është kanakar shtëpiak, të tjerat janë kafshë shtëpiake; dhelpira është individ i rritur, të tjerët janë të vegjlit.

Mjetet ndihmëse

plastelina



MJEDISI IM

Kapitulli i fundit me emërtimin “*Mjedisi im*” përbëhet nga katër tema mësimi të përafërta: *Nga shtëpia deri në shkollë, Mjedisi ndryshon, Çfarë tregojnë tabelat, Vera.*


Duke u bazuar në njohuritë për ndryshimet në mjedisin natyror dhe shoqëror, të cilat fëmijët i kanë fituar deri tani, në kuadrin e këtij kapitulli zhvillojmë qëllimet më poshtë: të shqyrtojnë nxënësit edhe më tej ndryshimet në natyrë dhe veprimtaritë e njerëzve; të mësojnë për ndikimin e njeriut ndaj natyrës; të njohin e të dallojnë objektet shoqërore e gjeografike në mjedisin përreth e më gjerë; t’i zgjerojnë dhe t’i zbatojnë njohuritë për mënyrat e ndryshme të shënimit të informacioneve.

Në pamjen e vendbanimeve ndikon para së gjithash mjedisi natyror. Dallojmë vendbanimet malore dhe ato fushore. Fshatrat dhe qytetet dallohen për nga madhësia, për nga mënyra e strukturimit, për nga mënyra e organizimit të jetës së banorëve dhe për nga veprimtaritë tipike. Organizohen veprimtaritë e ndryshme dhe bisedohet me nxënësit për dallimet midis qytetit dhe fshatit, në aspektin e madhësisë, numrit të banorëve, numrit të shkollave, profesionit të njerëzve ...

Njeriu e ndryshon mjedisin dhe ia përshtat atë kërkesave të veta. Bisedohet për atë, sesi duket vendbanimi ku jetojnë nxënësit. Çfarë është ndërtuar në kohën e fundit në vendbanimin tuaj? Ndërtimi i urave, rrugëve, ndërtesave, fabrikave, pyllëzimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe veprimtaritë e tjera të njeriut, ndihmojnë në zhvillimin e cilësisë së jetës. Mirëpo, largimi i mbeturinave në mënyrë të papërshtatshme, prerja e pa planifikuar e pyjeve, derdhja e ujërave të zeza në lumenj, në liqene, në det dhe dukuritë e tjera të ngjashme, ndikojnë në ndotjen e mjedisit natyror. Bisedohet për atë, sesi mund të ndihmojnë nxënësit në ruajtjen e mjedisit ku ata jetojnë.

Nxënësit tashmë i dallojnë disa objekte natyrore e shoqërore në mjedisin përreth. Shëtitet në mjedisin përreth, me qëllim që të njihen format karakteristike të relievit dhe ujërat. Duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin e fëmijëve, u ndihmohet atyre që të orientohen në lidhje me ndonjë objekt natyror apo shoqëror, të cilin ata e kanë të afërt dhe të njohur mirë. Përmes veprimtarive të ndryshme zbavitëse apo interesante, nxënësit do të njohin dhe do të të përdorin nocionet orientuese dhe do t’i zbatojnë ato në rrethanat konkrete. Nxënësit orientohen në hapësirë me ndihmën e pikave të ndryshme të orientimit: fillimi dhe fundi i rrugës, objektet karakteristike në afërsi të shkollës, institucionet e rëndësishme, numrat çift ose tek të ndërtesave etj. Bisedohet për rëndësinë e hartave, p.sh. paraqitet saktësisht rruga deri në shkollë në formën e një harte.

Me nxënësit bisedohet për dukuritë në botën e jashtme dhe për paraqitjen e këtyre dukurive me një varg simbolesh të ndryshme. Rëndësi ka që tek nxënësit të zhvillohet vazhdimisht vetëdija për mënyrat e ndryshme të paraqitjes së dukurive. Aftësia për komunikimin grafik është shumë e rëndësishme në shkencat natyrore dhe në teknikë. Vizatimi në shkencat natyrore ka të bëjë me vizatimin e objekteve, të dukurive, të



grafikëve, të tabelave. Për vizatimin e disa dukurive, përdoren zakonisht simbolet, të cilat nxënësit i dallojnë me lehtësi; shiun e paraqesin në formën e vijave të ndërprera, ndërsa diellin, kryesisht, në formën e vijave nga një qendër e imagjinuar në drejtim jashtë (Moti). Nëse bëjmë tabelën apo grafikun, për përshkrimin përmbajtës së tyre duhen numrat. Në shkencat natyrore dhe në teknikë përdoren shpesh shigjetat, p.sh. për paraqitjen e drejtimit të lëvizjes apo për paraqitjen e disa veprimtarive (Moti; Shpejt, më shpejt).

Flitet përsëri për ndryshimet në natyrë dhe në mjedisin përreth gjatë vitit (vera). Rikujtohen veprimtaritë që kemi patur në periudhën paraardhëse. Si përgatiten për pushime? Çfarë planifikojnë? Ku do t'i kalojnë pushimet? Mund t'i kalojmë ato në det, në bjeshkë, në fshat, në qytet. Prej kësaj varet, sesi do t'i planifikojmë disa veprimtari të veta. Çfarë do të bëjmë në det apo në bjeshkë? Bisedohet se me kë do ta kalojmë kohën, për çfarë duhet të kemi kujdes.



NGA SHTËPIA DERI NË SHKOLLË

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të njihen objektet karakteristike shoqërore e gjeografike në mjedisin e gjerë përreth shkollës• të dallohen sipërfaqet e tokës në mjedisin përreth shkollës• të dihet të përshkruhet përdorimi i tokës në mjedisin përreth shkollës• të dallohen format bazë të relievit në afërsi të shkollës• të orientohemi në mjedisin përreth shkollës me ndihmën e objekteve të njohura të natyrës ose të mjedisit shoqëror
Fjalë kyçe	mjedis, orientim, majtas, djathtas, para, pas, përpara, prapa (mbrapa), hartë, skicë, simbol, emërtim i objekteve shoqërore e gjeografike.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Në ndërtesën e shkollës kërkojnë dritaret e klasës së vet. Ku ndodhen dritaret në raport me hyrjen e shkollës? Në klasë vizatohet skica e shkollës në një copë letre. Së bashku me nxënësit shënohet hyrja dhe muri ku janë dritaret e klasës së tyre. Përsëritin atë që kanë parë në drejtimet e caktuara. Plotësohet skica.
2. Vizitohet mjedisi përreth. Vihen re objektet që janë ndërtuar nga njeriu. Emërtohen. Çfarë nuk ka bërë njeriu? Emërtohen objektet e mjedisit natyror afër e larg shkollës.
3. Kërkohet një objekt i njohur pranë shkollës (përmendore, qendër tregtare, teatër, postë ...). Përcaktohet pozicioni i shkollës në raport me këtë objekt (majtas, djathtas, para, prapa). Ku ndodhet shtëpia (banesa) e tyre, në raport me këtë objekt?
4. Vizatohen skicat dhe në to pasqyrohet gjithçka që është vënë re gjatë vizitës së mjedisit (kodrat, fusha, lumi ...).
5. Interpretohet loja "Objekti i fshehur". Nxënësit lëvizin nëpër klasë ose në oborrin e shkollës dhe me ndihmën e skicës së thjeshtë kërkojnë sendin e fshehur. Loja mund të interpretohet edhe në natyrë.
6. Bisedohet për objektet që ndodhen në rrugën nga shtëpia deri në shkollë. Përshkruhet pamja e jashtme e shtëpisë (përdhese, njëkatëshe, shumëkatëshe)? Ç'formë kanë çatitë? Përshkruhet forma e shtëpisë (katrore, kubike). Si janë parmakët (kangjellat) ose muret rrethuese (prej guri, prej druri, prej metali) dhe ç'ngjyrë kanë?
7. Bisedohet për dyqanet e vetëshërbimit, për punishtet e zejtarëve, për dyqanet e luleve, për qendrat tregtare. Përshkruhet funksioni i tyre. Në cilat objekte tregtojnë më shpesh anëtarët e familjes së tyre? Në cilat tregtojnë ata vetë? Pse nuk tregtojnë në objektet e tjera? Nëse e kalojnë rrugën, ku është më i sigurt ky kalim? Pse pikërisht aty?
8. Vizatohen objektet shoqërore e natyrore në rrugën nga shtëpia deri në shkollë.



Puna me Tekstin mësimor

1. Emërtohen objektet shoqërore e natyrore në figurën ilustruese. Cilat prej këtyre objekteve i kanë në mjedisin e vet?
2. Në fotografi njihen objektet e ndryshme shoqërore dhe emërtohen ato. Cili është funksioni i tyre? Bisedohet për objektet që shohin nxënësit në rrugën nga shtëpia deri në shkollë dhe që u ndihmojnë atyre që të orientohen. Gjejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis objekteve të dhëna dhe atyre nga mjedisi i tyre.

Puna me Fletoren e punës

1. Shkruhet se çfarë ka krijuar natyra dhe çfarë kanë krijuar njerëzit në mjedisin e tyre.
2. Vizatohen objektet shoqërore e natyrore që ndeshen në rrugën nga shtëpia deri në shkollë.
3. Lexohet teksti dhe caktohet se ku jetojnë. Ngjiten në vendin e duhur vizatimet nga Shtojca numër 9.

Mjetet ndihmëse

pllakati me skicën e thjeshtë të shkollës.

MJEDISI NDRYSHON

Qëllimet

- të vihet re në shembujt konkretë sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën
- të përshkruhen ndryshimet në natyrë që shkaktohen nga njeriu
- të propozohet sesi mund të ndikohet në ruajtjen dhe në rregullimin e mjedisit natyror përreth
- të vihet re rrjedha kohore e ndodhive (ngjarjeve)

Fjalë kyçe

mjedis, mjedis jetësor, gurore, depo, vendbanim.

Veprimtaritë e propozuara

1. Nxënësit nxirren që të vizitojnë mjedisin përreth, ne qëllim që të vërejnë ndikimin e njeriut mbi natyrën. Kërkohet kantieri i ndërtimit. Bisedohet për atë që ka qenë në atë vend, para se të fillonin punimet. Bëhen supozimet. Kërkohe përgjigjet nga ata që i kryejnë punimet.
2. Nxënësit mbledhin fotografi, kartolina dhe pamje të vendbanimit tani dhe dikur. Prej materialit të grumbulluar përgatitet stenda e klasës. Materiali klasifikohet sipas kriterit tani dhe dikur.
3. Bisedohet për ndryshimet që kanë ndodhur në mjedisin përreth. Çfarë ka ndryshuar që nga koha kur ata kanë shkuar në shkollë (është ndërtuar ura, ndërtesa e banimit, trotuari, rruga ...)? Shënohen ndryshimet.



4. Nëse ekziston mundësia, shihet shtëpia për të cilën nuk kujdeset askush. Përshkruhet pamja e saj. Çfarë duhet restauruar në të? Bisedohet me fëmijët për nevojën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.
5. Shihen sipërfaqet e ndryshme të tokës në mjedisin përreth shkollës. Shihet ndërtesa e banimit me oborr. Ku është kufiri i pronës private (i pronës së pronarit dhe i oborrit)? Kuptohet nocioni pronë private. Kush kujdeset për oborrin e ndërtesës së banimit? Shihen edhe sipërfaqet e tjera përreth. Emërtohen dhe supozohet se kush kujdeset për to. Për cilën sipërfaqe kujdesen shërbimet e veçanta dhe për cilat ata vetë? Si mund të ndihmojnë nxënësit në ruajtjen e mjedisit? Bisedohet me nxënësit për atë që u pëlqen dhe për atë që do të ndryshonin.
6. Bisedohet për kafshët e mjedisit përreth. Ku jetojnë zogjtë dhe ku është shtëpia e tyre? Ku jetojnë milingonat dhe merimangat? Çfarë do të ndodhë, nëse e presim drurin në të cilin jetojnë? Çfarë do të ndodhë, nëse në atë tokë ndërtohet rruga ose ndërtesa e banimit? Nxënësit bëjnë supozimet për jetën e mëtejshme të këtyre kafshëve.
7. Bëhen propozimet për ruajtjen e mjedisit të jetesës. Si mund të ndihmojnë nxënësit në ruajtjen e mjedisit? Si do ta rregullonin ata oborrin e shkollës? Vizatohen propozimet e nxënësve.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihen fotografitë. Nxënësit përshkruajnë, krahasojnë dhe parashikojnë. Vihet re se fotografitë janë të periudhave të ndryshme kohore. Në ç'gjë ndryshojnë qytetet e paraqitura në fotografi? Si janë ndërtesat (shtëpitë)? Nga se ndryshojnë?
2. Vihet re se në ç'gjë ndryshojnë vizatimet e dhëna?
3. Vihet re sesi mund të ndikojë njeriu mbi mjedisin. Bisedohet për njohuritë që kanë nxënësit lidhur me ndryshimin e mjedisit ku jetojnë dhe bëhen propozimet për mbrojtjen e tij. Komentohet fakti se disa ndryshime kanë pasoja të mira, ndërsa disa të tjera janë me pasoja të këqija.

Puna me Fletoren e punës

1. Nxënësit shkruajnë në tabelë se çfarë ekziston në vendbanimin e tyre.
2. Shkruhen disa nga gjërat që janë interesante lidhur me vendbanimin. Si emërtohet dyqani në të cilin blihet më shpesh buka?
3. Vrojtohet sheshi i ndërtimit në afërsi të shkollës. Shihet disa herë gjatë kohës së ndërtimit dhe vihen re ndryshimet, të cilat pastaj shënohen në tabelë.

Mjetet ndihmëse

fotografitë, kartolinat, pamjet nga vendbanimi.



ÇFARË TREGOJNË TABELAT?

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">të zhvillohet aftësia për sistemimin e të dhënavetë zhvillohet aftësia për komunikimin grafik në shkencat natyrore e teknike
Fjalë kyçe	tabelë, grafik, rrjetë

Veprimtaritë e propozuara

- Në Tekstin mësimor dhe në Fletoren e punës kërkohen tabelat dhe grafikët. Çfarë është paraqitur në to? Ç'kuptim kanë? Si lexohen ato?
- Bihet dakord për të shkuar në piknik. Bëhen propozimet për vendin ku do të shkohet? Përgatitet tabela e "dëshirave" dhe shkruhen të dhënat. Tabela do të ketë dy kolona, ndërsa rreshta aq sa ka edhe propozime për piknikun. Mbi bazën e tabelës hartohet grafiku.
- Plotësohen tabelat mbi bazën e figurave ilustruese.
- Vizatohet grafiku. Mbi bazën e grafikut plotësohen tabelat.
- Në rrjetën me katrore shkruhet sa dhe çfarë lapsash grafiti, flomastera dhe lapsash me ngjyra kanë nxënësit në mjetet e veta të punës. Rrjeta katrore është edhe një mënyrë për paraqitjen e të dhënave.

Puna me Tekstin mësimor

- Shihet tabela dhe komentohet. Çfarë është paraqitur në kolonën e parë dhe çfarë në kolonën e dytë? Sa nxënës do të shkojnë për pushime në bjeshkë dhe sa do të shkojnë në det? Sa nxënës do të mbeten në shtëpi? Çfarë është paraqitur me numrin 7? Lexohen dhe komentohen grafikët. Çfarë është paraqitur vertikalisht dhe çfarë është paraqitur horizontalisht? Cila kolonë në grafik është më e larta dhe cila kolonë është më e ulëta? Çfarë tregon kjo gjë?
- Shihet kalendari dhe vihet re sesa kohë i duhet dosës që t'i pjellë gicat (tre muaj, tri javë, tri ditë).

Puna me Fletoren e punës

- Shihet figura ilustruese, në të cilën është paraqitur se çfarë paketon Ana për të shkuar në det. Lidhet me vizë sendi me ngjyrën. Numërohen sendet dhe ngjyrat me ngjyrën përkatëse të kolonës në rrjetën katrore. Ç'sende ka më shumë dhe ç'sende ka më pak? Çfarë është në numër të njëjtë?
- Lexohen të dhënat në tabelë. Ngjyroset në grafik numri i duhur i katrorëve.

Mjetet ndihmëse	fletët mësimore me tabela, me grafikë e me rrjeta katrore, figurat ilustruese.
------------------------	--



VERA

Qëllimet	<ul style="list-style-type: none">• të përshkruhen ndryshimet në natyrë që ndodhin në verë• të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike në mjedisin ku jetojnë• të zgjerohen njohuritë dhe shkathtësitë që mundësojnë kujdesin për shëndetin vetjak• të dallohen bimët e ngrënshme e të pangrënshme
Fjalë kyçe	fryt pylli, luleshtrydhe, boronicë, manaferrë, ferrëkaçe, kërpudhë, alpinist, zjarr, kujdesi për shëndetin.

Veprimtaritë e propozuara

1. Vizitohet parku ose pylli në afërsi të shkollës. Vihen re ndryshimet tek bimët që kanë vrotuar në stinën e kaluar të vitit. Çfarë ka ndryshuar dhe çfarë ka mbetur e njëjtë?
2. Vizitohet livadhi. Vihen re ndryshimet në raport me pranverën. Emërtohen insektet. Rikujtohen disa insekte që i kanë parë në pranverë.
3. Modelohet hardhuca ose flutura prej teli ose prej plasteline.
4. Lexohen tekstet për jetën e bletëve. Lexohen tekstet mbi rëndësinë e mjaltit për shëndetin.
5. Plotësohet grafiku për kushtet e motit. Bisedohet për rreziqet nga thatësira dhe nga temperaturat e larta. Komentohen të gjitha mënyrat e ndryshme për rënien e zjarrit. Parashikohen rreziqet nga zjarri që mund të kërcënojnë banorët e qytetit dhe pyjet. Cila shenjë paralajmëron për rrezikun nga zjarri?
6. Vizitohet tregu i fruta perimeve dhe bisedohet për atë që ofrohet në tezgja. Vihen re ndryshimet në pamjen midis llojeve të njëjta të frutave e të perimeve. Bisedohet me prodhuesit apo me shitësit për vendin ku janë prodhuar produktet. Nga cila zonë janë ata? Si i transportojnë produktet deri në treg? Nxirret përfundimi se qyteti dhe fshati janë të lidhur me njëri-tjetrin.
7. Bisedohet për frytet e pyllit. Ç'fryte pylli njihen nga nxënësit? Si përdoren për ushqim? Thuhet se çfarë mund të përgatitet prej luleshtrydheve të pyllit, prej boronicave, prej manaferrave dhe prej ferrëkaçes së trëndafilut të egër (pekmez, reçel, komposto, çaj).
8. Modelohen fryte pylli prej plasteline.
9. Bisedohet për kërpudhat. Ç'pamje ka kërpudha? Cili është kuptimi i shprehjes: "Rriten si kërpudhat pas shiut"? Ç'përfundim nxirret? Si përdoren për ushqim kërpudhat? Si u pëlqen nxënësve që t'i hanë? Pse nuk duhet t'i mbledhin vetë nxënësit kërpudhat?
10. Përfytyrohet dhe vizitohet shenja (simboli) për kërpudhën helmuese.
11. Bisedohet me të ftuarin alpinist. Bëhet parapërgatitja për intervistë. Pse merret personi me alpinizëm? Sa kohë ka që merret me këtë sport? Cila është gjëja më e rëndësishme tek alpinizmi? Si ndikojnë kushtet e motit mbi alpinizmin? Ç'pajisje janë të nevojshme? Çfarë pëlqehet më shumë tek alpinizmi?



12. Bisedohet me nxënësit se ku do t'i kalojnë pushimet verore dhe si do t'i kalojnë ato. A kanë qenë më parë në këtë vend? Çfarë u ka mbetur në kujtesë për këtë vend? Çfarë u ka pëlqyer dhe çfarë nuk u ka pëlqyer? Ku do t'u pëlqente të shkonin?
13. Vizatohet vendi, ku do t'u pëlqente nxënësve ta kalonin pushimin.
14. Bisedohet për lëndimet ose për infeksionet që u kanë ndodhur gjatë pushimit të mëparshëm. Ku ka ndodhur kjo gjë? Nga se janë sëmurë? Si janë mjekuar? Ç'lëndime kanë pasur? Si janë lënduar? Kush u ka ndihmuar? Si u ka ndihmuar? Çfarë bëhet, nëse pritemi?
15. Bisedohet për qëndrimin e tepruar në diell. Si mund të mbrohemi nga rrezatimi i dëmshëm i Diellit? Pse duhet të pihen mjaft lëngje? Bëhet lidhja me temën e mësimin "Trupi im".
16. Shkruhet ajo për të cilën nxënësit mendojnë se është e rrezikshme për ta dhe si do të duhej të silleshin për ta shmangur atë rrezik.

Puna me Tekstin mësimor

1. Shihet figura ilustruese. Cila stinë e vitit i paraprin verës? Komentohet pamja e pyllit. Emërtohen bimët dhe kafshët që njihen.
2. Emërtohen frytet (bimët) në figurën ilustruese. Pse quhen ato fryte pylli? Cilat prej tyre i kanë parë në mjedisin përreth? Ku i kanë parë? Ç'gjë kanë të përbashkët? Në ç'gjë ndryshojnë? Pse nuk duhet të mblidhen bimët që rriten pranë rrugës? Pse duhet të tregohemi të kujdesshëm me kërpudhat?
3. Përshkruhet pamja e qytetit gjatë verës. Bisedohet për atë që nxënësit bëjnë gjatë verës dhe që nuk e kanë bërë më parë. Lexohet teksti pranë vizatimeve që pasqyrojnë datën kur fillon vera. Shihet fotografia e zjarrit në pyll. Komentohet mënyra sesi ka rënë zjarri.

Puna me Fletoren e punës

1. Mbi bazën e vizatimeve plotësohet fjalëkryqi, zgjidhja e të cilit është MANAFERRA.
2. Shkruajnë emërtimet e fryteve të pyllit të paraqitura në figura. Vizatohen edhe frytet e tjera të pyllit dhe emërtohen.
3. Me bojëra tempera bëjnë vizatime mbi rrasë.
4. Zbukurohet kapaku i kavanozit me guaska deti e guaska kërmilli ose me guralecë të ngjyrave të ndryshme.

Mjetet ndihmëse

plastelina, teli, guri, bojërat tempera, guaska deti e kërmilli.

PROPOZIM PËR PLANIN VJETOR

JAVA	KAPITULLI I TEKSTIT MËSIMOR	TEMA MËSIMORE NË TEKSTIN MËSIMOR	NUMRI I ORËVE	QËLLIMET OPERATIVE
1.	Rritemi	Përsëri në shkollë	2	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se çdo vit jemi më të rritur të zgjerohen njohuritë për dallimet midis vetes e të tjerëve (moshatarëve e të rriturve) të vihen re ndryshimet tek vetja dhe tek njerëzit në mjedisin përreth të zhvillohet mirëkuptimi për dallimet midis njerëzve
1. 2.	Rritemi	Kur të rritem, do të bëhem ...	3	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se njerëzit që jetojnë ose që punojnë bashkë, vendosin raporte të caktuara reciproke (respekt, dashuri, miqësi, bashkëpunim, kujdes, situata të ndryshme konfliktuale etj.) të zhvillohet mirëkuptimi për dallimet midis njerëzve të vihet re se edhe fëmijët, sikurse edhe të rriturit, gëzojnë lirinë e zgjedhjes, pavarësisht nga gjinia të mësohet se lojërat, shokët dhe shoqet mund të zgjidhen lirisht
2. 3.	Rritemi	Familja ime	2	<ul style="list-style-type: none"> të zhvillohet qëndrimi pozitiv ndaj punës së të gjithë pjesëtarëve të familjes të kuptohet vlera e punës të të gjithë pjesëtarëve të familjes
3.	Rritemi	Në moshë gjithnjë e më të madhe	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen periudhat e ndryshme të jetës së njeriut të mësohet se qeniet e gjalla lindin, rriten, plaken dhe vdesin të vihet re se çdo vit bëhemi më të rritur
4.	Rritemi	Si ka jetuar gjyshja e nënës?	3	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se jeta e njerëzve në të kaluarën ka qenë ndryshe të vlerësohen sendet e së kaluarës të njihen nxënësit me aspektet e ndryshme të jetës së njerëzve në të kaluarën dhe sot
5.	Rritemi	Shokë e miq	2	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se njerëzit që jetojnë ose që punojnë së bashku vendosin marrëdhënie të caktuara reciproke të zhvillohet mirëkuptimi për ndryshimet midis njerëzve të vihen re ndryshimet midis marrëdhënieve të dashurisë, të respektit, të kujdesit, të miqësisë e të bashkëpunimit

5. 6.	Shkolla jonë	Në shkollë	3	<ul style="list-style-type: none"> të dijnë nxënësit se shkolla ka gazetën e vet, ekipin sportiv ... të zhvillohet ndjesia për përkatësinë "shkollës së vet"
6.	Shkolla jonë	Rregullojmë klasën	1	<ul style="list-style-type: none"> të modelohen trupa prej materialeve të ndryshme të përdoren materiale, vegla e procese të ndryshme punimi: kartoni, letra (modelohet, pritet, ngjitet) të lidhen materiale e procese të ndryshme punimi të përgatiten nxënësit për punë dhe për sistemimin pas punës të vihet re se gjatë punës shkaktohen mbetjet që duhet të mënjanohen
7.	Shkolla jonë	Këndi i gjallë	2	<ul style="list-style-type: none"> të emërtohen karakteristikat e qenieve të gjalla që jetojnë në mjedisin përreth nxënësve të thuhet se çfarë u duhet qenieve të gjalla për të jetuar të kuptohet se qenieve të gjalla u nevojitet ushqimi dhe strehimi të bëhet lidhja midis materialeve të ndryshme e proceseve të punimit
7. 8.	Shkolla jonë	Në këndin e lojërave	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihet gjendja e baraspeshës të vihet re se trupat në lëvizje mund të ndalen
7. 8.	Retë dhe era	Moti	2	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruhen dukuritë që përsëriten në natyrë të njohin dukuritë e motit: re, shi, erë të vënë re se ndryshimet në mjedisin përreth janë nganjëherë të këndshme dhe nganjëherë të dëmshme për kafshët e bimët
9.	Retë dhe era	Ka ardhur vjeshta	3	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruhen ndryshimet e natyrës që ndodhin në vjeshtë të vihen re veprimtaritë e njerëzve, të bimëve e të kafshëve në vjeshtë të zhvillohet kuptimi për lidhjen reciproke midis qenieve të gjalla
10.	Retë dhe era	Më thuaj me figura	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve të ushtrohen nxënësit që me teknologji të thjeshta t'i përdorin e t'i ruajnë të dhënat

10. 11.	Retë dhe era	Dita dhe nata	3	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re lidhja midis lëvizjes së Diellit dhe pjesëve të ditës të zhvillohet kuptimi për ditën e natën
11. 12.	Gjatë udhëtimit	Shenjat e qarkullimit rrugor	3	<ul style="list-style-type: none"> të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve të njihen shenjat kryesore të qarkullimit rrugor në rrugën nga shtëpia deri në shkollë të përcaktohen njohuritë për lëvizjen e sigurt
12. 13	Gjatë udhëtimit	Udhëtojmë	3	<ul style="list-style-type: none"> të njihen me rregullat e sjelljes në mjetet e ndryshme të udhëtimit, karakteristike për vendin ku jetohe të dallojnë rëndësinë e sjelljes së rregullt e të sigurt në rrugën nga shkolla deri në shtëpi të njihen me mënyrat e ndryshme të transmetimit të informatave
13. 14.	Gjatë udhëtimit	Të jemi të kujdesshëm	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen rreziqet në qarkullimin rrugor në situatat dhe kushtet e ndryshme të motit të vihet re rrjedha e ndodhive të motit
14.	Gjatë udhëtimit	Këmbalkat dhe patericat	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen mjetet lëvizëse dhe ato ndihmëse për lëvizje të njihen gjurmët që lë lëvizja të nxirret përfundimi se trupat në lëvizje mund të ndalen
15.	Gjatë udhëtimit	Prej ç'gjëje janë sendet	3	<ul style="list-style-type: none"> të përcaktohet cilësitë e materialeve të modelohen trupat prej materialeve të bëhet lidhja midis materialeve të ndryshme dhe proceseve të punimit të vihet re rëndësia e përgatitjes për punë të vihet re se gjatë punës krijohen mbeturinat, të cilat duhet të hiqen
16.	Gjatë udhëtimit	Shpejt, më shpejt	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen mjetet për lëvizje të nxirret përfundimi se mjetet për lëvizje mund të ndalen
16. 17.	Ka ardhur dimri	Ka rënë borë	3	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruhen ndryshimet e natyrës në periudhën e dimrit të vihen re veprimtaritë e njerëzve e të kafshëve në dimër të vihet re se ndryshimet në mjedisin përreth janë nganjëherë të këndshme, ndërsa nganjëherë të dëmshme për bimët e për kafshët

17. 18.	Ka ardhur dimri	Uji dhe akulli	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihen gjendjet agregate të ujit (akulli, bora, uji si lëng) të vihet re se akulli dhe bora janë ujë në gjendje të ngurtë të vihet re se prej borës e akullit përftohet uji në gjendje të lëngët dhe se uji mund të ngrijë
18.	Ka ardhur dimri	Kalendari	2	<ul style="list-style-type: none"> të njihet kalendari të dallohen ngjarjet sipas renditjes kohore: sot, dje, nesër, ditët e javës të përdoren fjalët për kohën: ditë, javë, muaj, vit
19.	Ka ardhur dimri	Festojmë	2	<ul style="list-style-type: none"> të dallohen festat shtetërore dhe festat fetare të vihet re rrjedha kohore e ndodhive
19. 20.	Kujdesemi për vetveten	Trupi im	3	<ul style="list-style-type: none"> të dihet se çfarë i duhet njeriut e qenieve të tjera për të jetuar të dihet se nga mjedisi përreth diçka merret, përpunohet dhe i jepet atij (jashtëqitja)
20. 21.	Kujdesemi për vetveten	Ushqimi	2	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re rëndësia e ushqimit të shumëllojshëm të mësohet se ushqimi prishet
21. 22.	Kujdesemi për vetveten	Jetoj në mënyrë të shëndetshme	3	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re rëndësia e ushqimit të shumëllojshëm për shëndetin e njerëzve të vihet re se njerëzit ndejnë më mirë, nëse janë rregullisht fizikisht aktivë të zgjerohen njohuritë dhe shkathtësitë që mundësojnë kujdesin për shëndetin vetjak të vihet re rëndësia e ruajtjes së dhëmbëve të shëndoshë
22. 23.	Pranvera erdhi	Druri ndryshon	3	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruhen ndryshimet në natyrë që ndodhin në pranverë të vihen re veprimtaritë e njerëzve dhe të kafshëve në pranverë
23. 24.	Pranvera erdhi	Prej nga vjen ushqimi?	3	<ul style="list-style-type: none"> të nxirret përfundimi se njerëzit e prodhojnë ushqimin të vihet re se njerëzit, gjatë prodhimit të ushqimit, përdorin veglat e mjetet e punës
24. 25.	Pranvera erdhi	Majdanozi dhe speci	3	<ul style="list-style-type: none"> të nxirret përfundimi se njerëzit e prodhojnë ushqimin të njihen pjesët e ndryshme të bimës të vihet re se prej farave të ndryshme rriten bimët e ndryshme

25. 26.	Pranvera erdhi	Në livadh	3	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se në mjedise të ndryshme jetojnë qenie të ndryshme të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike për mjedisin ku jetojmë të vihet re se disa kafshë/bimë janë të ngjashme, ndërsa disa të tjera ndryshojnë shumë të zhvillohet të kuptuarit për lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla
26.	Pranvera erdhi	Liqeni	2	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re se në mjedise të ndryshme jetojnë qenie të ndryshme të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike për mjedisin ku jetojmë të vihet re se disa kafshë/bimë janë të ngjashme, ndërsa disa të tjera ndryshojnë shumë të zhvillohet të kuptuarit për lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla
27.	Pranvera erdhi	Të ngjashëm, por të ndryshëm	2	<ul style="list-style-type: none"> të nxirret përfundimi se njerëzit dhe kafshët kanë trashëgimtarët (zakonisht dy prindër) të kuptohet se trashëgimtarët ngjajnë me prindërit dhe me njëri-tjetrin, por jo plotësisht të mësohet se qeniet e gjalla lindin, rriten, plaken dhe vdesin
27. 28	Mjedisi im	Nga shtëpia deri në shkollë	3	<ul style="list-style-type: none"> të njihen objektet karakteristike shoqërore e gjeografike në mjedisin e gjerë përreth shkollës të dallohen sipërfaqet e tokës në mjedisin përreth shkollës të dihet të përshkruhet përdorimi i tokës në mjedisin përreth shkollës të dallohen format bazë të relievit në afërsi të shkollës të orientohemi në mjedisin përreth shkollës me ndihmën e objekteve të njohura të natyrës ose të mjedisit shoqëror.
28. 29.	Mjedisi im	Mjedisi ndryshon	2	<ul style="list-style-type: none"> të vihet re në shembujt konkret sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën të përshkruhen ndryshimet në natyrë që shkaktohen nga njeriu të propozohet sesi mund të ndikohet në ruajtjen dhe në rregullimin e mjedisit natyror përreth të vihet re rrjedha kohore e ndodhive (ngjarjeve)

29.	Mjedisi im	Çfarë tregojnë tabelat?	2	<ul style="list-style-type: none"> të zhvillohet aftësia për sistemimin e të dhënave të zhvillohet aftësia për komunikimin grafik në shkencat natyrore e teknike
30.	Mjedisi im	Vera	3	<ul style="list-style-type: none"> të përshkruhen ndryshimet në natyrë që ndodhin në verë të emërtohen qeniet e gjalla karakteristike në mjedisin përreth të jetesës të zgjerohen njohuritë dhe shkathtësitë që mundësojnë kujdesin për shëndetin vetjak të dallohen bimët e ngrënshme e të pangrënshme

LITERATURA

1. B.S. Blum (1981): *"Taksonomija ili klasifikacija obrazovnih i odgojnih ciljeva"*, "Knjiga 1-kognitivno područje". Beograd: Instituti i Zhvillimit të Arsimit e Edukimit të Republikës.
2. U. Bronfrenbrenner (1974): *"Is early intervention effective? Facts and principles of early intervention: a summary"*.
3. Xh. Bruner (1988): *"Proces obrazovanja. Psihologija u nastavi"*. Beograd: Përmbledhja e punimeve të psikologjisë pedagogjike nr.4.
4. K. Burke. Vollsh (2003): *"Stvaranje sredine za učenje usmereno na dete: I razred"*; Beograd, Qendra e Pedagogjisë Interaktive.
5. Zh. Delor (1996): *"Obrazovanje skrivena riznica"*, Beograd: UNESCO.
6. J. Delors (1996): *"Učenje: skriveno blago"*, Lubljanë, Ministria e Arsimit dhe e Sportit".
7. Grup autorësh (1998): *"Da zemlja ostane zelena"*, Shoqata e Ekologëve të Rinj të Malit të Zi, Podgoricë.
8. I. Iviq, A. Peshikan, S. Antiq: *"Vodič za dobar udžbenik, opšti standardi kvaliteta udžbenika"*, Platonium, Novi Sad.
9. M. Klarin (2006): *"Razvoj djece u socijalnom kontekstu"*, Universiteti i Zagrebit, Naklada Slap, Jastrebarsko.
10. R. Kroflič (1994): *"Evalvacija visokoškolskega kurikuluma ket sastavni del planiranja"*, Sodobna pedagogika, 5-6.
11. *"Kreiranje vaspitno-obrazovnog procesa u kojem dijete ima centralnu ulogu"*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi, Podgoricë, 2001.
12. L. Levkov (2003): *"Školski program (kurikulum) i uvažavanje različitosti"*, në J. Shefer. S. Maksiq dhe S. Joksimoviq (doracak): *"Uvažavanje različitosti i obrazovanje"*, Beograd, Instituti i Studimeve Pedagogjike.
13. P. N. A. Klermon (2004): *"Socijalna interakcija i intelektualni razvoj"*, Beograd, ZUNS.
14. *"Knjiga promjena obrazovnog sistema"* (2001): Podgoricë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
15. *"Marzanova taksonimija ili naučiti kako učiti"*, (2008), Naša škola, Enti i Shkollimit Podgoricë.
16. N. Mijanoviq (1999): *"Pogledi na reformu obrazovanja"*, Podgoricë, Vaspitanje e obrazovanje, nr. 4.
17. S. Mirkov (2006): *"Metakognicija u obrazovnom procesu"*, Beograd, IPA, nr. 1.
18. S. Miliq (2002): *"Individualizovani pristup u vaspitno-obrazovnom procesu"*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi, Podgoricë.
19. B. Pavlloviq (2001): *"Koliko je poželjno dečje pitanje u školi"*, Beograd, Revista e Istitutit të Studimeve Pedagogjike.
20. M. Peshiq (1998): *"Pedagogija u akciji"*, Beograd, Istituti i Pedagogjisë dhe Androgogjisë.
21. J. Peshiq (2005): *"Problemski diskurs udžbenika"*, Psikologjia, vll. 38, nr. 3, fq. 225-237.
22. A. Polak (1998): *"Timsko delo v šoli-zakaj, kdo i kako"*, Lubljanë, Fakulteti i Pedagogjisë i Universitetit të Lubljanës.

23. Zh. Pijazhe, B. Inhelder (1978): *"Intelektualni razvoj deteta"*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd.
24. S. Radonjiq (1996), *"Škola u prirodi"*, Lidhja e Fëmijëve të Podgoricës dhe e Malit të Zi, Podgoricë.
25. S. Razdevshek-Pučko (1997): *"Usposobljanje učiteljev za programsko prenovu osnovne škole"*, Përmbledhja e studimeve të Kongresit të pedagogëve të Sllovenisë, Lubljanë; *"Programska priprava naše osnovne i srednje škole"*, Lidhja e Shoqatave të Pedagogëve të Sllovenisë.
26. Xh. Rotçild, E. Xh.Deniels: *"Materijali i aktivnosti za rad u učionicama u kojima dijete ima centralnu ulogu"*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi, Podgoricë, 2002.
27. Z. Rutar Ilc (2000): *"Opisni kriteriji kot pogoj kvalitetno povratna informacija"*, Lubljanë, në *"Problemi ocjenjivanja in devetletna osnovna šola"*, Fakulteti i Pedagogjisë dhe Enti i Shkollave i RS.
28. Z. Rutar Ilc, I. Sentoçnik (2001): *"Koncepti znanja, učenje za razumjevanje"*, Lubljanë, në *"Modeli učenja i poučavanja"*, Përmbledhja e studimeve, Enti i Shkollave i RS.
29. M. Scott (1994): *"Ekologija"*, Tehniška založba Slovenije, Ljubljanë.
30. P. Stojaković (1990): *"Psihološki uslovi transfera učenja"*, Beograd, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore.
31. N. Suziq (2006): *"Unutrašnja i vanjska motivacija u školskom postignuću"*, Podgoricë, *"Vaspitanje i obrazovanje"*, nr. 4.
32. J. Shefer (2005): *"Kreativne aktivnosti u tematskoj nastavi"*, Beograd, IPA.
33. B. Taylor (1994): *"Veliki slikovni atlas živali"*, *"Mladinska knjiga"*, Lubljanë.
34. L. S.Vigotski (2001): *"Mišljenje i govor"*, Nolit, Beograd.
35. L. S.Vigotski (1986): *"Kognitivni razvoj deteta"*, *"Zbornik radova iz razvojne psihologije"*, Beograd, Lidhja e shoqatës së psikologëve të RS të Serbisë.
36. I. Zdanski: *"Nastava u prirodi"*, Beograd, 1998.